Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (105). JANAR 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

ZGJEDHJET LOKALE

Kandidatët, vendosin liderët e partive

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 9

OPINION

Buxheti, pritshmëri që fitohen me ide dhe projekte

Nga **HYSEN UKA** - FAQE 6

MONOGRAFI

Haki Stërmilli - Jeta luftë, frymëzimi aty

Nga **XHEZAIR ABAZI** - FAQE 11

KULTURË & SPORT

Mësuesja që flet me pikturën

Ndregjoni, mundësi kampion

FAQE 12,21

DY MINISTRA TË QEVERISË, AHMETAJ DHE HAXHINASTO DEKLAROJNË:

Tenderi zhvillohet në shkurt, punimet nisin në prill 2015

Kryetari i Kuvendit Ilir Meta deklaron në kuvendin e Shkupit:
"Presim që edhe pala maqedonase të punojë për vazhdimësinë e rrugës së Arbrit"

Faqe 2



A do të bëhet Rruga e Arbrit?

Opinion nga **Ahmet Çaushi** - Faqe 5

Intervistë / Flet Dr. Ing.Faruk Kaba, drejtuesi i studios projektuese:

Jam optimist se marrëveshja do të nënshkruhet

- Projekti për pjesën e mbetur është i plotë, përveç një seksioni nga Ura Çerenecit deri në pikën kufitare në Drin, me gjatësi 3.7 kilometra, e cila, ka qenë parashikuar të projektohet, por u neglizhua në mënyrë të pakuptueshme nga ish strukturat administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
- Tuneli i Murrizës është projektuar me dy alternativa: në kuote 850m absolute dhe 934m. I pari është 3600 ml i gjatë ndërsa i dyti 2600 ml, pra rreth 1 kilometër më i shkurtër. Arsyet e bërjes së variantit të dytë kanë qenë ekonomike dhe teknike.
- Nga ish-strukturat e rrugëve janë bërë ndërhyrje të rënda, që kanë dëmtuar projektin origjinal. Personalisht, dëshiroj dhe shpresoj, që me kredinë kineze të arrijmë të korrigjojmë "gabimet" e bëra, që rruga e ardhshme të jete ajo që ne kemi konceptuar, projektuar dhe dëshiruar.

Faqe 3

Radika

Pas studimit mjedisor vendoset për vazhdimësinë e projekteve

- Qeveria e Maqedonisë i rikthehet çështjes së ndërtimit të hidrocentraleve me ujërat e Radikës.
- Ministrat Bushati dhe Poposki: jemi në kontakte për një zgjidhje të drejtë.
- Menaxhim në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe me legjislacionin ndërkombëtar.
- Projekti i hidrocentraleve, anashkalohet Dibra.
- Pushteti vendor në Dibër, Gostivar dhe Rekë si dhe 91 organizata joqeveritare në Maqedoni kërkojnë ekspertë ndërkombëtare për vlerësimin e situatës mjedisore

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 5

Arsim

Mësues për Shqipërinë: konkurojnë 92 mësues, fitojnë 39

Në sistemin arsimor në rrethin e Dibrës ka mbi 136 vende të lira dhe në provim morën pjesë vetëm 23 kandidatë. Shkëmbim akuzash mes një mësuesi dhe drejtoreshës së shkollës: Shkarkim i padrejtë apo emërime jashtë kritereve?

FAQE 5

cyan magenta yelloë black 1

Kryetari i Kuvendit Ilir Meta deklaron në kuvendin e Shkupit: "Presim që edhe pala maqedonase të punojë për vazhdimësinë e rrugës së Arbrit"

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (105). 1 - 31 Janar 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Agron TUFA
Abdurahim ASHIKU
Xhafer MARTINI
Ahmet ÇAUSHI
Hysen UKA
Xhezair ABAZI
Adem BUNGURI
Sulejman TOMÇINI
Selman MËZIU
Defrim METHASANI
Ilmi DERVISHI
Mevlud BUCI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.** Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online. Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

DY MINISTRA TË QEVERISË, AHMETAJ DHE HAXHINASTO DEKLAROJNË:

Tenderi zhvillohet në shkurt, punimet nisin në prill 2015

Kaloi një muaj që kur kryeministri Edi Rama përcolli përmes rrjeteve sociale "kartolinën për Dibranët" me premtimin për rrugën e Arbrit, dhe dy ministra të qeverisë së tij nuk harrojnë ta përmendin këtë çështje në analizat vjetore të dikastereve të tyre.



Arben Ahmetaj



Edmond Haxhinasto

"Besoj se brenda muajit prill do miratojmë ligjin përkatës për akordimin e kontratës së Rrugës së Arbrit kompanisë kineze, e cila paraqiti ofertën", tha ministri Haxhinasto. Ende nuk janë bërë publike detaje të ofertës së paraqitur nga kompania kineze China State Construction", shkruan ATSH.

AHMETAJ: NË SHKURT ZHVILLOHET TENDERI

I pari ishte ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Arben Ahmetaj, i cili gjatë prezantimit të projektit "Partneriteti Publik Privat - Risia e Vitit 2015" në fillim të Janarit, tha se "Rruga e Arbrit do të jetë risia e fund dimrit: në fund të shkurtit do të jetë në tenderim".

"Në fushën e transporteve risi është ndërfaqja e koncesioneve për ndërtim, mirëmbajtje, operimi i akseve kryesore rrugore me qëllim përmirësimin e sigurisë rrugore. Dua të përmend dy projekte që janë tashmë duke u përpunuar si kontraktime publik-privat; një është ndërtimi i segmentit të rrugës së Arbrit, që besoj do të jetë risi e fund dimrit, pra besoj në fund të shkurtit do të jetë në tenderim dhe projekti tjetër është ai i mirëmbajtjes së rrugës Durrës-Morinë. Ka një sërë rrugësh te reja të cilat do të konsiderohen dhe do të hidhen në treg për një kontraktim publik-privat", theksoi ministri Ahmetaj.

Në faqen e internetit të kësaj ministrie, një ndër projektet e hapura për investime është edhe rruga e Arbrit. "Kjo është një rrugë kryesore që siguron lidhjen e shpejtë midis portit të Durrësit dhe Republikës së Maqedonisë. Është, pra, e një rëndësie të madhe strategjike për vendin", - thuhet në shpjegimin shoqërues të ftesës për investime për projektin e rrugës së Arbrit. "Objektivi është që të krijojë një rrugë të qëndrueshme të transportit i cili është i sigurt, miqësore me mjedisin dhe ndihmon për të nxitur zhvillimin ekonomik të dy rajoneve - Matit dhe Dibrës. Ajo do të shkurtojë distancën mes Tiranës dhe Dibrës nga 173 km në 74 km", thuhet në botimin e posaçëm "Albanian Calls - A country of oppurtunities", me anë të të cilit joshen bizneset e huaja të investojnë në Shqipëri.

HAXHINASTO: NË PRILL NISIN PUNIMET

Por ndërkohë, nga fundi i shkurtit që thotë ministri Ahmetaj për tenderimin, ministri tjetër i qeverisë, ai i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, i cituar nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, thotë se "punimet për ndërtimin e rrugës së Arbrit, konsideruar si rruga e dytë e rëndësishme në vend pas Rrugës së Kombit, do të nisin brenda muajit prill".

"Kompania kineze China State Construction Engrg.Corp.Ltd do të ndërtojë rrugën e Arbrit. Kjo u bë e ditur për ATSH-në nga burime nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Një ditë më parë, vet ministri i Transportit, Edmond Haxhinasto, tha se punimet për ndërtimin e rrugës së Arbrit, konsideruar si rruga e dytë e rëndësishme në vend pas Rrugës së Kombit, do të nisin brenda muajit prill. "Besoj se brenda muajit prill do miratojmë ligjin përkatës për akordimin e kontratës së Rrugës së Arbrit kompanisë kineze, e cila paraqiti ofertën", tha ministri. Ende nuk janë bërë publike detaje të ofertës së paraqitur nga kompania kineze China State Construction", shkruan ATSH.

ATSH citon Ministrin që ta ketë thënë deklaratën e mësipërme gjatë "Analiza vjetore 2014 - Objektivat dhe Sfidat e 2015" ku u mor në shqyrtim puna e Autoritetit Rrugor Shqiptar, por në faqen e internetit të Ministrisë, në fjalën e ministrit Haxhinasto nuk citohet fare deklarata e mësipërme.

Ndërkohë, shumë pak informacion po qarkullon për atë se si do të jetë rruga e Arbrit tani që po afrohen investimet kineze. Duket pak paradoksale që një ndër gjashtë firmat më të mëdha në botë të vijë e të ndërtojë në Shqipëri një rrugë me dy kalime, e cila përveç afrimit të Dibrës me Tiranën, shumë pak e rrit shpresën për një gjallërim ekonomik të shkëmbimeve mes Shkupit dhe Tiranës.

Ndoshta kjo lidhet edhe me mungesën e dëshirës së Maqedonisë për vazhdimin e punimeve nga Dibra e Madhe në drejtim të Gostivarit.

META NË MAQEDONI: PUNONI PËR RRUGËN E ARBRIT

Gjatë vizitës së tij në Maqedoni, kryetari i Parlamentit Ilir Meta, e preku këtë çështje, duke e vënë theksin te nevoja e rritjes së bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, krijimi i projekteve të përbashkëta ndërkufitare dhe rritja e investimeve në zonat e varfra në perëndim të Maqedonisë dhe lindje të Shqipërisë, duke e vendosur theksin në ndërtimin e hekurudhës që lidh dy shtetet, por edhe atë të ndërtimit të rrugës së Arbrit.

" Integrimi ynë evropian duhet të avancojë paralel me projektet e përbashkëta rajonale që forcojnë korridoret kyçe të ndërlidhjes mes të gjitha vendeve tona. Në këtë kuadër duhet të forcojmë përpjekjet e përbashkëta për të realizuar sa më shpejt linjën hekurudhore mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Një emergjencë strategjike do ta konsideroja për të dy vendet tona realizimin e shpejtë të kësaj linje hekurudhore, për t'i dhënë një peshë të re Korridorit të 8-të, dhe dy vendeve tona në veçanti. Janë hedhur hapa konkretë për ndërtimin e rrugës së Arbrit në pjesën e Shqipërisë, si një alternativë tjetër që afron dy kryeqytetet tona. Pritshmëria jonë është që me hapjen së shpejti të këtij korridori rrugor që kalon përmes dy Dibrave, edhe pala maqedonase të punojë për vazhdimësinë e këtij aksi të rëndësishëm deri në Shkup", tha kryeparlamentari Meta në fjalimin e tij para deputetëve të parlamentit të Maqedonisë më 20 janar.

Sipas Kryetarit të Kuvendit, "filozofia e urave që bashkojnë brigjet dhe popujt, ku sigurohet komunikimi, shkëmbimi dhe bashkëpunimi, është filozofia triumfuese e Evropës së Bashkuar, e cila shekullin e kaluar u mbijetoi dy luftërave botërore. Ne qëndrojmë larg alternativave arkaike nacionaliste, dhe qëndrojmë në mbështetje të plotë të zgjidhjeve konkrete, që rrisin punësimin dhe mirëqenien, që luftojnë varfërinë për të gjithë dhe pa diferencime etnike. Ndaj jam besimplotë se gjendemi në një moment të rëndësishëm historik, ku shumë hendeqe janë kapërcyer, ku duhet folur për projekte të përbashkëta dhe me interes reciprok, për energjinë, industrinë, mjedisin tonë të mrekullueshëm, agropërpunimin, arsimin, transportin, turizmin dhe shëndetësinë".

BUJAR KAROSHI

intervistë

Intervistë / Flet Dr. Ing.Faruk Kaba, drejtuesi i studios projektuese të rrugës së Arbrit:

‘Jam optimist se marrëveshja do të nënshkruhet së shpejti’

- Si paraqitet situata tani me rrugën e Arbrit, pas premtimit të Kryeministrit Rama se një marrëveshje me qeverinë kineze është gati?

- Që të jem i sinqertë, edhe unë e kam informacionin të kufizuar, por përderisa është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, asaj Kineze dhe Shqiptare, në kuadrin një kredie me kushte shumë të favorshme dhe e specifikuar për rrugën e Arbrit, kjo është shumë domethënëse. Jam shumë optimist.

- A keni informacion se çfarë parashikon kjo marrëveshje?

- Jo. Nuk kam informacione zyrtare, por e di që është negociuar deri vonë për të zgjidhur problemin në favor të ndërtimit sa më të shpejtë të rrugës. Vështirësia mbetet gjithnjë në faktin që ekonomia shqiptare ka një borxh të brendshëm e të jashtëm shumë të lartë, gjë që nuk e lejon marrjen e kredive të mëtejshme, qofshin edhe ato të tilla si kjo kredi kineze me kushte shumë të favorshme në terma shlyerje (përqindje interesi) dhe terma kohorë.

- A keni kontakte me firmën kineze dhe të çfarë natyre kanë qenë kontaktet?

- Me firmën kineze kam patur kontakte, por thjesht vetëm për çështje teknike dhe kjo është e kuptueshme. Ata kanë kërkuar disa informime të përgjithshme dhe disa shërbime që lidheshin kryesisht me studimin e fizibilitetit të rrugës. Ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe sigurisht studimi i fizibilitetit i vitit 2003 ka nevojë të rishikohet, nëse tentohet të gjenden mënyra të tjera financimi të rrugës, përpos asaj të kredisë që ka ofruar qeveria kineze, siç mund të jetë koncesioni, projekt i formës PPP (Partneritet Publik - Privat) etj.

- Në negociata me kinezet, a parashikohet vetëm ndërtimi i segmentit të mbetur apo edhe vazhdimi i rrugës në territorin e Maqedonisë?

- Personalisht nuk kam asnjë informacion zyrtar. Di vetëm që kompania e ngarkuar nga Qeveria Kineze (China State Construction Engineering Company - CSCEC), një nga gjashtë kompanitë më të mëdha në botë, ka qenë edhe në Diber - Maqedoni, sigurisht jo për turizëm, por për të marrë informacione më të plota lidhur me rrugën. Ata kanë marrë kontakte me Komunën e Dibrës dhe sigurisht duhet të kenë marrë kontakte edhe me përfaqësues të Qeverisë së Maqedonisë. Këto janë çështjet e tyre dhe kjo është normale, por duke ditur indiferencën e plotë të qeverisë Maqedonase lidhur me rrugën e Arbrit, nuk besoj se këto vizita do të kenë prodhuar ndonjë impakt të veçantë pozitiv në favor të projektit. Qëndrimi i palës maqedonase është më shumë se indiferent kundrejt kësaj çështje.

- Sipas informacioneve tuaja, a bëhet fjalë për një financim nga ana e Qeverisë Kineze apo një firmë kineze do të vijë të bëjë rrugën?

- Mënyra e disbursimit të kredisë kineze është e tillë: pas marrëveshjes ndërqeveritare, huadhënësi (Qeveria Kineze), procedon nëpërmjet bankës së saj zyrtare EXIM Bank of China. Në të njëjtën kohë, ngarkohet një nga firmat kineze të ndërtimit (firmë me aksione 100 përqind shtetërore), e cila rakordon kredinë ndërmjet Exim Bank, firmës së ngarkuar për ndërtim dhe përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare (dikasterit përkatës etj). Sigurisht që, këtu palët përfshihen edhe në negociata për çmimet njësorem, vlerën e preventivit dhe detaje të tjera standarde, për të firmosur më pas kontratën përfundimtare. Mesa kam unë informacion, akoma nuk është arritur në këtë stad. Mund të konfirmoj që ndërtimi do të drejtohet dhe kontrollohet nga kompania kineze, por do të zbatohet nga nënkontraktorë vendas apo të huaj. Kjo është një çështje e kompanisë kineze, si nënshkruese e kontratës ndërtimore me qeverinë shqiptare.

- A është gati projekti final i rrugës në segmentin e mbetur dhe në qoftë se po, sa parashikohet fondi i nevojshëm për përfundimin e saj?

- Projekti për pjesën e mbetur është i plotë, përveç një seksioni nga Ura Çerenecit deri në pikën kufitare në Drin, me gjatësi 3.7 kilometra, e cila, ka qenë parashikuar të projektohet, por u neglizhua në mënyrë të pakuptueshme nga ish strukturat administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Në fakt, pati përpjekje për të devijuar drejtimin e përcaktuar nga studimi origjinal i miratuar i fizibilitetit, për ta kaluar në një drejtim, që, për mendimin tim, ka qenë i gabuar dhe në kundërshtim me studimin origjinal të miratuar zyrtarisht nga strukturat e shtetit shqiptar. Le të shohim ç’do të ndodhe më tej.

- Lajmet se Kina do të ofrohet për ndërtimin e rrugës ka ngjallur shpresa së rruga e Arbrit do të ketë parametrat e një autostrade? Cilat do të jenë parametrat teknike të rrugës?

- Këto janë supozime absurde dhe diletanteske. Ndërtimi i rrugës si autostradë nuk përputhet me standardet dhe realitetin. Dëshira për ta parë këtë rrugë si autostradë është e të gjithëve dhe veçanërisht e imja, por nuk është as realiste dhe as inxhinierike, dhe nuk qëndron teknikisht edhe nga pikëpamja ekonomike.

- Dy shoqata dibrane kanë ngritur shqetësimin se, tani, me ndryshimin e qeverisjes në vend, duhet riparë standardi i ndërtimin në disa segmente, veçanërisht Tuneli i Murrizit? A keni ju dijeni për këtë dhe cilat janë të dhënat teknike përfundimtare për Tunelin e Murrizit?

- Do të ishte me të vërtetë një lëvizje e mirë, pse jo. Në fakt tuneli është projektuar me dy alternativa: në kuote 850 m absolute dhe 934 m. I pari është 3600 ml i gjatë ndërsa i dyti 2600 m, pra rreth 1 kilometër më i shkurtër. Arsyet e bërjes së variantit të dytë kanë qenë ekonomike dhe teknike në të njëjtën kohe. I pari është shumë i vështirë, por presupozon një zgjidhje më të mirë të rrugës në tërësi, që megjithë vështirësitë teknike, nuk është i pamundur për tu ndërtuar. Gjithsesi, le t’ja lëmë këtë aspekt palës kineze dhe strukturave tona që do të kontraktojnë me palën kineze dhe që do të administrojnë rrugën në të ardhmen. Le të shpresojmë që do të pranohet dhe ndërtohet zgjidhja më e mirë. Gjithashtu, në ish strukturat e rrugëve janë bërë ndërhyrje të rënda, që kanë dëmtuar projektin origjinal. Personalisht, dëshiroj dhe shpresoj, që me kredinë kineze të arrijmë të korrigjojmë “gabimet” e bëra, që rruga e ardhshme të jete ajo që ne kemi konceptuar, projektuar dhe dëshiruar.

Bisedoi: Bujar Karoshi



Aksi i rrugës së Arbrit luginës së Tujanit. Foto: B.Karoshi



Faruk Kaba

Projekti për pjesën e mbetur është i plotë, përveç një seksioni nga Ura Çerenecit deri në pikën kufitare në Drin, me gjatësi 3.7 kilometra, e cila, ka qenë parashikuar të projektohet, por u neglizhua në mënyrë të pakuptueshme nga ish strukturat administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Tuneli i Murrizës është projektuar me dy alternativa: në kuote 850m absolute dhe 934m. I pari është 3600 ml i gjatë ndërsa i dyti 2600 ml, pra rreth 1 kilometër më i shkurtër. Arsyet e bërjes së variantit të dytë kanë qenë ekonomike dhe teknike.

Nga ish-strukturat e rrugëve janë bërë ndërhyrje të rënda, që kanë dëmtuar projektin origjinal. Personalisht, dëshiroj dhe shpresoj, që me kredinë kineze të arrijmë të korrigjojmë “gabimet” e bëra, që rruga e ardhshme të jete ajo që ne kemi konceptuar, projektuar dhe dëshiruar.

Rruga e Arbërit nr. 105

A do të bëhet ndonjëherë Rruga e Arbrit? - pyet populli dhe pret.
Kur do të bëhet?

opinion

A do të bëhet **Rruga e Arbrit**?

Nga **AHMET ÇAUSHI***

A do të bëhet ndonjëherë Rruga e Arbrit? - pyet populli dhe pret. Kur do të bëhet? Kur do të provojmë të udhëtojmë me makinë andej nga shkuan të parët tanë me këmbë për Tiranë, Durrës e më tej? Ajo deri tani ka disa fillime, por datë mbarimi nuk ka provuar. A do të ketë? Edhe sa do të shkojë kështu? Dibra ndodhet në lindje të Tiranës, pak nga veriu. Por popullit për të shkuar nga Tirana për në Dibër i duhet të niset nga perëndimi në rrugën e Durrësit e, në gjysmë të saj, në Vorë, të kthehet drejt veriut për Lezhë e Shkodër e, si të kalojë Kurbinin, urën e Matit (urën e Zogut) të kthejë drejt lindjes, të kalojë nëpër Rubik e Rrëshen, për të kaluar tej e tej luginën e Matit, të ngjitet në Qafën e Buallit e të kalojë nëpër Bulqizë për të arritur në Dibër. Një dibrani, një rekasi, gostivarliu, tetovari, shkupjani apo strugani për të shkuar në Tiranë i duhet të kalojë nëpër tetë rrethe: Dibër e Madhe, Dibër, Bulqizë, Mirditë, Lezhë, Kurbin dhe Tiranë. Një super lodhje e pajustifikuar. Pse gjithë kjo lodhje për dibranin që shkon në Tiranë, Durrës e më tej ose për tiransin, durrsakun etj., për të ardhur në Dibër? A kësaj rruge kanë udhëtuar të parët tanë? Dikur me fillim të hershëm, ndoshta shumë kohë para erës sonë, kur nuk kishte shkolla, nuk kishte inxhinierë, nuk kishte qeveri të "popullit", banorët e Dibrës kishin komunikuar me tiransit, durrsakët etj., nëpër një rrugë shumë të shkurtër që, sa kalonte kufirin e Dibrës, prekte një qoshe të Klosit dhe takonte Tiranën. Dibrani nisej nga Dibra kur lindte dielli në verë dhe hynte në Tiranë kur perëndonte dielli. Këtë rrugë e bënte në këmbë. Unë kam udhëtuar së pari për Tiranë në shtator të vitit 1950, para 65 vjetësh. Rruga kalonte nga Rubiku. U nisëm me "sat" nga Peshkopia në orën shtatë të mëngjesit. Arritëm në Tiranë në orën shtatë të mbrëmjes. Rrugëtimi ishte shumë i vështirë dhe i gjatë, i njëjtë sa ai i udhëtimit me këmbë nëpër rrugën e shkurtër.

U hapën shkolla, u përgatitën historianë e inxhinierë, u bëmë edhe me "qeveri" e askujt nuk i shkoi mendja për një rrugë më të shkurtër që ta lidhte Dibrën me kryeqytetin e t'ua lehtësonte sadopak jetën dibranëve. U desh të vinin vitet e 1990-tës, që intelektualët dibranë hapur e pa drojë të shprehnin kërkesën për rrugën e vjetër për t'u lidhur me zemrën, qendrën e vendit tonë, Tiranën. Në fakt, kjo rrugë nuk ishte e fshehur. Ajo i kishte të qarta shenjat. Nga qendra e Tiranës nisej drejt lindjes një rrugë si ajo e Durrësit, Kavajës dhe Elbasanit dhe quhej Rruga e Dibrës.Të tjerat u rindërtuan disa herë, ndërsa për Rrugën e Dibrës nuk mendoi askush. Ajo nuk i shërbeu dibranit. Emri i kësaj rruge mbeti vetëm si shenjë orientimi për të pyetur se ku e ke shtëpinë…. në Rrugën e Dibrës. Nga shkohet në spital?.... - Nga Rruga e Dibrës etj.

U desh interesimi i intelektualëve dibranë bashkuar rreth shoqatës "Nisma" me Iljaz Kacën dhe Hysen Uken, të të cilët nxitën sensibilizimin e qyterarëve, intelektualëve, zyrtarëve lokalë për të tërhequr vëmendjen qeveritarëve se ka pasur një rrugë të shkurtër, të mbrojtur dhe shumë ekonomike, e cila ka lidhur Dibrën me kryeqendrën e vendit tonë, Tiranën. Në Korrik të vitit 1999, grupi i përbërë nga Muharrem Kola, sekretar i përgjithshëm i Prefekturës së Dibrës, Iljaz Kaca - arkeolog, Hysen Uka - gazetar, Flamur Bulku - topograf, Ramadan Bunçi - inxhinier, Pëllumb Dervishi - operator, Nexhat Hysa - ing. gjeolog dhe Bilbil Tafa - shofer, kryen ekspeditën në terren dhe hartuan të parin relacion teknik që iu dërgua qeverisë qendrore me kërkesën për ndërtimin e Rrugë së Dibrës (Arbërit) nga ana e Prefekturës së Dibrës. Ata bënë studime, udhëtuan edhe me këmbë nëpër këtë rrugë, bënë edhe projekte e llogaritje dhe ua dërguan qeveritarëve e qeverisë me gojë dhe me letra e shkresa edhe me ndihmën e inxhinierit me banim në Tiranë, Bashkim Lleshi. Shumë kohë qeveria nuk i përfilli këto kërkesa. Bujar Karoshi u bë zëdhënësi i tyre në mediat e Tiranës, dhe më pas gazeta "Rruga e Arbrit" u bë mbështetja e kërkesës së dibranëve, që kjo rrugë të bëhet sa më parë. Nuk ka pse populli i Dibrës të dënohet me rrugëtime të gjata nëpër shtatë rrethe për të shkuar në Tiranë. Këtë kërkesë jetike jo vetëm të dibranëve të kufirit brenda kufijve shqiptarë, por edhe të dibranëve në anën tjetër të kufirit, edhe të gjithë shqiptarëve në Maqedoninë e sotme e më tej, politika e shfrytëzoi për interesa elektorale. Në vitin 2005 në Bulqizë u asfaltuan 100 metrat e para të kësaj rruge. Populli e kuptoi mashtrimin. Pas disa vitesh filluan përsëri punimet në disa segmente. Gjatë ndërtimit të rrugës u bënë ndryshime në përmasat dhe në drejtimin e rrugës. Nuk ka asnjë justifikim në mendjen e dibranëve që të ndërpriteshin punimet për të parandërtuar një rrugë tjetër që nuk kishte filluar. Rruga e Arbrit nuk është më pak kombëtare se ajo që lidh Durrësin me Prishtinën.



Nga një ekspeditë në aksin e rrugës së vjetër të Dibrës, 1999.

Sa me krenari e kënaqësi politikanët e qeveritarët tanë krenohen brenda e jashtë atdheut për bashkëjetesën ndërfetare në vendin tonë. Në fakt, kjo bashkëjetesë vjen nga përmbajtja e feve e jo nga liderët fetarë, prandaj le të shohin kursin politik të partive të tyre për t'i korrigjuar që të sjellin bashkëjetesë paqësore pa e cënuar aspak garën, për t'i dhënë sa më shumë këtij populli. Ai përsëri shpreson.

Populli i Dibrës u gëzua si për vete për Rrugën e Kombit. Për kënaqësi ai herë-herë filloi të nisej drejt veriut, të hyjë në Kukës e të kthehet drejt jugut për të shkuar në Tiranë. Diferenca në kohë me rrugën aktuale që kalon nga Burreli e Shkopeti është shumë e vogël, ndërsa udhëtimi bëhet më i rehatshëm. Udhëtimi në rrugën e vjetër është më shumë interesi i shoferëve për të siguruar pasagjerë.

Rruga e Arbrit bashkon më shumë shqiptarë se çdo rrugë tjetër. Ajo bashkon shqiptarët brenda kufijve aktualë të vendit tonë, bashkon mbi 400 000 shqiptarët që jetojnë brenda kufijve të Maqedonisë aktuale: Dibër e Madhe, Rekë, Strugë, Gostivar, Tetovë e Shkup. Ajo vazhdon më tej për Kosovë: Prishtinë e Prizren pse jo, pak më tej Preshevë e Metvegjë etj. Rruga e Arbrit afron edhe zemrat e shqiptarëve që jetojnë në Bullgari, Rumani, Turqi etj. Ja, pra, pse është kaq e rëndësishme Rruga e Arbrit. Neglizhimi i ndërtimit të kësaj rruge ka dëmtuar çështjen kombëtare. Po të ishte ndërtuar më herët kjo rrugë, ndoshta nuk do të ishte cënuar fare uji i Radikës. Ky ujë do të vazhdonte të lëzite në shtratin e krijuar prej Zotit e të vazhdonte të jepte jetë për Dibrën e Madhe, për Dibrën brenda kufijve tanë, për tërë luginën e Drinit edhe për peshqit në detin Adriatik; do të vazhdonte të jepte dritë elektrike për tërë popullin shqiptar. Mungesa e kësaj rruge ka futur në harresë të qeveritarëve këto problem madhore e ka nënshkruar marrëveshje që cënojnë interesat kombëtare. Ja pse kjo rrugë ka dasht' parë me vëmendjen më të madhe.

Në thellësi të historisë së kombit tonë dibranët i kanë kryer të gjitha detyrimet kundrejt atdheut. Nëse fillojmë me kohën e pushtimit të Ballkanit nga osmanët, dibrani Gjergj Kastrioti zbriti së pari në Dibër për të marrë besën e dibranëve. Luftëtarët e kësaj treve trimëruan në rreth 20 betejat e bëra në Dibër dhe në krahina të tjera kundër perandorisë më të fuqishme të kohës. Ata shkruan lavdinë e popullit tonë. Ishte i vetëm populli i Dibrës që i ndali serbët në kufirin dibran, për të mos vazhduar më tej pushtimin. Nëpër rrugët më të shkurtra dibranët shpejtuan për të shkuar në Shkodër e për të ndaluar Karadakun të pushtonte qytetin verior.

Qenë dibranët ata që udhëtuan në këso rrugësh për të arritur në Durrës e ta mbronin nga pushtimi italian, qenë dibranët ata që luftuan edhe në Vlorë, por edhe në Janinë me Ali Pashë Tepelenën. Ishte Iljaz Pashë Qoku i Dibrës, kryetari i Lidhjes së Prizrenit, dhe dibranët ata që i dhanë forcë kësaj lidhjeje që kërkonte ta shpëtonte Shqipërinë nga copëtimi. Dibranët dhanë maksimumin e tyre për sigurimin e pavarësisë së vendit tonë në vitin 1912. Haxhi Vehbi Dibra ishte kryetari i senatit dhe nënkryetari i qeverisë së parë. Ai zëvendësoi Ismail Qemalin gjatë kohës që Ismail Qemali ishte në Europë. Me mungesën e Haxhi Vebi Dibrës, Ismail Qemali do ta kishte shumë më të vështirë të bashkonte popullin mysliman dhe të përdorte flamurin shqiptar me shqiponjën në mes, ndoshta të pamundur. Përsëri ishte Haxhi Vehbi Dibra, që në vitin 1923, në kongresin e parë të myslimanëve të Shqipërisë, shpalli shkëputjen nga Stambolli të institucioneve fetare shqiptare. Kjo solli forcimin e pavarësisë dhe këputi shpresat e Haxhi Qamilit.

Pasuritë e shumta, ndër më të rrallat e më të kërkuarat, si dhe bukuritë mahnitëse të luginës së Drinit, të rrjedhjeve të ujërave nga të dy shpatet e maleve në anët e Drinit, pyjet e larta e të shumëllojta, bjeshkët me lulet e ajrin e të cilave jepet jetë duhet t'i kishin shtyrë më herët qeveritë për ndërtimet e rëndësishme e jo vetëm për një rrugë. Toka ku shtrihen dy Dibrat i ngjan pamjes së shqiponjës në ulje. Fletët e saj pak të mbledhura janë si dy shpatet e dy maleve të veshura me bukuri të rralla në dy anët e Drinit. Trupi i shqiponjës zgjatet drejt veriut, siç përshkon Drini tërë Dibrën. Ujërat që burojnë nga dy shpatet e maleve ushqejnë me bollëk trupin e kryeshpendit për t'i dhënë jetë tërë popullit të Dibrës. Këta ujëra mbushin liqenet e veriut për t'u dhënë dritë e jetë të begatë tërë popullit shqiptarë nga veriu në jug. A nuk ka qenë e është kromi i Dibrës ai që i është gjendur ekonomisë shqiptare në ditë të vështira që populli ynë të mbijetojë e për ta fuqizuar atë! Toka e nëntoka e Dibrës, malet të mbuluara me pyje, por edhe shkrepat e zhveshura kanë bukuri e pasuri të pallogaritshme. Nuk kemi ditur e sot që dimë nuk duam t'ja japim popullit këto vlera. Rruga e Dibrës duhej bërë shumë herët, ndoshta që në kohën e Zogut e atë të Enver Hoxhës. Vlera e kësaj rruge do të ishte ndjerë për t'i afruar shqiptarët e të gjitha trevave brenda e jashtë Shqipërisë. Kjo rrugë do t'i bënte më të bashkuar, më të pasur dhe më të fortë. Është gabuar.

Por tani, a do të bëhet kjo rrugë? Edhe herë të tjera është premtuar nga ministra e kryeministra të qeverive nga tërë krahët partiakë. Nuk është bërë e dibranët për të shkuar në Tiranë nisen në të kundërtën e qytetit, drejt veriut për të arritur në Kukës. Nga Kukësi ai përsëri niset drejt jugut për të shkuar në Tiranë. Rruga tjetër që të çon në Tiranë duhet të niset nga jugu për të kaluar në Burrel dhe luginat e Shkopetit e kur të arrijë në rrugën e Durrësit të kthehet drejt lindjes për të hyrë në Tiranë. Përsëri, a do të bëhet kjo rrugë?! A do të arrijë brezi ynë të shijojë udhëtimin në këtë rrugë të shkurtër e të hyjë në Tiranë për dy orë e gjysëm? Le të shpresojmë! Politikanët le të mos harrojnë se populli i Dibrës nuk do të mashtrohet, ashtu siç u provua në vitin 2005. Nëse kjo rrugë mbaron një ditë, populli do ta festojë, ka një kërkesë: Në festën e mbarimit të punimeve të kësaj rruge të ftohet ai kryeministër që e filloi së pari në Bulqizë dhe asfaltoi rreth 100 metër rrugë. Fillimi i kësaj rruge shpreh edhe dëshirën për ta ndërtuar atë, por edhe ta ndiejnë që të mos përsëritet herë tjetër.Në këtë festë të ftohet edhe kryeministri që e filloi këtë rrugë, por që nuk e përfundoi. Cilido që gabon ta ndjejë përgjegjësinë përpara popullit të tij. Mesazhi i popullit të Dibrës, edhe pse deri tani është trajtuar si i persekutuar, është shumë i fuqishëm: "Për interesat e kombit shqiptar shtërngoni duart e uroni njëri-tjetrin për aq sa ka bërë secili". Populli ynë e dëshiron këtë, se kështu vendi ynë do të ndërtohet më shpejt, populli ynë do të pasurohet e do të jetë më i bashkuar e më i fortë.

Populli, me gjithë problemet e së kaluarës, shpreson ta shijojë shpejt udhëtimin e parë në këtë rrugë.

Sa me krenari e kënaqësi politikanët e qeveritarët tanë krenohen brenda e jashtë atdheut për bashkëjetesën ndërfetare në vendin tonë. Në fakt, kjo bashkëjetesë vjen nga përmbajtja e feve e jo nga liderët fetarë, prandaj le të shohin kursin politik të partive të tyre për t'i korrigjuar që të sjellin bashkëjetesë paqësore pa e cënuar aspak garën, për t'i dhënë sa më shumë këtij populli. Ai përsëri shpreson.

* **Myftinia Dibër**



Qeveria e Maqedonisë i rikthehet çështjes
së ndërtimit të hidrocentraleve me ujërat e Radikës

Pas **studimit mjedisor** do të vendoset për **vazhdimësinë e projekteve**

Nga **BUJAR KAROSHI**

Radika po del sërish në skenë me të njëjtin përqendrim ngjarjesh si një vit më parë. Janë dy ministrat e jashtëm që e prekin këtë çështje në Tiranë, por nga ana tjetër rikonfirmohet edhe vazhdimi i përpjekjeve të qeverisë së Maqedonisë për ti shkuar në fund ndërtimit të rreth 19 hidrocentraleve me ujërat e Radikës, dy prej të cilëve, Fusha e Llukovës dhe Ura e Boshkut konsiderohen si më të rrezikshmit për ndikimet në natyrë dhe jetën e komunitetit.

BUSHATI DHE POPOSKI: JEMI NË KONTAKTE PËR NJË ZGJIDHJE TË DREJTË

Dy ministrat e Jashtëm, të Maqedonisë dhe Shqipërisë, Nikola Poposki dhe Ditmir Bushati, gjatë një takimi mes tyre më 26 janar në Tiranë, prekën edhe çështjen e ujërave të Radikës.

Pyetjes së gazetarëve se "A ka një tërheqje nga ana e Maqedonisë për këtë projekt, për devijimin e lumit Radika?, Poposki u përgjigj se "bëhet fjalë për një projekt të mundshëm për zgjerimin e rrjedhjes së ujit në fushën e energjisë elektrike. Aspekti më i rëndësishëm për sa i përket këtij projekti është financimi nga institucione ndërkombëtare, para së gjithash nga Banka Botërore, dhe vlerësimi kryesor i këtij projekti që financohet nga institucione ndërkombëtare është para së gjithash vlerësimi i ndikimit që ka kjo në mjedis. Momentalisht ndodhemi në hapat e fundit të përfundimit të raportit në kuadër të vlerësimit të ndikimit të mjedisit, dhe në bazë të konkluzioneve që do të dalin, do të vendoset nëse ky projekt do të realizohet apo jo. Më duhet të përsëris që nëse konkluzionet janë pozitive, atëherë mund të vazhdohet me projektin, nëse ka ndikime negative, atëherë jo.

Çdo gjë do të ndërmerret duke u nisur nga ky vlerësim i institucioneve ndërkombëtare dhe çdo spekulim tjetër do të ishte i gabuar. Republika e Maqedonisë është më tepër se çdokush e shqetësuar me një projekt të tillë, që ndikon drejtpërdrejt në mjedis".

"Duke vazhduar me të njëjtin argument që dha kolegu Poposki, tha Ministri Bushati, për sa i përket Radikës kam përshtypjen që ajo çfarë unë thashë në fillim ishte edhe më e gjerë se Radika, sepse fliste për një menaxhim në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe me legjislacionin ndërkombëtar që detyron dy vendet tona për sa i përket burimeve ujore ku përshihet Ohri, Prespa, Drini e kështu me radhë. Vetë përgjigja e homologut maqedonas për sa i përket projektit të Radikës është dëshmi e qartë e faktit që dy qeveritë tona dhe institucionet përkatëse janë në komunikim dhe kontakt të vazhdueshëm, jo thjesht me njëratjetrën, por dhe me aktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, siç është rasti i Bankës Botërore, dhe çdo projekt, në mënyrë që të jetësohet, do të duhet të kalojë në disa faza që u përmendën dhe do duhet të kalojë disa teste që kanë të bëjnë me interesin e përbashkët të vendeve që përfshihen nga zbatimi i këtij projekti, çka do të thotë se nuk kam se çfarë t'i shtoj më shumë asaj që tha kolegu im Poposki për këtë çështje. Ndaj e thashë edhe në fillim që shqetësimi është i drejtë dhe spekulimi, siç ndodh rëndom, është i pajustifikuar.

PROJEKTI I HIDROCENTRALEVE, ANASHKALOHET DIBRA

"Qeveria e Maqedonisë po i vazhdon projektet e saj për ndërtimin e dy hidrocentraleve, Fusha e Lukovës dhe Ura e Boshkut, duke synuar anashkalimin e përpjekjeve të dibranëve për dhënien e mendimit mbi këto vepra", tha për gazetën Rruga e Arbërit një anëtar i shoqërisë civile nga Dibra e Madhe.

BUSHATI: menaxhim në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe me legjislacionin ndërkombëtar

Një organizatë joqeveritare në Maqedoni e quajtur "Front 21/42" ka kërkuar informata të karakterit publik në Dibër dhe Gostivar lidhur me objektet në Fushë të Lukovës dhe në Urë të Boshkut", shkruan faqja në FB "Të mbrojmë Lumin Radika".

"Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka urdhëruar përgatitjen e "Projektit infrastrukturor" në vend të "Planit urbanistik për zona jashtë zonave të banuara urbane"! Në këtë mënyrë ministria anashkalon Dibrën lidhur me vendimit për ndërtim të hidrocentralit edhe pse Ura e Boshkut është në territorin e Dibrës".

"Dibra duhet urgjentisht të reagojë më qëllim që të përfshihet në procedurat e mëtejshme dhe jo të anashkalohet në këtë mënyrë", thotë Bardhyl Marku, aktivist pro mbrojtjes së ujërave.

Lidhur me projektin tjetër Fusha e Lukovës, Komuna Gostivarit mars të vitit 2013 ka miratuar një vendim për përgatitjen e një projekt-plani për zona jashtë zonave të banuara urbane. Për këtë dokument komuna e Gostivarit nuk ka përgatitur studim për ndikimin në mjedis që është një obligim sipas ligjit për ekzistues për Mbrojtje të ambientit jetësor.

Pushteti vendor në Dibër, Gostivar dhe Rekë si dhe 91 organizata joqeveritare në Maqedoni kërkojnë ekspertë ndërkombëtare për vlerësimin e situatës mjedisore

"Nuk dimë nëse Gostivari është duke planifikuar që të përgatisë një vlerësim të tillë strategjik, por ne shpresojmë se në të ardhmen e afërt do të bëhet një studim të tillë", thotë Marku.

PUSHTETI VENDOR PËRGATITET TË KUNDËRSHTOJË PROJEKTIN

Një grup ekspertësh është ngritur nga Komuna e Dibrës së Madhe për këtë çështje, por deri më tani nuk është bërë e mundur hartimi i një strategjie. Grupi i punës, pasi ta hartojë dhe miratojë strategjinë, do t'ia paraqesë atë Këshillit Komunal për miratim. Njëra nga synimet e strategjisë do të jetë edhe një padi ndaj ELEM dhe Qeverisë lidhur me projektet elektroenergjetike "Llukovo Pole" dhe "Boshkov Most", me qëllim që të hapet rruga për hapat e ardhshëm ligjorë, nëse qeveria do të vazhdojë me kokëfortësi të mos e marrë parasysh mendimin e organizatave mjedisore.

Ndërkohë, dy kryetarët e komunave të Dibrës së Madhe dhe Gostivarit, Ruzhdi Lata dhe Nevzat Bejtja, si dhe kryetari i shoqatës së bashkësive lokale të rajonit të Rekës, Samet Abdyli, po përgatisin një kërkesë ndaj IUCN – Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, ku kërkojnë ndihmën e tyre për hartimin e një raporti të pavarur me qëllim mbrojtjen e mjedisit Natyror të Mavrovës dhe Fushës së Lukovës.

"Dëshirojmë të shprehim shqetësimet tona në lidhje me aktivitetet e dëmshme të planifikuara në Parkun Kombëtar të Mavrovës në Maqedoni", thuhet në letër.

"Fshatrat dhe komunat tona janë të vendosura në dhe përreth parkut kombëtar të Mavrovës në Maqedoni, në të cilin janë planifikuar të ndërtohen dy hidrocentraleve të mëdha dhe shtatëmbëdhjetë hidrocentrale më të vegjël.

Ne kemi kundërshtuar projektet e digave në parkun tonë kombëtar për shumë vite, sepse ne jemi të bindur se ata do të shkretojnë lumenjtë në dhe jashtë parkut duke shkatërruar në këtë mënyrë një pjesë të rëndësishme të parkut. Kjo mund të vë statusin e Mavrovës si një park kombëtar në rrezik dhe të dëmtojë reputacionin e parkut dhe me atë të ardhmen tonë ekonomike, do të thahet lumi Radika dhe lumenj të tjerë të vegjël brenda parkut kombëtar të Mavrovës dhe e gjithë kjo do të ketë ndikim të madh negativ mbi liqenin e Dibrës dhe klimës së rajoni", shkruajnë përfaqësuesit lokalë.

Gjatë një konference në Shkup në prill 2014, IUCN ishte shprehur e shqetësuar nga digat e projektuara. Përfaqësues të saj informuan për miratimin e Rezolutës për mbrojtje të Parkut Kombëtar të Mavrovës gjatë Kongresit Botëror për Konservim të Mjedisit mbajtur në Jeju të Koresë së Jugut në Shtator 2012. Gjithashtu, drejtues të IUCN u dërguar letra të hapura Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Botërore (BB) në lidhje me projektet e planifikuara të hidrocentraleve në parkun kombëtar.

"Ne shohim te Organizata Juaj një shans për të ndaluar projektet në qoftë se presioni ndërkombëtar mbi qeverinë tonë dhe në institucionet financiare rritet", thuhet në letër. "Prandaj ne do të donim të ju ftojmë në qytetet tona dhe në Parkun Kombëtar të Mavrovës në mënyrë që ju të kuptoni më mirë situatën".

Kjo letër është mbështetur nga 91 organizata joqeveritare në Maqedoni që janë të angazhuara për mbrojtjen e mjedisit. Ajo është firmosur nga Lata dhe Abduli, dhe pritet së shpejti të firmosë edhe kryetari i komunës së Gostivarit, Nevzat Bejtja.

IUCN - Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës është një organizatë ndërkombëtare që ndihmon botën për të gjetur zgjidhje të shpejta për të mbrojtur mjedisit. Puna e IUCN-së fokusohet në vlerësimin dhe ruajtjen e natyrës, duke siguruar qeverisje efektive dhe të barabartë të përdorimit të saj, dhe vendosjen e zgjidhjeve natyrore e bazuar për sfidat globale të klimës, ushqimit dhe zhvillimit.

IUCN është organizata më e vjetër dhe më e madhe mjedisore globale në botë, me më shumë se 1200 pjesëtarë të qeverive dhe OJQ-ve, me mbi 11 mijë vullnetarë, ekspertë në mbi 160 shtete. Organizata ka një staf prej mbi njëmijë të punësuarish në 45 zyra dhe qindra partnerë në publik, OJQ dhe sektorë privatë në të gjithë botën.

Rruga e Arbërit nr. 105

Buxheti i shtetit i vitit 2015 përmban katër objektiva:
Zhvillimin e ekonomik, ulja e borxhit, reforma e pensioneve
dhe reforma në sistemin energjetik

Buxheti, *pritshmëri që fitohen me* **ide dhe projekte**

Nga **HYSEN UKA**



Nëse vërtet të gjithë të zgjedhurit dhe përfaqësuesit tanë në Kuvend apo në institucione kanë vërtet qëllim dhe mision progresin dhe zhvillimin e qarkut të Dibrës, duhet të shtojnë komunikimin me grupet e interesit, me shoqërinë civile, e jo vetëm me forcën e tyre politike, të mbledhin dhe të strukturojnë propozimet dhe idetë që vijnë nga qytetarët dhe ti shndërrojnë ato në pole tërheqëse për fondet e qeverive në vazhdimësi, jo sipas stinës politike e parisë së radhës në pushtet.

Fjala "buxhet", periodikisht, është fjala më e përdorshme në tremujorin e fundit të çdo viti. Variacione mbi këtë temë, dhe me këtë fjalë zgjaten e zgjaten deri në bezdisje. Arsyeja e kësaj mërzitje është keqkuptimi dhe keqpërdorimet që i bëjnë thelbit përmbajtjesor të kësaj fjale, pra konceptit të buxhetit, disa nga padija, por në të shumtën e herëve nga qëllime e interesa të caktuara, jo në të gjitha rastet të mira.

Si një vendimmarrje politike e një mazhorance politike është lëndë mjaft e përshtatshme për të bërë politik. Shumica parlamentare përcjell mesazhe për mbështetësit dhe elektoratin e vet, në rajone e zona të caktuara. Po ashtu edhe deputetet nga foltorja e parlamentit përcjellin mesazhe për votuesit e zonat e tyre elektorale. Nga ana tjetër opozita kundërshton e vë në dyshim çdo aspekt të buxhetit, duke përdorur ndjeshmërinë e madhe të njerëzve, si të atyre që janë mbështetës të saj, ashtu edhe të atyre që janë të zhgënjyer nga qeverisja e deritanishme e partisë në pushtet.

Kryeministri nga foltorja e Kuvendit, në inagurimin e projektit të tij financiar, e quan Buxhetin e vitit 2015: "...buxhet kyç, sepse është buxheti i një viti që shënjon një orientim drejt një ekonomie të qëndrueshme, pasi buxheti i vitit 2014 në përmbajtje të të cilit kishte element të emergjencës për arsye të gropës ekonomike, ishte buxhet urë drejt procesit të rimëkëmbjes. Buxheti 2015 rikthen besimin dhe orienton plane afatmesme dhe afatgjata shume më të mirëbazuara e të mirëorientuara".

Nga ana tjetër lideri i opozitës, Berisha shkruan: *"Buxheti i vitit 2014 është buxheti i gropës së zezë të madhe sepse, jo që nuk siguroj rritjen ekonomike por dhe për krizën dhe recesionin, nga i cili Shqipëria do vuaj për kohë të gjatë! Buxheti më i madh në histori është buxheti i mjerimit pasi, jo vetëm nuk u shoqërua me krijimin e vendeve të reja të punës dhe rrënjën e varfërisë, përkundrazi këtë vit papunësia u rrit në rreth 40%, kurse varfëria ekstreme u rrit me 6.2 herë. Ky ishte buxheti që ka përgatitur të gjitha kushtet negative për një gropë më të thellë për ekonominë tonë, rrokullisjen e saj drejt skenarit grek gjatë vitit 2015"***.**

Qytetarët, të cilët i mbajnë në shpinë si Kryeministrin edhe ish kryeministrin, por edhe thesin e halleve dhe të taksave, qëndrojnë të shushatur nga bubullimat e rrufetë e politikës, që njëherë vijnë nga e majta e njëherë nga e djathta, të shpërfillur, në pamundësi as të pyetën e as të dëgjohen për çfarë kanë nevojë, për çfarë do paguajnë e çfarë do të fitojnë nga gazep buxheti.

BUXHETI DHE DEBATI PARLAMENTAR

Kushtetuta përcakton qartë se sistemi buxhetor në Shqipëri përbëhet nga buxheti i shtetit dhe buxheti vendor . Buxheti i shtetit krijohet nga të ardhurat që mblidhen prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme. Buxheti përfshinë të gjitha shpenzimet e shtetit në një vit buxhetor. Nga ana tjetër në ushtrim të autonomisë së tyre, organet vendore caktojnë dhe mbledhin edhe ato disa taksa e detyrime të tjera. Buxheti është prova më reale, më bindëse se si funksionon një qeveri. Një qeveri përmes shpërndarjes së buxhetit, d.m.th strukturës buxhetore manifeston se cilat konsideron përparësi të qeverisjes së saj, dhe se sa ato përparësi shprehin kontratën politike të saj me mbështetësit e qeverisjes; eficiencën e qeverisjes gjatë periudhës dhe veprimtarisë së saj të mbledhjes së financiare, transparencë si në buxhet krijimin dhe shpërndarjen ashtu edhe efektivitetin në përdorimin e financave publike. Gjithashtu, buxheti është domethënës dhe shpreh më së miri edhe ritmet e zhvillimit në një vit buxhetor qeverisje, stabilitetin dhe zhvillimin në vend, përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, rritjen e mirëqenies dhe të kërkesave të tyre social -kulturore etj.

Por si e shprehin dhe i qasen buxhet krijimit dhe buxhet shpenzimit aktorët dhe faktorët tonë brenda vendit...? Ka një perceptim, vlerësim dhe qëndrim të qytetarëve, nisur nga nevojat, prioritetet dhe aspiratat e tyre, i cili gjithashtu është i larmishëm sipas rajoneve shkallës së zhvillimit në momentin e dhënë, kur hartohet buxheti, zhvillimit dhe resurseve natyrore dhe fuqisë kontribuese në buxhet krijim, si dhe nga shkalla e besimit me qeverinë, me forcën politike në qeverisje. Nga kjo premisë themi se zona të caktuara, rrethe qarqe, bashki e njësi të tjera të niveleve vendore apo dhe rajone të tjera kanë pritshmëri, vlerësime dhe qëndrime të ndryshme ndaj buxhetit. P.sh. shpesh dëgjojmë të thuhet se një qeveri ka me sy të mirë veriun apo një tjetër jugun, një qeveri me ministër financash nga ky rreth "ka fat dhe privilegj, pasi patrioti do të kthej sfratin nga krahina e vet" ose se "filan ministër nuk e ka me sy të mirë X komunë apo rreth", dhe konflikti e dyshimi futet edhe brenda të njëjtës forcë politike.

Të mjegulluar nga këto dyshime, disa nga deputetët e Partisë Socialiste në Komisionin e Ligjeve i ngritën gjyqin dhe e "mbërthyen" në një debat të pakuptimtë e të pa princip ministrin socialist të Financave, Shkëlqim Cani, në këtë rast edhe me origjinë por edhe deputet i Dibrës, me akuzën se "I ke dhënë më shumë fonde Dibrës se sa Durrësit". Pakënaqësi dhe dyshime për favorizim të Dibrës në shpërndarjen e fondeve për pushtetit vendor ndaj deputetit Shkëlqim Cani, shprehen Blendi Klosi, Xhemal Qefalia, Fatmir Xhafa dhe Bashkim Fino, të cilët u shprehen se "rrethet më të mëdha të vendit si Durrësi, Tirana apo Vlora përfitojnë më pak se rrethe shumë më të vogla (duke nënkuptuar Dibrën). Ministri Cani nga ana e tij theksoi "formulën e USAID-it të 2001-shit", dhe sipas kësaj metode, doli se nuk kishte asnjë "favorizim apo hile" por vetëm më në fund një deputet i Dibrës, është në lartësinë e duhur për të mbrojtur në mënyrë të ndershme dhe të drejtë interesat e votuesve të tij, që në këtë rast gjithashtu janë nga Dibra.

Këto qëndrime e perceptime janë lëndë e mjaftueshme për tu përdorur politikisht dhe për të ndërtuar opozitë luftarake, kur dihet ligjësia se gjithmonë nevojat janë më të mëdha se mundësit edhe në rastet më të mira e me të ardhura të kënaqshme e jo më në një rast buxheti me deficit të brendshëm alarmues. Këtu bëhet edhe manipulim e spekulim me shifra e përdorim i shifrave në mënyrë krejt irracionale, të shumëzuara me koeficient të lart të interesave politike partiake. Këtu pastaj diskutimi nis nga poshtë e ngjitet deri në komisionet për buxhetin e deri në parlament.

SI MUND TË TËRHIQEN FINANCIME NGA BUXHETI?

Unë dua të trajtoj një aspekt tjetër të marrëdhënieve dhe të përceptimit të buxhetit, atë të një qytetari të thjeshtë dhe se si qytetarët kanë një fuqi të madhe të tërheqin para nga buxheti, se si deputetët duke bashkëpunuar e duke u ushqyer me interesat dhe idetë krijuese të qytetarëve e grupeve të intelektualëve nuk duhet të skërmiten rreth kockës së buxhetit, por ato me idetë e tyre, me projektet e tyre, të shndërrohen në një magnet që të thithin sa më shumë investime nga buxheti i shtetit. Nëse idetë e tyre janë novative, janë bindëse, nuk është e nevojshme të bësh zhurmë, por promocione dhe bindje ndaj institucioneve vendimmarrëse, që kërkesat dhe idetë e tyre janë reale, të dobishme dhe produktive.

Buxheti i shtetit i vitit 2015 përmban katër objektiva: Zhvillimin e ekonomik, ulja e borxhit, reforma e pensioneve, dhe reforma në sistemin energjetik, ende nuk kemi dëgjuar konkretisht se cilët janë alternativat opozitare që rrezojnë buxhetin aktual apo e vënë atë në dyshim. Sigurisht, nuk mund të themi se një buxhet është i mbaruar deri në përsosje, aq më shumë në një vend si vendi ynë ku kemi deficit buxhetor dhe një borxh publik alarmant. Nuk mund të pretendojmë më shumë kur dihet se shpenzimet qeveritare dhe të hyrat nga taksat dhe tatimet e burime të tjera buxhetore shënojnë disproporcion negativ. Në këtë rast, më e dobishme do të ishte një pjesëmarrje e gjerë dhe një mirëkuptim e kontribut i të gjithëve për të përdorur në mënyrë sa më të arsyeshme e produktive financat e pakta publike.

ÇFARË KA NDODHUR ME BUXHETIN DHE SHPËRNDARJEN E TIJ?

Përfaqësuesit opozitarë të qarkut të Dibrës kanë bërë zhurmë dhe janë të shqetësuar vetëm me faktin se buxheti i vitit 2015, që është edhe vit zgjedhor për pushtetin lokal, pakëson burimet përmes të cilëve administrate e qarkut Dibër edhe përkundër ngushtësisë financiare ka përdorur të gjitha fondet në dispozicion, duke shfrytëzuar edhe boshllëqet apo paqartësit ligjore për të "strehuar" e mbajtur të motivuar njerëzit e saj të prekur nga reformat. Nga 28 nëpunës që kishte një vit më parë administrate e qarkut Dibër, aktualisht ka 66 të nëpunës në listat e pagave, duke shpërdoruar kështu një fond të konsiderueshëm nga financat publike pa asnjë dobi shoqërore.

Kundërshtimet rreth buxhetit nuk diskutojnë rreth projekteve, rreth ideve që prevalojnë për nga rëndësia dhe dobia shoqërore që sjellin përkundër atyre që ka përzgjedhur dhe ka përcaktuar për të mbështetur financiarisht buxheti i vitit 2015. Por kjo frymë e diskutimit dhe e kundërshtimit të buxheteve është kthyer në mjet politik karakteristik në politikbërjen shqiptare, me pasoja të mëdha në shumë aspekte, por veçanërisht në realizimin e transparencës ndaj publikut lidhur me financat, si një detyrim ligjor kjo për qeverisjen, por edhe dobësimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrjen dhe projektimin e vizioneve të së ardhmes së zonave të caktuara apo dhe të vendit.

Kam ndjekur me vëmendje diskutimet rreth buxhetit të deputetëve të opozitës në parlament, teknicientëve të nivelit më të lartë në fushën e financave, por në të gjitha kundërshtitë dhe frymën e debatit të tyre nuk kam gjetur ide apo projekte kundërvenëse, që mund të quhen përparësi krahasuar me projektin që planifikon të financojë qeveria, por vetëm shifra të thata të cilat mjeshtërisht përdoren për të prodhuar efekte politike, por që nuk shprehin asnjë vizion zhvillimor.

Në gjykimin tim, nëse vërtet të gjithë të zgjedhurit dhe përfaqësuesit tanë në Kuvend apo në institucione kanë vërtet qëllim dhe mision progresin dhe zhvillimin e qarkut të Dibrës, duhet të shtojnë komunikimin me grupet e interesit, me shoqërinë civile, e jo vetëm me forcën e tyre politike, të mbledhin dhe të strukturojnë propozimet dhe idetë që vijnë nga qytetarët dhe ti shndërrojnë ato në pole tërheqëse për fondet e qeverive në vazhdimësi, jo sipas stinës politike e parisë së radhës në pushtet.

arsim



Shkolla e Lunarës. Foto publikuar në FB "Oda Dibrane"

Mësues për Shqipërinë: Në Dibër konkurojnë 92 mësues, fitojnë 39

- Në sistemin arsimor në rrethin e Dibrës ka mbi 136 vende të lira dhe në provim morën pjesë vetëm 23 kandidatë.
- Shkëmbim akuzash mes një mësuesi dhe drejtoreshës së shkollës: Shkarkim i padrejtë apo emërime jashtë kritereve?
- Sipas një ish-zyrtari të Ministrisë së Arsimit, në vitet e fundit, gjatë analizave është vënë re se Qarku i Dibrës ka qenë në nivelet më të ulta të rezultateve të mësimdhënies, reflektuar kjo nga rezultatet e maturës shtetërore. Ndërsa në konkurset kombëtare nxënësit nga Dibra ose nuk kanë marrë pjesë, ose janë renditur në vendet e fundit.

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Kushedi sa njerëz kanë marrë diploma fallco nga shkolla e mesme Lunare, pa e ditur se ku ndodhet, dhe sot janë në poste drejtuese", shkruan faqja ne Facebook "Oda Dibrane", duke prezantuar foton ilustruese të këtij numri. Në fakt, kjo diçiturë duket si spekulim, por kur shikon standardet e arsimit të Dibër në të paktën 10 vitet e fundit, ky "spekullim" mban mes rreshtash të vërteta të dhimbshme.

Sipas një ish-zyrtari të Ministrisë së Arsimit, në vitet e fundit, gjatë analizave është vënë re se Qarku i Dibrës ka qenë në nivelet më të ulta të rezultateve të mësimdhënies, reflektuar kjo nga rezultatet e maturës shtetërore. Ndërsa në konkurset kombëtare nxënësit nga Dibra ose nuk kanë marrë pjesë, ose janë renditur në vendet e fundit.

E gjithë kjo, thotë burimi, vjen si rezultat i mësuesve pa profilin përkatës dhe mungesës së dëshirës së tyre për një arsim cilësor dhe profesional.

Gjatë një kërkimi vitin e kaluar për nivelin e arsimit fillor, vetëm në 2 shkolla u konstatuan 12 nxënës, që megjithëse ishin duke mbaruar nivelin fillor të arsimit, madje edhe atë 9-vjeçar, nuk kishin mësuar akoma të lexonin dhe të shkruanin.

"Unë nuk e di pse mësuesit kërkojnë rroga të larta, kur fëmijën tim e lënë sakat", më tha prindi i një nxënësi.

Në Dibër nuk është vështirë të dëgjosh raste emërimesh, pushimesh apo transferime mësuesish si rezultat i pagesave nën dorë apo përkatësisë partiake. Ka plot mësues të mirë që janë larguar në shkolla periferike, madhe edhe në klasa kolektive, dhe plot mësues pa arsimin përkatës janë afruar drejt shkollave në qytet ose pranë qytetit, pasi kështu ka vendosur partia apo organizatat politike ku ato militojnë.

Gazeta "Opozita.com" botoi në fillim të vitit rastin e një mësuesi në shkollën e Dovolanit, me përvojë 40 vjeçare, i cili ishte shkarkuar nga drejtoresha e shkollës, e cila akuzohej se nuk kishte për vete arsimin përkatës. Gazeta shkruante se "drejtoresha ka rezultuar me diplomë fallco para 7 vitesh, rast që çoi në largimin e menjëhershëm nga puna të saj", por kjo nuk e pengoi atë të kthehet jo më si mësuese, por si drejtore e shkollës.

Menjëherë pasi lajmi u shpërnda si "virus" në rrjetet sociale, pati edhe një reagim të drejtoreshës aktuale, e cila akuzonte paraardhësin e saj se ai nuk ka zbatuar udhëzimin nr. 21 të MASH. "Duke i lënë këto udhëzime ti mbulojnë pluhurat në sirtarë, shkruan ajo, dhe ky udhëzim u zbatua sot nga inspektimi i MAS dhe u vërejt që në shkollën 9-vjeçare "Nazmi Rushiti " Dovolan, ishin bërë shkelje të rënda të këtij udhëzimi. Pushimi i ish drejtorit, thotë ajo, erdhi për shkak se u zbatua ky udhëzim, mbyllja e klasave me numër nxënësish nën normë. Vendimi i largimit nga detyra i mësuesit është i drejtë dhe në përputhje me udhëzimet e MAS dhe të DAR Dibër".

Por, në reagimin e saj drejtoresha e komanduar e shkollës së Dovolanit nuk shpjegon se çfarë thotë "Udhëzimi Nr. 21", i cilës periudhë është ky udhëzim dhe a është në tagrin e saj të shkarkojë apo emërojë mësues.

Gjithashtu, drejtoresha e akuzon mësuesin e saj se nuk ka patur marrëdhënie të mira me kolegët, ka qenë kokfortë dhe ka thyer shpesh kodin e etikës. Në vitin 2009, shkruan ajo, u shkarkua nga posti i drejtuesit në këtë shkollë dhe ditën e largimit bastardoi komplet bazën kompjuterike që ndodhej në Drejtori (Skaner, Laptop, Fotokopje dhe Routerin e internetit të sallës së informatikës).

Drejtoresha e shkollës ndërkohë bën edhe një CV të saj, ku thotë se "Në vitin shkollor 1990-1991 kam kryer shkollën e mesme bujqësore me shkëputje nga puna në specialitetin Agronomi pranë shkollës së mesme bujqësore "Ramiz Daci" Maqellarë. Mbi bazën e kësaj dëftese, ka kryer gjatë viteve 2009-2013 kursin e plotë në programin e studimit të Fizikës (Bachelor) të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, me kohë të pjesshme dhe në vitin 2013 jam regjistruar në Master Profesional pranë këtij fakulteti dhe vazhdoj vitin e dytë për këtë titull".

Në fakt, ky emërim bie ndesh me kriteret e vëna nga Drejtoria Rajonale e Arsimit në Dibër. Në një njoftim të saj për vende të lira puna, ku kërkohen 10 drejtues shkollash, tre në arsimin e mesëm dhe 7 në arsimin 9-vjeçar, thuhet se kandidatët duhet "të kenë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershrne me të, të ketë të paktën kategorinë "Mësues i Kualifikuar" dhe të mos ketë masa disiplinore ndaj tij". Me sqarimin që ka dhënë vetë drejtoresha aktuale, të treja këto kritere vihen në diskutim.

"Është e vështirë që kriteret të respektohen pikë për pikë, thotë një mësues në një shkollë të Peshkopisë, për arsye sepse në Dibër vihet re një mungesë e madhe kuadri të profilizuar".

Ministria e Arsimit Lindita Nikolla, gjatë një prezantimi të rezultateve të para të projektit "Mësues për Shqipërinë" thotë se ky projekt "është zgjidhje për emergjencën kombëtare në arsim, ku evidentohen rreth 4000 mësues pa arsim përkatës ose jashtë profilit".

Në provimin kombëtar "Mësues për Shqipërinë" që u organizua pikërisht për të mbushur këtë boshllëk, në të gjithë Shqipërinë morën pjesë rreth 5300 mësues, ku më pak se gjysma, 2082, rezultuan fitues. Në Dibër konkurruan 92 kandidatë dhe kanë fituar 39.

Po ti hedhësh një sy listës fituese të publikuar nga MAS shikon se në Dibër, shumica e fituesve kanë kërkuar të fillojnë punë si mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe, rreth 14 prej tyre, dhe pjesa tjetër në arsimin parashkollor, fillor dhe ndonjë prej tyre për biologji, gjeografi, histori apo muzikë.

Në një postim në FB, deputeti i Dibrës Ulsi Manja thotë se në sistemin arsimor në Dibër ka "mbi 136 vende të lira, dhe në provim morën pjesë vetëm 23 veta".

Për këtë shkrim kërkuam të takonim një mësues që kishte konkurruar në "Mësues për Shqipërinë", kishte fituar dhe, ose kishte filluar, ose ishte në prag të punësimit. Njëri prej tyre, me të cilin arritëm të shkëmbenim mesazhe me email, dha disa informacione që vë në dyshim udhëzimet e MAS.

"Unë kam kërkuar në një shkollë të caktuar, por tani më thonë se duhet të shkoj në një shkollë më të largët". Ai na u lut të mos e citonim emrin, pasi ka frikë se nuk do ta emërojnë në punë dhe kjo është shpresa e fundit për të filluar profesionin e mësuesit, sado larg që të jetë.

Ndërsa një burim pranë drejtorisë arsimore thotë për gazetën se "Të gjithë mësuesit në Dibër që kanë fituar konkursin do të sistemohen me punë".

Një kërkesë për informacion përmes emailit për drejtorinë arsimore të Dibrës dhe dy zyrat rajonale në Mat dhe Bulqizë mbeti pa përgjigje.

Por a është cilësia e mësuesve aktualë në nivelet e pranueshme? Është vetë ministrja e Arsimit që pohoi nga Shkodra me 8 janar, se janë "4000 mësues pa arsim përkatës dhe jashtë profilit", të cilët "lejuan që 1 në 4 nxënës jo të një klase, të ishin në duart e një qytetari, por që kurrsesi nuk mund të ishte mësues, sepse nuk kishte lidhje me lëndën që jepte".

Një shofer furgoni, gjatë një udhëtimi me të në vjeshtën e vitit të kalur, kur shkollat sapo kishin hapur dyert për vitin e ri arsimor, thotë se mësuesit e fëmijëve të tij janë "analfabetë". Pyetjes se pse e ka këtë përshtypje, ai thotë se e shikon te fëmijët e tij, njërin në klasë të 5-të dhe tjetrin në klasë ta 7. "Djali e kishte zgjidhur gabim një detyrë të matematikës në detyrat e klasës, dhe ai e kishte vlerësuar me 10".

"Por nuk ka nevojë të shohësh mësuesit, thotë ai, mjafton të vish me mua në mëngjes, dhe do ta shikosh se drejtorit të shkollës i vjen era alkool që në 7 të mëngjesit. Kam probleme me pasagjerët, nuk duan të vijnë me furgonin tim, pasi drejtori qelbet era raki".

"Unë kam marrë kredi për të shkolluar vajzën në një shkollë private në Tiranë, thotë një prind përmes FB, pasi mësuesi i saj, gjatë javës jepte mësim, në fundjavë largohej për t'u shkollur pranë një universiteti privat në Tiranë". Ai shton se përveç kësaj, në klasë nuk dëgjohej mësuesi, edhe kur ai ishte i mirë, pasi disa nxënës vijnë në shkollë për të kaluar kohën, kërcënojnë mësuesit dhe u grisin fletoret nxënësve të mirë, që guxojnë të bëjnë detyrat në shtëpi". "Djalit tim i kanë djegur çantën në shkollë, thotë përmes emailit një prind, pasi ai shkonte në shkollë me çantë shpine".

Pavarësisht këtyre rasteve, rruga drejt një arsimi në standarde bashkëkohore kalon nga mësuesi. Një mësues i mirë, një kolektiv pedagogjik i përgatitur, do të gjejë edhe mundësinë t'i eliminojë këto raste.

"Koha e gënjeshtrave ka marrë fund në arsim, thotë ministrja Lindita Nikolla. Ne, jo vetëm që po adresojmë një sistem të ri punësimi për mësuesit bazuar në meritë, konkurrencë dhe transparencë, por po punojmë shumë fort me universitetet e edukimit për të mundësuar një sistem të ri mbështetjeje për mësuesit e rinj dhe për ata që janë në sistem, në mënyrë që cilësia në arsim të jetë kryefjala e punës sonë".

Në takimin e Shkodrës ajo iu bëri thirrje prindërve të bëhen zëdhënës të fortë, duke monitoruar çdo lëvizje që do të realizohet për të mundësuar punësimin e mësuesve të rinj, në respekt të ligjit dhe të ardhmes së fëmijëve.

Linjat elektrike të amortizuara,
ndërprerje dritash në gjithë qarkun

Bora zbardh Dibrën, fshatrat **izolohen**



Arratiset faturisti i OSHEE, policia shpall kërkimin

Vetëm një ditë pas protestës së banorëve të Maqellarës, për ndërprerjen padrejtësisht për ta të energjisë nga ana e OSHEE-së, ka reaguar policia e shtetit e cila ka shpallur në kërkim ish faturistin e energjisë shtetasin Arian Qoku.

Burime nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Dibrës, thanë se ish "punonjësi i OSHEE-së nuk i ka derdhur paratë në arkën e kompanisë. Mësohet se shtetasi në fjalë ka patur edhe më herët probleme të ngjashme, ndërsa së fundmi rezulton të jetë zhdukur dy muaj më parë".

Viti 2015 filloi me reshje të dendura borë për rajonin e Dibrës. Temperaturat u ulën ndjeshëm, pati bllokime të rrugëve nacionale dhe lokale si dhe ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike në shumë komuna të qarkut të Dibrës.

Trashësia e dëborës shkoi nga 50 centimetra deri në 1 metër në zona të thella malore. Këto reshje dëbore u shoqëruan në vijim me një ulje të ndjeshme të temperaturave ku në Bulqizë shënuan deri në minus 18-të gradë C. Një situatë e tillë që zgjati gjatë pothuajse gjithë dyjavorit të parë të muajit janar, mbajti të izoluara komuna si Lurë, Kala e Dodës, Luzni, Sllovë dhe Selishtë në rrethin e Dibrës, Trebisht, Osren, Zerqan dhe Krastë në rrethin e Bulqizës dhe Xibër, Derjan e Macukull në rrethin e Matit. Si pasojë e këtyre reshjeve, rrugët që i lidhin këta komuna me qendrat e rretheve u bënë të pakalueshme nga automjetet.

Ndërkohë edhe rrugët nacionale Peshkopi-Kukës, Bulqizë-Krastë dhe Ura e Cerenecit-Klenjë-Librazhd patën bllokime në segmente të veçanta për të paktën 3 ditë. Vetëm rruga nacionale Peshkopi-Bulqizë, ka funksionuar për lëvizjen e automjeteve pa probleme kjo falë edhe gatishmërisë që tregoi firma kontraktuese për mirëmbajtjen e saj, ku nuk munguan borëpastrueset dhe hedhja e kripës dhe skorjeve.

Kjo situatë e motit, nxori tërësisht zbuluar strukturat shtetërore lokale, të cilat në asnjë moment nuk bënë ndërhyrje për zhbllokimin e rrugëve që lidhin qendrat e komunave me qendrat e rretheve, si dhe fshatrat e veçantë me qendrat e komunave. Në këta rrugë për asnjë moment nuk pati ndërhyrje për zhbllokimin e tyre me borëpastruese dhe as hedhje skorjesh e kripe që kanë munguar totalisht.

Izolimi i fshatrave në zonat e thella malore u bë edhe më i vështirë edhe për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike. Defektet në në linjat e transmetimit kanë qenë të shpeshta si rezultat i amortizimit. Ulja e temperaturave, shoqëruar me erë të fortë, çoi në këputje të telave përcjellës të energjisë dhe shembje të shtyllave, duke lënë kështu në terr të plotë banorët.

Zonat më të prekura nga ndërprerja e energjisë kanë qenë Lura, Sllova, Selishta, Qafë-Murra, Kalaja e Dodës, në rrethin e Dibrës, Zerqani, Fushë-Bulqiza, Trebishti dhe Ostreni, në rrethin e Bulqizës, si dhe Xibër-Murrize në rrethin e Matit.

NGRICAT NË RRUGË - 163 PERSONA PËSOJNË LËNDIME

Ngricat që vijuan gjatë 10 ditëshit të parë të muajit janar, të mbajnë të "mbërthyer" rajonin e Dibrës, shkaktuan probleme jo vetëm në rrugët automobilistike për lëvizjen e automjeteve, por edhe në bulevardet e trotuaret e qyteteve Peshkopi dhe Bulqizë për lëvizjen e qytetarëve të tyre. Kjo për faktin se bulevardet dhe trotuaret e këtyre qyteteve mbetën të pa liruar nga bora dhe akulli. Më të rrezikuar për lëvizje qenë fëmijët dhe të moshuarit.

Bashkitë e Peshkopisë dhe Bulqizës e realizojnë pastrimin e qyteteve jo me kompani private, por me ndërmarrjet e pastrim-gjelbërimit, në varësi të tyre. Situata e krijuar nga reshjet e dëborës dhe ngricave që në këtë Vit të Ri, kapluan vendin aq më tepër Dibrën, i nxori zbuluar këto ndërmarrje në varësi të bashkive përkatëse. Kjo pasi bulevardet dhe trotuaret e këtyre qyteteve, vijuan të jenë nën "pushtetin" e akullit, për ditë të tëra, në pamundësi për tu pastruar, duke rrezikuar kështu ndjeshëm lëvizjen e banorëve të tyre. Ndërkohë që njësitë vendore kërkonin me të drejtë pastrimin e rrugëve nacionale nga kompanitë private që kishin kontraktuar mirëmbajtjen e tyre, duket se "harruan" që tu kërkonin ndërmarrjeve të pastrim gjelbërimit në varësi të tyre, që të pastronin rrugët brenda qyteteve Peshkopi dhe Bulqizë, që u kthyen kështu në burim aksidentesh për banorët e tyre.

Burime nga urgjenca e Spitalit Rajonal të Peshkopisë, bënë me dije se situata vijoi të mbetet mjaft gjatë gjithë dy javëshit të parë të Janarit, ku çdo ditë pranë urgjencës së këtij spitali paraqiteshin pacientë me fraktura në gjymtyrë e trup që kërkonin ndihmë mjekësore.

Sipas shefit të urgjencës së këtij spitali, Gazmend Xhambulla, në periudhën kohore nga nata e Vitit të Ri e deri më 15 janar, të paktën 163 pacientë kanë ardhur në urgjencë me fraktura, ku 20 prej tyre kanë qenë fraktura të rënda. Shkak i këtyre incidenteve është bërë situata e rënduar brenda qyteteve Peshkopi dhe Bulqizë, që janë të mbuluar nga akulli, si dhe aksidentet automobilistike në rrugët nacionale dhe rurale, ku veçanërisht këto të dytat lënë shumë për të dëshiruar, pasi në fare pak prej tyre për të mos thënë në asnjërën, nuk ka patur ndërhyrje për lirimin e tyre me borëpastruese e kripë.

MAQELLARA NË PROTESTË: S'JEMI DEBITOR, NA RIKTHENI ENERGJINË

Më 19 janar, qindra banorë të komunës Maqellarë kanë protestuar pranë zyrave të OSHEE-së për ndërprerjen e energjisë elektrike. Motoja e kësaj proteste ishte: "S'jemi debitor, na riktheni energjinë". Banorë të irrituar me libreza në duar kanë pohuar se nuk janë debitorë, pasi kanë paguar rregullisht energjinë, gjë të cilën e kanë të pasqyruar në libreza, por shumat e lekëve të derdhura prej tyre nuk figurojnë të jenë të regjistruara në sistem nga ana e punonjësve të OSHEE-se.

–"Gjeni faturistët tuaj vjedhës dhe vini ata përpara përgjegjësisë dhe jo të na ndërpritni ne energjinë pasi ne jemi pagues të rregull të saj", kanë thënë banorët gjatë kësaj proteste.

Ndërkohë, një tjetër problem që ngritën banorët ishte edhe ai i pagesave të faturave të energjisë në zyrën postare, të cilët edhe ata në mjaft raste nuk figurojnë të pasqyruara në sistem. "Për të dyja këta raste, thanë banorët, duhet që OSHEE-ja të ndërhyjë për zgjidhjen e kësaj problematike dhe jo të na ndërpresë energjinë, pasi ne i kemi shlyer faturat dhe nuk mund ti paguajmë për së dyti".

Banorët kërcënuan se protestat e tyre do vijojnë deri në rikthimin e energjisë për ta, madje do përshkallëzohen. "Do kërkojmë ndihmë nga Maqedonia për t'u furnizuar me energji, nëse protesta jonë do bjerë në vesh të shurdhër te OSHEE-se si deri më tani", kërcënuan gjatë zhvillimit të protestës banorët.

"Faturistët e OSHEE-së apo ata të postës shqiptare ku ne kemi derdhur lekët, janë të OSHEE, ndaj ajo ti gjejë ata ku i kanë çuar parat që ne kemi derdhur për likuidimin e faturave të energjisë. Qeveria e mbron OSHEE për likuidimin e faturave dhe mirë bën, po ne pse nuk na mbron kur OSHEE-ja na pret pa të drejtë energjinë, pse faturistët e saj apo arkëtarët e postës nuk kanë derdhur lekët që kanë mbledhur prej nesh", thonë banorët.

lajme - Bulqizë

Rikonstruktohet shkolla, premtohen investime të reja në Bulqizë

Bulqizë, 24 Jan. Ministri i Financave, njëkohësisht edhe Deputet i Dibrës, Shkëlqim Cani, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Bulqizës, Myfit Duriçi ka inspektuar më 24 janar punimet e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Xhevded Doda", në këtë qytezë. Shkolla 9-vjeçare "Xhevded Doda" ka rreth 750 nxënës me 33 klasa. Investimi i qeverisë shqiptare kap vlerën e 52 milionë lekëve. Në projektin e ri të shkollës janë parashikuar t'u ndërtuar palestra, fushë futbolli, dhoma sanitare për femra dhe rrethimi komplet i kësaj kompleksit. "Ky investim do të përfundojë së shpejti, tha Ministri i Financave, dhe pas rikonstruksionit nxënësit e kësaj shkolle do të jenë në kushte komode". Gjatë kësaj vizite, deputeti i Dibrës foli edhe për investime te reja në qytetin e minatorëve. Do të ketë një rikonstruksion total të fasadave në qytet si dhe do të ndërtohet edhe një pallat me banesa sociale. Ai theksoi edhe njëherë se Bulqiza do të jetë në qendër të vëmendjes nga qeveria, gjë që u premtua edhe gjatë vizitës së kryeministrit Rama në dhjetor.

Grabiten tre kinezë të ACR, kapen hajdut

Bulqizë, 30 Jan. - Kur bie fjala për shtetasit e huaj, policia lokale në Bulqizë është në krye të detyrës. Tre shtetas kinezë që punojnë për llogari të ACR në Minierën e Bulqizës, kanë rënë pre e grabitjes nga dy persona me maska dhe të armatosur. Ngjarja ka ndodhur gjatë mbrëmjes së datës 29 janar, kur tre shtetasit kinezë kishin zbritur nga miniera, ku dhe banojnë, për në qytet për t'u furnizuar me produkte ushqimore. Ndërsa po ktheheshin në fjetore, atyre u është prerë rruga nga dy persona me maska dhe të armatosur. Grabitësit u kanë marrë atyre gjithçka kishin me vete, të hollat dhe sende ushqimore. Punëtorët kinezë të minierës kanë kundërshtuar, por grabitësit kanë arritur të largohen nga vendi i ngjarjes duke u marrë atyre së paku rreth 10 mijë lekë, thanë burime te policisë lokale. Pas denoncimit, policia e Bulqizës është vënë në ndjekje të tyre, dhe brenda një kohe të shpejtë janë ndaluar shtetasit Selim Rushiti dhe Edison Daka, të cilët ishin fshehur në një shtëpi të braktisur. Sipas policisë, dy të arrestuarve u është gjetur edhe arma automatike me të cilën janë kërcënuar shtetasit kinezë.

zgjedhje lokale

Hidhën para “filxhanëve të kafesë” kandidaturat për bashkitë e Dibrës, Bulqizës, Matit dhe Klosit.

Kandidatët për zgjedhjet lokale - vendosin liderët e partive

Strukturat diskutojnë, forumet përzgjedhin, klanet vendosin

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Duhen edhe disa muaj që partitë të vendosin për kandidatët që do të drejtojnë bashkitë në Dibër. Deri atëherë, shumë kandidatë do të diskutohen në kafenetë dhe bulevardet kryesore të qyteteve.
Por duket se fituesit do të zgjidhen restoranteve të periferisë dhe do të vulosen pranë selive qendrore të partive në Tiranë.

Pas mosmarrëveshjeve mes dy forcave më të mëdhaja politike për ndarjen e re administrative, ishte Gjykata Kushtetuese që e shpalli të vlefshëm ndarjen e re, dhe menjëherë pas saj, Presidenti i Republikës ka caktuar 21 qershorin 2015 se datën e zgjedhjeve të reja vendore. Por ndryshe nga herët e kaluara, kur partitë do zgjidhnin rreth 40 kandidatë në qark, tani ata duhet të zgjedhin vetëm katër, dhe mes ambicieve të rritura të forcave politikë, është e vështirë të gjesh të duhurin, atë që do të fitojë. Kjo për faktin se koalicionet e partive janë të brishta, strukturat e partive nuk janë funksionale edhe në tre partitë që mbushin pushtetin politik në vend, por edhe se klanet e fuqishme brenda partive, herë të biznesit e herë të familjeve të mëdha, rrezikojnë që parashikimet e partive politike ti çojnë dëm në minutën e fundit.

BASHKIA E PESHKOPISË: “LUFTË E FTOHTË” MES PS DHE LSI

Peshkopia do të jetë bashkia më e madhe e qarkut dhe mbetet një ndër më të rëndësishmet në qarkun e Dibrës. Kjo edhe për faktin se prej vitesh ajo qeveriset nga e djathta jo vetëm në qytet, por edhe në pjesën më të madhe të komunave aktuale. Si e tillë, duket se PD është në avantazh, sipas statistikave.

Ilir Krosi, kryetari aktual i Peshkopisë pritet të jetë një kandidaturë e mundshme, por burime pranë kryesisë së PD në Dibër përmendin edhe ish deputetin Rrahim Kaleci, aktualisht kryetar i Partisë Demokratike. Por Partia Demokratike ka një figurë me mjaft ndikim brenda strukturave të saj, që është kryetari aktual i Qarkut Naim Gazidede. Gazidede nuk pritet të kandidojë, por mbështetja e tij për një nga kandidatët do të përcaktojë në të ardhmen se cili do të jetë kandidati i kësaj partie për Peshkopinë.

Ndërkohë Partia Socialiste duket se do ta ketë të vështirë të gjejë një kandidat me ndikim, jo vetëm se prej shumë vitesh strukturat e kësaj partie janë inekzistente, por edhe për faktin se ajo është e detyruar të ndajë pushtetin me Lëvizjen Socialiste për Integrim. Drejtuesit e kësaj të fundit kanë qenë figura kryesore të PS-së, por duke mos gjetur hapësira në atë parti, “u arratisën” drejt LSI-së, duke marrë edhe poste drejtuese.

Zëra pranë drejtuesve lokalë të lidhur me PS-në përmendin deputetin aktual Ulsi Manja si kandidat të mundshëm. Një figurë e përfolur për kandidat është edhe Shukri Xhelili, ish biznesmen, aktualisht drejtor i sigurimeve shoqërore. Por një kandidate e mundshëm mund të jetë edhe zonja Donika Hyseni, aktualisht sekretare e përgjithshme e Prefekturës. Por, duke ditur synimet e LSI për t’u fuqizuar në Dibër, edhe prefekti aktual Milaim Damzi mund të jetë një kandidat i mundshëm, pas një aleance mes LSI dhe PS për zgjedhjet lokale. Megjithatë, duke pasur parasysh se Damzi dhe Manja kanë qenë dy kundërshtarë të fuqishëm brenda Partisë Socialiste, do të ishte e vështirë ekuilibrimi i një fushate të suksesshme për të majtën. Megjithatë, në qytet ndihet atmosfera se Partia Socialiste nuk është shumë e interesuar për Bashkinë e Dibrës, kështu që një kandidate femër do të ishte një kandidaturë e mirë për qytetin, jo vetëm për faktin që do zbehte zërat kundërshtarë brenda partisë, por edhe do plotësonte statistikat e partisë socialiste për kandidaturat femra, në respekt të kodit zgjedhor.

BASHKIA E BULQIZËS: PS E VENDOSUR TË RUAJË QEVERISJEN

Gara për marrjen e bashkisë së Bulqizës, pritet të jetë nga më të fortat, si për nga emrat garues brenda dy koalicioneve, sidomos atij të majtë, mes PS-së dhe LSI-së. Pesha specifike për marrjen e kësaj bashkie, nga secila prej forcave politike garuese, duket se rritet ndjeshëm për shkak të Minierës së Kromit Bulqizë, më e madhja në vendin tonë, e cila mban peshën kryesore të eksporteve në vendin tonë.

Emri më i përfolur nga PS-ja për në krye të listës garuese për Bulqizën mbetet kryetarit aktual i kësaj bashkie, Myfit Duriçi, i cili nuk i fsheh ambiciet për këtë post, ashtu si shumë të tjerë. I pyetur nëse do të pranonte të ishte kandidat i PS-së për kryetar të Bashkisë Bulqizë ai thotë:

“Natyrisht se po! Nëse do propozohem nga strukturat e bazës të PS-së, do pranoj për të vijuar punën që kam nisur prej dy vitesh në një gjysmë mandati në krye të kësaj bashkie. Edhe pse në një kohështrirje të vogël vetëm rreth 2 vite, në drejtimin e Bashkisë Bulqizë, kemi realizuar investime mbreslënëse, të cilat i vlerësoi edhe vetë Kryeministri Rama gjatë një vizite që bëri në qytetin tonë në fundin e dhjetorit të kaluar”. Ndërkaq, brenda strukturave të PS flitet edhe për një kandidat tjetër të mundshëm , ajo e Rakip Hoxhës, i cili është njohur si një ish administrator i mirë në krye të Degës së Raiffeisen Bank në Bulqizë. Të dy këta kandidatë do të kenë më parë se 21 qershori një përballje me kandidatët e LSI, parti e cila ka marrë një kandidat për deputet për zgjedhjet parlamentare në këtë bashki. Vëllai i deputeti Përparim Spahiu, Ylli Spahiu - aktualisht Drejtor i Shërbimit të Transportit Rrugor, përflitet si një kandidat i mundshëm, por që ka pak gjasa të zgjidhet me propozim nga baza e partisë. Por në qoftë se Partia Socialiste ia lë Bulqizën LSI-, gjithçka mund të ndodhë: edhe deputeti mund të lërë mandatin për të konkurruar për Bashkinë e Bulqizës. Ndërkohë, kryetari i Degës së LSI-së Bulqizë, Ilir Balla, nuk e ka përjashtuar mundësinë e kandidimit. I pyetur nëse do të ishte emri i tij një kandidaturë e mundshme, ai ka lënë të kuptohet se vendimin për një kandidim të mundshëm të tij e kanë në dorë strukturat e Degës së LSI-së Bulqizë.

Partia Demokratike mund të vendosë Durim Ballën si kandidat, aktualisht kryetar i PD për Bulqizën. Në Bulqizë flitet edhe për kandidatë të tjerë të mundshëm, por duke pasur parasysh se Balla ka fituar drejtimin e PD me më shumë se 100 vota diferencë, çdo kandidat tjetër do ta kishte të vështirë ta vendoste emrin në listën e zgjedhjeve të 21 qershorit.

BASHKIA KLOS: PD KËRKON KANDIDAT FITUES

Një nga emrat më të përfolur për të vënë kandidaturën për Bashkinë e Klosit nga Partia Socialiste është Hashim Doma, ish kandidat për deputet i kësaj partie në zgjedhjet e 23 qershorit 2013-të. Ndërsa LSI mund të përfitojë nga kandidatura e saj femër për t’ia marrë PS kandidatin. Lutfie Meta është kandidatura e LSI dhe ka shumë gjasa të jetë përballë kandidaturës së Partisë Demokratike. Kjo e fundit mund të vendosë Bedri Hoxhën kandidat, aktualisht deputet, por një kandidat tjetër është edhe Basir Çupa, ish drejtor i postës së Burrelit. Nga Partia Demokratike thonë se PD do ta ketë të sigurtë fitoren në këtë bashki.

BASHKIA BURREL: GARË E FORTË BRENDA PS

Adelina Farriçi, kryetarja aktuale e bashkisë është kandidatura më e mundshme brenda Partisë Socialiste. Jo vetëm se ajo ka qenë e suksesshme në një qytet ku mbizotëron politika e burrave, por edhe se ka mbështetjen e kryetarit të Partisë Socialiste dhe ambasadave të huaja në vend. Shumë prej ambasadorëve e kanë shprehur hapur mbështetjen për kryetaren Farrici gjatë vizitave të tyre në Burrel. Ajo i ka kthyer qytetit një zhvillim stabël dhe ëndrrën për të qenë një qytet me perspektivë. Por, Adelina Farriçi para se të rikandidojë, duhet të fitojë betejën me kryetarin e degës së PS, Hasan Ceni, mjek, i cili, megjithëse ishte i treti në listën e Partisë Socialiste në zgjedhjet e përgjithshme, nuk arriti të zgjidhej deputet. Ceni mund ta kishte marrë postin e deputetit, pas tërheqjes së Shkëlqim Canit, i cili mori portofolin e Ministrit të Financave, por planet nuk rrodhën ashtu siç priteshin. Kjo për shkak se Cani nuk dha dorëheqjen, por edhe nëse ai do ta jepte, ishte një grua që do të zinte vendin e tij, kështu që Hasan Ceni nuk mund të ulej në një vend në parlamentin shqiptar. Një procedurë e ngjashme, si në rastin e Lezhës, mund ta çonte Cenin në Parlament, por ajo që ndodhi me rastin e Lezhës u kuptua si një makinacion i turpshëm, kështu që PS nuk ia lejoi vetës të bënte të njëjtën gjë me rastin e Dibrës. Edhe për faktin se Ezmerina Hoxha gëzon shëndet të plot.

LSI ka kryetarin aktual të partisë në qytet Agim Hysën, një biznesmen i njohur, por që do ta ketë të vështirë t’u dalë para kandidatëve të PS, gjithmonë në qoftë se aleanca PS-LSI do të jetë funksionale.

Partia Demokratike në Burrel, ndryshe nga ajo në Peshkopi, shfaqet shumë e tërhequr. Debati për kandidatët pritet të ndizet me dhënien e urdhrit nga lart. Megjithatë, brenda kryesisë thonë se Nezir Rizvani, me profesion financier, mund të jetë kandidat i mundshëm.

***

Partitë politike në përzgjedhjen e kandidaturave deri më tani bazohen vetëm mbi atë se si funksionojnë partitë aktualisht. Ndërkohë, pritet një përzgjedhje emrash sipas strukturave, dhe formalisht, një votim brenda partive do të zgjedhë kandidatët. Por duket se, ashtu si për rastin e deputetëve, edhe për kryetarët e bashkive të reja, do të jenë grupimet e fuqishme brenda partive që do përzgjedhin kandidatët, dhe më pas kryetarët e partisë në qendër do të vendosin për kandidatët.

Një organizatë joqeveritare në Tiranë, që prej vitesh ka marrë në shqyrtim punën dhe administrimin e të zgjedhurve vendorë në veri dhe verilindje të vendit, thotë se atmosfera politike është shumë e ngarkuar në këto qarqe. Sipas drejtuesit të kësaj organizate të njohur, i cili nuk dëshiron të japë të dhëna për momentin, thotë se kandidatë të panjohur deri më tani nga forcat politike do ta bënin më të pranueshme situatën para zgjedhore dhe pas zgjedhore, si dhe do të rrisnin besimin në një qeverisje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Një grupim brenda Partisë Demokratike në Dibër ka hapur një faqe në FB dhe kërkon që kandidati i saj i ardhshëm të jetë Edmond Hasani, një intelektual pranë PD në Peshkopi, që megjithëse i shpreh hapur bindjet e tij politike, shpesh të ekstremit të djathtë, është shumë pragmatist dhe i pranuar nga qytetarët. Hasani në kohën e lirë shëtit në malet përreth dhe në qytet dhe bën shumë fotografi, ku pastaj i përcjell përmes rrjeteve sociale dhe në këtë mënyrë ka shumë mbështetës. Ai ka një kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarët, është shumë kritik, por edhe ka një dashuri të madhe për qytetin dhe njerëzit e saj.

Edhe Partia Socialiste mund ta gjejë një kandidat me vizion për bashkinë, - thotë një anëtar i PS në qytet, i cili megjithëse është i pakënaqur për mënyrën se si PS po e administron pushtetin në Peshkopi, beson akoma se Edi Rama do ta rregullojë qeverisjen. Ai thotë se Hysen Uka, një profesor i Studimeve Evropiane, mund të jetë një kandidat që mund të pranohet nga strukturat e partisë, por edhe nga populli jashtë klaneve partiake. “Ai është refuzuar dhunshëm për vite me radhë të jetë pjesë e stafit akademik të Universitetit të Peshkopisë, filial i “Aleksandër Moisiut”, - thotë një anëtar tjetër i PS. Ai nuk është pranuar për shkak se nuk pajtohet me politikat “gjobvënëse” ndaj studentëve dhe me mënyrën se si stafi drejtues i Universitetit ka drejtuar deri më tani këtë filial”. Uka ka punuar për disa vite gazetar në vitet 1990-1997 dhe është i pari që ka iniciuar çështjen e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Për këtë shkak, njerëzit besojnë se ai do ishte një kandidat i mirë për bashkinë e Peshkopisë dhe do të kishte mbështetje, kryesisht nga pjesa e votuesve që i bojkotojnë zgjedhjet.

Duhen edhe disa muaj që partitë të vendosin për kandidatët që do të drejtojnë bashkitë në Dibër. Deri atëherë, shumë kandidatë do të diskutohen në kafenetë dhe bulevardet kryesore të qyteteve. Por duket se fituesit do të zgjidhen restoranteve të periferisë dhe do të vulosen pranë selive qendrore të partive në Tiranë.

Peshkopi: Topi i FRD-së “ia fut me top” PS-së dhe PD-së!

Bamir Topi, kryetari i Partisë Fryma e Re Demokratike, ka zgjedhur Peshkopinë për t’i rënë me top dy partive që kanë ndërruar pushtetin në këtë periudhë tranzicioni.

“Dy partitë politike po mbajnë peng vendin”, u tha ai militantëve të partisë së tij në Peshkopi.

“Shikoni, theksoi Topi, në orën 11.30 minuta bulevardin e Peshkopisë e pashë të mbushur plot me njerëz që bënin xhiro, pasi janë të papunë. Njerëzit vazhdojnë të mbajnë shpresat tek politika, e cila në vazhdimësi i mashtron ata.

Ndaj u bëj një thirrje të ridimensiononi vështrimin tuaj politik. Mos u shkoni mbrapa PS-së dhe PD-së, që politika të mos mbetet domen i dy-tre vetëve, që pastaj edhe ekonomia të mos mbetet domen i dy-tre monopoleve”.

Më pas kryetari i Frymës së Re Demokratike ka folur për zgjedhjet e ardhshme lokale, veprimtarinë e KQZ dhe mënyrën se si kjo forcë politike do të hyjë në zgjedhjet vendore.

“Brenda moralit tonë që përfaqësojmë, ju garantoj se ne si forcë politike do të përfaqësohemi në këto zgjedhje me përfaqësuesit më të denjë të partisë”, theksoi kryetari i FRD, duke mos nxjerrë asnjë emër për kandidatët lokalë.

Në këto takime, Bamir Topi shoqërohej nga nënkryetari i partisë Gazmend Oketa dhe sekretarët Sali Shehu dhe Sami Gjergji.

Me rastin e 547 vjetorit të vdekjes shfaqet dokumentari që i kujton Europës se shqiptarët janë pjesë natyrale e saj dhe kanë luftuar me shekuj për këtë ëndërr.

dokumentar

"Skënderbeu i pagjumë" për fatet e këtij kombi

Nga **SASHENKA NDREKA**



Në këtë dokumentar heroi ynë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu vjen i pagjumë për fatin e shqiptarëve edhe në agimin e mijëvjeçarit të tretë. Troku i kalit të tij troket në dyert e Europës si një mik i madh i vjetër. Ai bisedon me humanistët e mëdhenj europianë si Bajroni e Edit Durham...

"Skënderbeu i pagjumë" erdhi në sallën e kinemasë së Arkivit Qendror të Filmit në Tiranë më 19 janar, në një periudhë mjaft delikate për vendin tonë. Pikërisht në kohën kur politikanët po bëjnë çmos për të rritur bashkëpunimin midis tyre, për rrugëtimin e përbashkët drejt familjes së madhe europiane, Angjelina Xhara dhe Bujar Kore sjellin dokumentarin "Skënderbeu i Pagjumë". Dy veteranët e Televizionit Publik Shqiptar, nën konsulencën e studiuesit Moikom Zeqo, risjellin në kujtesën e shqiptarëve, atë që nisi pesë shekuj më parë heroi ynë kombëtar, ëndrrën europianie.

Tema e këtij dokumentari është përjetimi artistik që i kanë bërë brenda e jashtë vendit tonë, figurës legjendare të Gjergj Kastriot Skënderbeu. Ka mbi 600 vite që shkruhen libra për të! Kryeqytet europiane mbajnë krenarinë e Heroit Shqiptar, përmes monumenteve e busteve të tij. Muze të njohur në botë kanë piktura monumentale me figurën e kryetrimit të pamposhtur. Gravura madhështore shprehin me një nivel të lartë artistik betejat legjendare. Për Skënderbeun janë bërë filma dhe janë kompozuar edhe pjesë muzikore deri opera...Nga Vivaldi, Fransua Franse e Fransua Rabële deri tek Abdulla Grimci

Në këtë dokumentar heroi ynë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu vjen i pagjumë për fatin e shqiptarëve edhe në agimin e mijëvjeçarit të tretë.

Troku i kalit të tij troket në dyert e Europës si një mik i madh i vjetër. Ai bisedon me humanistët e mëdhenj europianë si Bajroni e Edit Durham, apo piktorët Rembrand e Delacrue, e sa e sa të tjerë miq që përhapën kudo famën e tij si mbrojtësi i Europës e Krishtërimit, që në shekullin e XV.

Në arkivat e Europës studiuesit e huaj e historianët flasin me fjalët më të zgjedhura për prijësin tonë të madh. Gjenerali Xhejms Uollf thotë: "Skënderbeu shkëlqeu midis gjithë gjeneralëve të kohërave të vjetra e të sotme, si një udhëheqës i madh i një ushtrie të vogël mbrojtëse", ndërsa historiani Zhan Filip Falmerajen pohon: "Gjergj Kastrioti është një nga kryeluftëtarët më të përkryer, më faqebardhë e më të mëdhenj të botës".

"Duke pasur këtë objekt kompleks për filmin, ne duam të tërheqim vëmendjen, duke u mbështetur veçanërisht në portretin madhështor të Skënderbeut mbi kalë, se ai është i gjallë dhe shumë veprues në këtë fillim të mijëvjeçarit të tretë, kur Shqipëria troket në Europë. Skënderbeu është i pagjumë për fatet e këtij kombi... Ai është ndërmjetës i madh sepse është mik i vjetër i Europës.

Për 25 vjet rresht Skënderbeu mbrojti qytetërimin europian dhe krishterimin nga pushtimi osman, me beteja fitimtare të zhvilluara në trojet shqiptare, përmes bashkimit të princërve shqiptarë dhe heroizmit të një ushtrie e populli të vogël që kreu një detyrë te madhe" -shprehet autorja ndërsa e pyesim për arsyen e zgjedhjes së titullit.

Ndërsa shijoj e përlotur duartrokitjet e pafundme në përfundimin e kësaj premiere, ndihem pafund e lumtur për vendlindjen time, që lindi një njeri kaq të madh...

Kush është Angjelina Xhara Papalilo?

Ajo lindi në Tiranë në vitin 1949. Nga viti 1969 deri në vitin 1977 ka qenë një nga spikeret e para të lajmeve në Televizionin Shqiptar përkrah Kiço Fotiadhit. Pas studimeve për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës filloi punë në Kinostudio dhe realizoi skenarët e dhjetëra filmave kronikalë e dokumentarë me temë, kulturore, historike dhe shkencore popullore.

Gjatë viteve të punës në Kinostudio Angjelina kreu një kurs pasuniversitar për skenariste e kritike filmi dhe teatri. Skenarët e saj për filmat "Piktura mesjetare shqiptare" dhe "Profesor doktor Aleksandër Xhuvani" kanë marrë çmime në festivale të filmit. Filma të tjerë si "Onufri", "Piktori Buza", "Veshjet popullore", "Fëmijët tanë një këngë e bukur", janë shfaqur me shumë sukses në aktivitete filmike jashtë atdheut.

Në vitet e demokracisë emigroi në Greqi ku u aktivizua në faqet e shtypit shqiptar atje por edhe si spikere në edicionet e lajmeve në gjuhën shqipe në Radion greke të Bashkisë së Athinës "9.84", duke punuar për shtatë vjet radhazi.

Vitet e fundit, Angjelina Xhara është marrë me letërsi duke botuar romanin e saj të parë "Enigma" me temë nga emigracioni. Romani ka marrë çmim në konkursin kombëtar të shpallur nga Shtëpitë botuese "Toena" dhe "Onufri". Sapo ka dalë nga botimi libri "Margarita e artë", kushtuar Artistes së Popullit Margarita Xhepa dhe ka gati për botim librin "Personalitete femërore shqiptare në kinematografi". Gjithashtu, Angjelina ka përkthyer librin e Alberto Moravias "Gruaja leopard" që u prit me shumë sukses nga lexuesit. Pas kthimit nga emigracioni realizoi, si skenariste, disa filma dokumentarë për një kohë të shkurtër, si: Kthim në Redina, Pak diell edhe për ne, Lirikë shpirti, Vatra e shqiptarëve të Amerikës, Margarita..., Skënderbeu i pagjumë.

Angjelina Xhara është vlerësuar me Medaljen "Naim Frashëri" dhe është zgjedhur "Ambasadore e Paqes" nga Organizata Ndërkombëtare e Paqes.

Peticioni për rrugën e Arbrit vazhdon të firmoset

Përse edhe tani Edi Rama nuk pranon të takohet me intelekualët dibranë?

Jan 28, 2015 — Të nderuar Miq dhe Kolegë,

Ju lutemi inkurajoni sa më shumë miq dhe kolegë të nënshkruajnë peticionin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

Tani për tani, i vetmi njoftim 'zyrtar' nga Qeveria e Shqipërisë se fondet për këtë projekt u siguruan nga Kina, u përcuall nga z. Edi Rama në Facebook nga Beogradi më 16 dhjetor 2014.

Peticioni ynë ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Ne do të vazhdojmë t'i bëjmë presion Qeverisë që të jetë transparente në menaxhimin e fondeve, dhe që ta përfundoj këtë vepër, siç është premtuar, brenda këtij mandati dhe në përputhje me stadarded ndërkombëtare.

z. Rama vazhdon të refuzojë kërkesën e intelektualëve dibranë për tu takuar me të për t'i dorëzuar peticionin. Për hir të transparencës, së shpejti do të bëjmë publike një shkëmbim emailesh me z. Rama në lidhje me këtë çështje.

Me respekt,
Gëzim Alpion



Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections

Complete the construction of the Arbëri Road - Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit

Sign this petition
with 4,440 supporters

560 NEEDED

First Name
Last Name
Email
City
Why is this important to you? (Optional)

Sign ›

Display my signature on Change.org

By signing, you accept Change.org's terms of service and privacy policy.

Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

monografi

Studiuesi Xhezair Abazi po përgati monografinë antologjike kushtuar Haki Stërmillit, e cila pritet të dalë nga botimi me rastin e 120 vjetorit të lindjes

Haki Stërmilli - *Jeta luftë, frymëzimi aty*

Nga **XHEZAIR ABAZI**

Më 7 maj 2015 është 120-vjetori i lindjes së Haki Stërmillit. Është përvjetori i një shkrimtari e personaliteti kombëtar që jetoi vetëm 58 vite. Vdiq më 17 janar 1953, duke qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe drejtor i të parit Muze Historik Shqiptar. Vërtet nuk jetoi gjatë, por pati një jetë intensive private, shoqërore dhe krijuese për ta patur zili edhe më jetëgjati...

I lindur në Shehër të Dibrës së Madhe, kryen këtu shkollën fillore dhe atë Ruzhdie (turke). Me kujdesin e Dervish Himës dhe Hoxhë Vokës, djaloshi shkon në Gjimnazin e Manastirit. Është pikërisht periudha kur në këtë qytet u mbajt Kongresi i ABC-së dhe vepronte Komiteti i Fshehtë i Kryengritjes Kombëtare i udhëhequr nga Bajo Topulli.

Në vitin e Pavarësisë Hakiu mbaron gjimnazin, por më 1913 në Dibrën e tij pushtuesit serbë dogjën mijëra shtëpi e vranë mijëra njerëz... Ndaj dhe familja e tij, si mijëra të tjera, u shpërngul duke lënë qytetin e lindjes të përzhitur...

Fillimisht në Elbasan, pastaj në Durrës e Mat, ai punon nw administratën e shtetit të ri shqiptar. Me sa duket, në Mat ai u njoh dhe u afrua me bashkëmoshatarin e tij Ahmet Zogolli, sepse pas Kongresit të Lushnjës, Hakiu emërohet me detyra të rëndësishme, deri Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, ku ministër ishte Ahmet bej Zogolli.

Kur Ahmet Zogolli mëson se nëpunësi i tij i lartë kishte lidhje me grupe të rinisë përparimtare, për ta "lidhur" pas vetes, i propozon fejesë me njërën nga motrat e tij. Stërmilli nuk pranon. Ahmet Zogolli e pushon nga puna...

Stërmilli shkruan në "Autobiografi": "Shpejt fillova me i diktue intrigat e tij, të cilat ma vonë e çuen në tradhti".

Stërmilli, u bashkua me lëvizjen demokratike të rinisë. Ai u zgjodh sekretar i përgjithshëm i shoqërisë "Bashkimi" kryetar i të cilës ishte Avni Rustemi.

Tanimë Zogu e shpall armik, derisa më 1929, forcat e xhandarmërisë serbe e rrëmbejnë pabesisht emigrantin politik Haki Stërmilli dhe ia dorëzojnë mbretit. Këto akt të rëndë e denoncon me një peticion Kongresi i Dytë Botëror për çlirim kombëtar e paqe (mbledhur në Frankfurt), "kundër torturave çnjerëzore të kryera mbi të burgosurin politik". Kjo protestë u nënshkrua nga emra të mëdhenj si N. Barbys, A. Ainshtajn, S. Katajama, deputetë e profesorë të shquar nga e gjithë bota.

Duke qenë i lidhur me krahun Demokratik dhe Qeverinë e Nolit, pas rrëzimit të tij merr rrugën e emigrantit politik. Fillimisht në Itali e Francë, pastaj në Rusi, ku punonte për sigurimin e bukës së gojës dhe, si anëtar i hershëm i KONARE, zhvillonte veprimtari politiko-shoqërore, botonte në "Federasion Ballkanik", "Liria kombëtare" etj. Pikërisht për këtë e burgosën në Vjenë dhe pastaj e dëbuan nga Austria.

***

Veprimtar e shkrimtar që vazhdoi frymën e rilindësve tanë, që krijoi vepra të denja në periudhën e Pavarësisë dhe deri pas Luftës së Dytë Botërore. H. Stërmilli krijoi një vijë goxha të gjatë procesi krijues dhe estetik, ku dallohet veçanërisht lidhja e veprës letrare me rrjedhën e kohës, me zhvillimin e gjinive, me drejtimet e tij letrare që, e botuar dhe në dorëshkrim, arrin në mijëra faqe. Veç të tjerash, të bën përshtypje raporti midis rrjedhave reale të kohës dhe reflektimi në fjalën letrare. Jeta dhe krijimtaria e këtij shkrimtari ka një diagrame të veçantë, unike. Madje është vështirë të gjesh ndonjë shkrimtar shqiptar të shek. XX që të ketë, një vijë jete e krijimtarie aq të pasur e dinamike, të dhimbshme e dramatike. H. Stërmilli është nga autorë të rrallë, jeta dhe vepra e të cilit kanë një unitet dhe harmoni të rrallë ideoartistike.



***

Uniteti dhe vijimësia e një jete dhe procesi krijues të H. Stërmilli janë gjithashtu mishërim i një dukurie unike. Që nga skicat dhe tregimet e para, shkruar në moshën djaloshare e deri te radhët e dorëshkrimit, të tij të fundit, ndihet edhe regëtima, edhe pluskimi i fortë i shpirtit të njeriut të thjeshtë, i Atij që si Atlanti mban mbi shpatulla Jetën dhe bën Historinë...

Duke bërë ngaherë jetën e njeriut të thjeshtë të punës e halleve, të mërgimtarit politik e të burgosur me vite, duke njohur e përjetuar rravgimet popullore, doemos që në veprën e tij do të sillte dramatizimin dhe tragjizmin, trishtimin e dhimbjen, vuajtjen dhe brengën...

***

Tipari më dallues në Veprën e H. Stërmillit është rezonanca me kohën. Jo vetëm në ditarët letrarë, që janë në thelb sizmograf i kohës por edhe në veprat dramatike, tregimet e romanet – ndihet qartë gurgullima dhe jehona e ngjarjeve të kohës, tallazet nëpër të cilat "vozit" shoqëria shqiptare... Ndien vuajtjen dhe brengën e pamundësisë për një jetë të denjë njerëzore në Liri, trishtimin e humbjes në luftë kundër pushtuesit, erën e rëndë të barutit dhe tymit të luftës e djegies së shtëpive stërgjyshore. Në dramat e H. Stërmillit ndihet veçanërisht shpirti tragjik i luftëtarit, i cili e sheh krijimin e familjes të lidhur ngushtë me lirinë kombëtare dhe fatet e atdheut...

Romani i mirënjohur i Stërmillit "Sikur të isha djalë", një "bestseller" i vërtetë i letërsisë shqiptare në dekadat e mesit të shek. XX, ishte një apoteozë e fuqishme për lirinë njerëzore në përgjithësi dhe lirinë e femrës në veçanti... Në vitet '30, në vitet '50, dhe deri në vitet '90 të shekullit që shkoi – romani u botua e ribotua mbi 10 herë, duke shënuar një rekord të papërsëritshëm të tirazhit në raport me popullsinë e vendit... Romani vinte gishtin në plagën më të dhimbshme të jetës sociale shqiptare – fatin dhe jetesën e femrës shqiptare, tragjizmin e saj – çka e shohim të shfaqet në mënyrë të thukët edhe në dekadat e shekullit 21.

***

Pjesëmarrës aktiv në lëvizjet e shtresave përparimtare të shoqërisë, H. Stërmilli krijoi në rrymën e letërsisë demokratike, duke e kuptuar artin e fjalës si forcë për shndërrim progresist të shoqërisë dhe jetës së njeriut. Pikëpamjet e tij politiko-shoqërore ishin në kundërshtim të hapur me ato të rrymave feudoborgjeze e klerikale. Ndërsa përfaqësuesit e rrymave idealizuese të jetës patriarkale të malësisë shkruanin për zana e shtojzovalle, apo ekzotikë alpine, Stërmilli (ashtu si Migjeni dhe Koliqi- ishte kundër këtij idealizimi – farsë, ishte për zbulimin e kontradiktave të kohës, kundër shtypjes e shfrytëzimit social, kundër mbizotërimit të jetesës nga klasa feudale e bajraktare, kundër kolonializmit dhe penetrimit të kapitalizmit fashist në Shqipëri...

Konceptet e bindjet sociopolitike të H. Stërmillit dhe vetë vepra e tij letrare, dëshmojnë prirjen e në drejtime letrare si romantizmi përparimtar dhe realizimi kritik. Këtë e dëshmojnë edhe disa artikuj të tij në shtypin e kohës për autorë të veçantë apo dukuri të ndryshme letrare-artistike. Duke lexuar shkrimet e tij për Hygoin, Sami Frashërin apo Ndre Mjedën, ndihet qartë admirimi për romantizmin dhe realizmin kritik. Veçanërisht te Mjeda duke bërë një analizë të shpejtë të veprës së tij, thekson se ky poet "nuk këndoi lavdinë e feudalëve e bajraktarëve", por "ngriti lart e i këndoi me pasion popullit, punëtorisë, natyrës së egër por të bukur shqiptare, lirisë e përparimit".

***

Që vepra letrare e H. Stërmillit, ngrihet mbi një shtrat realist, flet së pari mënyra e vështrimit të proceseve dhe dukurive shoqërore dhe reflektimi i tyre në fjalën letrare. Lënda e veprës letrare të këtij shkrimtari përparimtar sjell periudha, sociohistorike, ngjarje, fakte, heronj e karaktere që mbartin intensitet të lartë ideoemocional. Notat sentimentaliste janë episode midis masës mbitëzoruese të së vërtetës artistike realiste, çka do të argumentohet në studimin që po përgatitet për botim.

Që vepra letrare e H. Stërmillit, ngrihet mbi një shtrat realist, flet së pari mënyra e vështrimit të proceseve dhe dukurive shoqërore dhe reflektimi i tyre në fjalën letrare. Lënda e veprës letrare të këtij shkrimtari përparimtar sjell periudha, sociohistorike, ngjarje, fakte, heronj e karaktere që mbartin intensitet të lartë ideoemocional. Notat sentimentaliste janë episode midis masës mbitëzoruese të së vërtetës artistike realiste, çka do të argumentohet në studimin që po përgatitet për botim.

Duke bërë ngaherë jetën e njeriut të thjeshtë të punës e halleve, të mërgimtarit politik e të burgosur me vite, duke njohur e përjetuar rravgimet popullore, doemos që në veprën e tij do të sillte dramatizimin dhe tragjizmin, trishtimin e dhimbjen, vuajtjen dhe brengën...

Ftesë për sponsorizim

Studiuesi Xhezair Abazi po përgatit një monografi antologjike për Haki Stërmillin! Ftohen biznesmenë dhe qytetarë atdhetarë që ta mbështesin botimin e kësaj monografie me rastin e 120-vjetorit të lindjes.

Për më shumë informacion kontaktoni autorin ose mund të na shkruani në adresën e emailit të gazetës!

Faleminderit!

Bëj reklamën tënde duke filluar **me 1000 lekë**

AlpJon ALBANIA
Address: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kati II.
Tiranë, Albania
Mob: +355 (0) 67 47 32 492
E-mail: info@alpjonalbania.com
Web: www.alpjonalbania.com

BLERTA METHASANI
photographer
Mob. 069 88 55 999
E-mail. blerta.methasani@gmail.com
FB: Blerta Methasani Photography
Wedding, Event
Potraits & More

KLINIKË DENTARE
Manjani
Cel: **068 20 57 461** *Tel:* **+355 4 22 61 686**
E-mail: **klinikamanjani@gmail.com**
Adresa: **Rr."M. Gjollesha", P.56, Shk.2, Tiranë**

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për vitin e ardhshëm disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email **mbbotime@gmail.com, rrugaearberit@gmail.com** ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603.**
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi:
Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës:
Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi:
tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.** ***Tel:*** **068 22 46 400**

MANI STYLE
-hair diffusion ■■■■
Sallon bukurie
STILIST ME EKSPERIENCË ITALIANE
Rr. "Myslym Shyri", përballë Albtelecom-it
Tel. (04) 22 444 87. Cel. 067 23 38 068
Manistyle

KËTU MUND TË ISHTE REKLAMA JUAJ PËR VETËM 1000 LEKË

Agromarket "ÇERA"
Agromarket ÇERA
◆ Farmaci Bujqësore ◆ Shërbime Higjeno-Shëndetësore
◆ Prodhim Fidanësh & Farnash ◆ Lule Dekorative
Ing. Agr. **BESNIK ÇERA**
Mob: **068 25 22 632**
E-mail: **agromarket.Alcera@gmail.com**

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI BOOK HOUSE PESHKOPI
LIBRI PRANË JUSH
LIBRARIA FLETA XXI,
PRANË MUZEUT, PESHKOPI

OFROJMË
redaktime - korrigjime
ftesa - fletëpalosje
fotokopje - kartvizita
printime - lidhje libri duke filluar nga 1 kopje e vetme!
Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:
http://saveriverradika.com

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë për Peshkopinë dhe Dibrën e Madhe.

Gjithashtu, gazeta ofron hapësirat për botim për të rinjtë që duan të prezantohen në fushën e gazetarisë.

Për më shumë informacion mund të shkruani email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>** ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603.**
Redaksia

profil



Mësuesja që flet me pikturën

Nga **ILMI DERVISHI**

Lidia vjen nga një familje dibrane, me prindër shembullorë e shumë punëtorë, që si motiv kanë punën e këtë ndjenjë ia kanë kultivuar edhe Lidias. Talentin e pikturës ajo e ka trashëguar nga i ati, Trifoni, i cili ka të njëjtin fat, pra, edhe ai nuk dëgjon e nuk flet... Edhe dy xhaxhallarët, njëri prej tyre ka mbaruar liceun artistik e sot, krahas punës, merret edhe me pikturë në Itali. Lidia ka lindur me pikturën. Në klasë të shtatë talenti i saj u kurorëzua me piktura të realizuara prej saj. E angazhuar me aktivitete shoqërore, e talentuar në punën e saj në pikturë, me fantazi dhe kombinim të ngjyrave e jo e privuar nga rrethanat e fatit. Fillimisht u kualifikua në punimet e saj në një kurs rrobaqepësie me stilisten Mirela Nurçe. Mirela shpjegonte, se me intuitën e saj ndiqte vetëm me sy se si skiconte Mirela. Asnjëra nga vajzat që ishin në kurs nuk e kapi shpjegimin, ndërsa Lidia kishte skicuar atë që ajo shpjegonte. Ajo vetë bënte përpjekje në maksimum për t'i kuptuar gjërat, dëshirat e saj ishin të mëdha.

Që Lidia kishte talent dukej në çdo vizatim të saj, por ajo kishte dhe pasionin dhe këmbënguljen për të mësuar më shumë, e kështu që Lidia duhej të vazhdonte pikturën.

Ishte profesori Ermir Grezda, që me syrin e tij artistik u përpoq ta ndihmonte dhe ta orientonte që të merrej me pikturë.

Erdhi dita e konkurrimit dhe ne vendosëm të takonim drejtorin, z. Bujar Agalliu, për t'i sqaruar rrethanat e vajzës dhe për ta pyetur nëse kishte ndonjë kriter për këta persona. Ai tha se kriteri i vetëm, si për të gjithë të tjerët, ishte konkurrimi. Kështu Lidia u fut në konkurs dhe u gjend para jurisë, e cila e pyeste, por ajo nuk dëgjonte e nuk fliste dot me ta...

Lidia më ka treguar:

"Një mendim më thoshte ta lija këtë punë e të ikja, se e shihja të pamundur të vazhdoja... Si do të bëja? Askush nuk komunikon me mua! Por në kohën që isha në këtë dilemë, më dha forcë e kurajo një person që kaloi të gjithë nxënësit. Ai ndaloi tek unë dhe, duke më vënë dorën në sup, më tha: "Je Ok!". Ajo dorë në sup dhe ajo buzëqeshje më shoqëroi edhe më vonë, derisa mbarova provimin... Doli që kisha fituar e kështu peripecitë e tjera: regjistrimi, marrëdhënia me shokët e klasës që dëgjonin e flisnin, kurse unë isha vetëm, por falë Zotit kam pasur fat që të kem shokë e miq të mirë, si shoqja ime e ngushtë Ori Ivo, Anisa Ada e shumë e shumë të tjerë.

Shkolla vazhdoi me shumë sakrifica... Diçka më shpjegonin shoqet e diçka pedagogët se unë nuk pata asnjëherë interpreto. Në vitin e dytë të Liceut, në vitin 2006, një mësuesja ime më tha të dërgoja një pikturë në Amerikë, me fondacionin e zonjës Liri Berisha. As që e mendoja se do të fitoja, por erdhi lajmi që piktura ime kishte fituar në 52! U habita e u gëzova pa masë... Pas fitores ju dërgua një falënderim shkollës që më kishte mësuar mua. Aty më vlerësuan e më dhanë një rëndësi tjetër të gjithë pedagogët, duke më mësuar. Atë ditë u shtrua një koktej në ambientin e shkollës. Në këtë event erdhi personalisht Liri Berisha. Ishte një gëzim për të gjithë shkollën e në veçanti për mua dhe fjalët e saj më kanë shoqëruar edhe në vitet e mëpastajme. Një mirënjohje e veçantë shkon për këtë grua, me dorën e kujdesin e së cilës u ndjeva e sigurt në rrugën e vështirë të jetës. Znj. Liri Berisha, e cila erdhi për të më dhënë çmimin që kisha fituar, më premtoi se ajo vetë do të kujdesej që unë të vazhdoja edhe Akademinë. Edhe në Akademi më shoqëruan shokët e Liceut e për tetë vjet rresht ata mësuan edhe gjuhën e shenjave. Kam pasur vështirësi edhe me disa pedagogë, por për mua kanë qenë një ankth i vërtetë orët e provimeve. Ka pasur raste që edhe nuk më kuptonin, vështirësitë me orët e vendet e takimeve. Pastaj dolën telefonat e m'u lehtësuan disa gjëra...

Në këtë ditë të personave me aftësi ndryshe e ngre zërin që kjo kategori të vlerësohet më shumë në çdo fushë, të ketë interpreto në shkollat që ndjekin e t'u jepet mundësia të jenë të barabartë mes të barabartëve dhe të punësohen."

Në këtë ditë të personave me aftësi ndryshe e ngre zërin që kjo kategori të vlerësohet më shumë në çdo fushë, të ketë interpreto në shkollat që ndjekin e t'u jepet mundësia të jenë të barabartë mes të barabartëve dhe të punësohen."

Lidia ka marrë pjesë edhe në aktivitete të tjera, në një ekspozitë në Itali, Estoni dhe këto në Tiranë, ku është vlerësuar me çmime. Studentja e Akademisë së Arteve të bukura që mbaroi edhe masterin, vajza e talentuar me shpirt artistik, vajza që vjen nga shkolla e fëmijëve që nuk dëgjojnë e flasin, arriti të hapë ekspozitën e saj personale. Sot ajo tashmë ka filluar punë dhe është mësuese e vizatimit po në shkollën ku ajo hodhi hapat e para të dijes...

Piktorja e talentuar që flet me pikturat e saj.





Rruga e Arbërit nr. 105

botime

Me karakterin e një antologjie prehistorike, monografia synon të jetë një ndihmesë edhe për studentët e arkeologjisë në përgjithësi dhe asaj prehistorike në veçanti. Botimi i kësaj monografie sjellë një frymë të re në studimin e kulturave prehistorike në territorin e Shqipërisë dhe plotëson një boshllëk të ndjeshëm në pikëpamje të mënyrës së re të konceptimit dhe të trajtimit të tyre, dhe përbën padyshim një kontribut të rëndësishëm të të dy autorëve në këtë drejtim.

BOTOHET MONOGRAFIA "STUDIME PËR PREHISTORINË E SHQIPËRISË"

Një **kontribut në arkeologjinë shqiptare** nga profesorët Frano Prendi dhe Adem Bunguri

Në nëntor 2014, doli nga shtypi monografia **"Studime për Prehistorinë e Shqipërisë"** me bashkëautorë studiuesin shumë të njohur të Prehistorisë Shqiptare, Prof. Dr. Frano Prendi dhe ish studentin dhe bashkëpunëtorin e tij, studiuesin e arkeologjisë prehistorike, Prof. Dr. Adem Bunguri, monografi që u paraqit edhe në Panairin e Librit Shqip në Tiranë (12-16.11. 2014).

Në pikëpamje strukturore, monografia përbëhet nga 5 kapituj, të paraprirë nga një hyrje e shkurtër (f.7-9), pozita gjeografike (f. 9-13) dhe historiku i kërkimeve prehistorike (f. 13-21). Pastaj sipas kriterit kronologjik e tematik vijojnë kapitulli I "**Paleoliti dhe Mezoliti në Shqipëri"** (f. 22-50), kapitulli II "**Neoliti i Hershëm në Shqipëri**"(f.52-160), kapitulli III **"Neoliti i Mesëm në Shqipëri**" (f. 161-202), kapitulli IV "**Neolitit i Vonë në Shqipëri**"(f. 203-253) dhe kapitulli V **"Eneoliti në Shqipëri**" (f. 254-332). Punimi mbyllet me "**Konkluzionet e përgjithshme**" (f. 333-348) dhe një **Apendiks informativ** që përfshin "**Lista e vendbanimeve sipas periudhave"** (f. 349-355), **"Tabela e sipërfaqes së përafërt të vendbanimeve dhe të sipërfaqes së gërmuar"** (f. 356-357), **"Tabela e datimeve radiokarbonike të kulturave prehistorike në Shqipëri**" (f.358-359), "**Tabela e datimeve radiokarbonike të kulturave prehistorike në rajon"** (f. 360-369), "**Lista e refereimeve të dokumentacionit grafik, fotografik dhe arkeologjik të botuar më parë**" (f. 370-373), "**Lista e figurave dhe të tabelave ilustruese"** (f. 374-380), **"Lista e shkurtimeve"** (f. 381-382), "**Bibliografia**" (f. 383-411) **"Indeksi i emrave gjeografikë**" (f. 412-415) si dhe dy **tabela kronologjike** mbi Paleolitin dhe Neolitin në Shqipëri dhe në Ballkan dhe mbi Neolitin dhe Eneolitin në Shqipëri dhe në Ballkan (f. 416-417). Monografia me një vëllim prej 417 faqe tekst, shoqërohet nga **72** figura, foto, harta, planimetri, diagrama, **6** tabela tipologjike të morfologjisë së enëve sipas periudhave kronologjike si dhe **173** tabela iliustruese të kompozuara në fund të tekstit. Vëllimi i saj në total arrin në 590 faqe.

Përgatitja e një punimi të tillë përgjithësues, është nisur nga Prof. Frano Prendi, që në fillimin e viteve '90 të shekullit të kaluar, ndërsa pas vitit 2005, me këmbënguljen e tij, në këtë projekt, do të përfshihej edhe A. Bunguri, si bashkëautor i këtij studimi. Ajo ishte planifikuar të botohej në vitin 2008, me rastin e 80 vjetorit të lindjes së tij. Meqë atëherë nuk qe e mundur të realizohej, është paraqitur tani, duke përfshirë edhe informacionin më të ri arkeologjik, qoftë edhe kur ai është i publikuar në formën e raporteve të shkurtër paraprak. E veçanta e kësaj monografie është trajtimi i kulturave neo-eneolitike sipas grupeve dhe kompleksëve kulturor përkatës, duke i kushtuar më tepër vëmendje analizës dhe sintezës kulturore, kriter që në një farë mase, na ka çliruar nga përshkrimet e tepërta. Megjithatë, për të patur një pamje sa më të plotë të zhvillimeve neo-eneolitike në Shqipëri, brenda çdo grupi kulturor, kemi dhënë edhe një resume të kulturës së vendbanimeve kryesore, gjë që i jep punimit edhe tiparet e një antalogjie prehistorike.

Botimi i saj plotëson një amanet të Prof. Frano Prendit, i njohur në jetën e përditshme si Prof. Çesku, dhe përbën njëherësh edhe një homazh ndaj veprës së tij shkencore dhe kontributit të jashtëzakonshëm të tij në studimet prehistorike në Shqipëri. Me këtë rast, edhe në emër të Prof. Çeskut, falenderoj recenzentët shkencorë, Akademik Muzafer



Frano Prendi - Adem Bunguri
STUDIME PËR PREHISTORINË E SHQIPËRISË

Botimet M&B.
ISBN: 978-9928-172-18-1.
Çmimi: 15 Euro

Korkuti (Tiranë) dhe Dr. (PhD) Shafi Gashi (Prizren), oponentët si dhe kolegët e tjerë të Këshillit Shkencor për sugjerimet e tyre të vlefshme. Falenderoj gjithashtu skicografin Ilir Zaloshnja (Tiranë) për skicimin dhe tushimin e shumicës së tabelave ilustruese, arkeologun Ma. Vesel Hoxhaj (Prizren) për përpunimin kompjuterik të tyre dhe informaticienin Haris Sokoli (Prizren) për digitalizimin e të gjithë dokumentacionit grafik dhe fotografik. Më në fund, një falenderim i përzemërt, shkon për sponsorizuesin e këtij botimi, Dr. (PhD) Shafi Gashi (Prizren), arkeologun tashmë të njohur në rrethet shkencore të Kosovës dhe të Shqipërisë, dashamirësia e të cilit pati mundësuar botimin edhe të tre vëllimeve të tjera me studime arkeologjike të Prof. Frano Prendit, si dhe festimin e 80 vjetorit të lindjes së tij në Tiranë.

Më poshtë po rrjeshtojmë disa nga risitë e kësaj monografie, që duhet thënë se është një studim mjaft i arrirë në pikëpamje të cilësisë dhe interpretimit arkeologjiko-historik të fenomeve arkoeologjike dhe kulturës prehistorike në Shqipëri.

— Trajtimi për të parën herë i kulturave neo-eneolitike sipas kompleksëve kulturorë dhe grupeve kulturorë përkatës duke i kushtuar më tepër vëmendje analizës dhe sintezës kulturore. Brenda çdo grupi janë dhënë vendbanimet kryesore që e formojnë atë, tiparet e përbashkëta dhe veçoritë në kontekstin e diversitetit kulturor. Studimi i kulturave të vendbanimeve neo-eneolitike sipas grupeve kulturorë përkatës, e ka lehtësuar mjaft të kuptuarit më mirë të mekanizmave të brendshëm gjenetizues dhe faktorëve të jashtëm kulturorë, që kanë përcaktuar zhvillimet prehistorike në Shqipëri. Analiza dhe sinteza e plotë dhe shumë profesionale e kulturës së Neolitit të Hershëm sipas grupeve kulturorë përkatës, kulturës së Neolitit të Mesëm të tipit Cakran-Dunavec, asaj të Neolitit të Vonë të tipit Maliq I-Kamnik dhe kulturës eneolitike të tipit Maliq II.

— Evidentimi për të parën herë i dukurive të reja sociale që në fazën e zhvilluar të Neolitit të Hershëm, që i referohet impulsit II anatolian, kur instalohet plotësisht mënyra neolitike e jetesës. Shfaqja e diferencimit pasuror dhe e luftës mbrojtëse(grupi kulturor Podgorie I-Vashtëmi), fshijnë ngas tekstet "*barazinë utopike dhe jetën idilike gjatë Neolitit të Hershëm"*, siç ka qenë supozuar më parë.

—Evidentimi për herë të parë i 4 grupeve kulturorë të Neolitit të Hershëm dhe ilustrimi i tyre me hartat përkatëse, si dhe paraqitja për herë të parë e grupit të Neolitit Monokrom, i përfaqësuar nga Vlusha IIa, një arritje kjo përsa i përket proçesit neolitizues në Shqipëri.

— Paraqitja për herë të parë e tri modeleve të ndryshme të neolitizimit të Shqipërisë, dhe sjellja për herë të parë e argumenteve shkencorë në mbështetje të kësaj skeme të neolitizimit. Argumentimi i secilit model me fakte arkeologjike, përfshirë edhe datimet radiokarbonike të realizuara në Shqipëri dhe në rajon.

— Sinkronizimi i dinamikës së zhvillimeve neolitike të hershme të Shqipërisë me rajionet e tjera fqinje apo më të largëta të Thesalisë, Greqisë, Maqedonmisë Egjeane, Thrakisë, Anatolisë.

— Dhënja në fund të çdo periudhe apo kapitulli e tipeve kryesore të enëve në një tabelë tipologjike, sipas përfaqësimit të tyre në çdo vendbanim në përbërje të grupit kulturor përkatës.

— Futja për të parën herë e sistemit trifazor të kronologjisë së grupit eneeolitik Maliq II, përkatësisht Maliq IIa, IIb dhe IIc, që i referohen tri shkallëve kronologjiko-kulturoree të zhvillimit eneolitik në Shqipëri, të hershme, të mesme dhe të vonë.

— Interpretimi i realizuar historik i dukurive neo-eneolitike, duke filluar që nga faza më e hershme e Neolitit Monokrom deri tek faza e vonë eneolitike, kur në territorin e Shqipërisë dhe më gjërë ishte përhapur kultura e grupit Maliq II, që paraqitet e unifikuar në aspektet më kryesore të zhvillimit të saj.

— Theksimi i prirjes unifikuese të zhvillimit kulturor me drejtim vertikal, [shtë[nj[arritje e dukshme e punimit. Kështu ndërsa në neolitin e hershëm territori i Shqipërisë ndahej midis 4 grupeve kulturore të dy kompleksëve të mëdha anatolo-ballkanik dhe adriatiko-mesdhetar, në neolitin e mesëm, territori i saj mbulohej në mënyrë gjatësore nga kulturat adriatiko-mesdhetare në perëndim dhe ato danilo-vinçiake apo diminiane në lindje, si dhe nga kultura Maliq I-Kamnik dhe kulturat danilike e vinçiake të vona gjatë Neolitit të Vonë, gjatë Eneolitit mund të flitet për një grup të vetëm kulturor, atë Maliq II, i zhvilluar në mardhënje të ngushta kulturore me grupe të tjera t kompleksit Shuplavec-Bakarno Gumno, Gumelnica-Salkuca-Krivodol apo Baden-Kostolac.

— Pajisja e monografisë në fund të saj me një apendiks, ku janë dhënë lista e vendbanimeve të paleolitit të ulët, të mesëm e të lartë, lista e vendbanimeve të mezolitit, lista e vendbanimeve të neolitit të hershëm, të mesëm e të vonë dhe lista e vendbanimeve të eneolitit, së bashku me referencat e burimit të informacionit, tabela e madhësisë së vendbanimeve dhe sipërfaqes së gërmuar të tyre, si dhe tabela e datimeve radiokarbonike të realizuara deri më sot në Shqipëri për kulturat e trajtuara, së bashku me datimet BP apo calibrimin e tyre.

—Shoqërimi i tekstit nga një aparat ilustrativ mjaft i pasur dhe i organizuar, i përbërë nga 78 harta, diagrama, figura dhe skica të përfshira në tekst, si dhe i 173 tabelave ilustruese, të organizuara sipas kulturave të trajtuara dhe kritereve kronologjik dhe kulturorë. Përgatitja e tabelave ilustruese është kryer sipas parimit selektiv tipologjik, kur kultura e vendbanimeve në shqyrtim është e botuar, dhe atij gjithëpërfshirës, kur ajo botohet për herë të parë.

—Pajisja e librit me një aparat të pasur shkencor dhe bibliografinë më të fundit, të shprehur në **1484** fussnota.

ARGUMENTIMI ARKEOLOGJIK I NEOLITIZIMIT TË SHQIPËRISË

Çështja më e rëndësishme lidhur me neolitizimin, është studimi i proçesit dhe mënyrës së kalimit nga mezoliti në neolitin e hershëm dhe në pikëpamje të formave të ekonomisë nga gjuhetarët mezolitikë në blektorët dhe bujqit e hershëm neolitik. Aktualisht, mbi bazën e të dhënave arkeologjike, janë dalluar tri modele suksesive neolitizuese, që edhe pse me hiatuse kronologjike, mbulojnë të gjithë periudhën e neolitit të hershëm. Në këtë proçes të gjatë të akulturimit neolitizues, vihet në dukje fakti se të tri modelet neolitizuese përputhen me tri faza suksesive me hiatuse kronologjike midis tyre, që u referohen tri impulseve neolitizues, me origjinë nga Anatolia dhe Mesdheu lindor.

Në nivelin e sotëm të njohurive, janë dalluar në territorin e Shqipërisë, tre tipe të ndryshme vendbanimesh, që përgjithësisht përputhen me shkallët e neolitizimit të Ballkanit, tipi i vendbanimit hibrid, ku komponenti vendas bashkëjeton me atë migracionar të ardhur nëpërmjet difuzionit demik (Vlushë IIa), tipi i vendbanimit autokton, me vazhdimësi të pandërprerë banimi nga mezoliti në neolit (Konsipol IIIa) dhe tipi i vendbanimit të krijuar nga difuzioni demik ose lëvizjet migracionare transhumante gjatë impulsit III neolitizues (Podgorie I).

Modeli parë i referohet tipit hibrid, që gërsheton elementin indigjen, përkatësisht silekset e traditës mezolitike me elementin e ardhur, përkatësisht qeramikën e thjeshtë monokrome. Ai lidhet me impulsin e parë më të hershëm neolitizues me origjinë nga Anatolia, që përputhet me fazën e parë kronologjikisht më të hershme të periudhës së Neolitit Monokrom *(TODOROVA 2003, 264).*, bartësit e të cilit, në pikëpamje kulturore karakterizohen nga qeramika monokrome me ngjyrë të errët, që përbën edhe emëruesin e përbashkët për kulturat më të hershme neolitike në Ballkan. Në Shqipëri përfaqësuesi më i qartë është Vlusha IIa, e karakterizuar nga qeramika primitive monokrome, me pjekje të dobët, ngjyrë kafe në gri dhe forma të thjeshta të enëve, të zbukuruara me dekore të thjeshta plastike, e ngjashme me atë Sidar C Base dhe të disa vendbanimeve të tjera të Ballkanit Jugor (Krainici) dhe Anatolisë Egjeane (Haçilar, Barçin Höyük). Si e tillë, mendojmë se ajo duhet konsideruar si përfaqësuese e impulseve të para më të hershme neolitike me origjinë anatolike të ardhur në Shqipëri, që duket se gjetën në këtë vendbanim një popullësi indigjene me traditë të fortë mezolitike. Vlusha duket se përfaqëson tipin e një vendbanimi hibrid, kultura e të cilit formohet nga bashkëjetesa e elementit të ardhur migracionar dhe atij indigjen, e shoqëruar me proçese asimiluese e integruese, duke sjellë të dhëna në mbështetje të teorisë së akulturimit. Në këtë kontekst, Vlusha IIa do të përfshihej në modelin e ashtuquajtur

kulturë

"leap-frog colonisation" të përshkruar nga M. Zvelebil*(ZVELEBIL 2001, 2)*.

Modeli II është ai indigjen, me përfaqësues tipik fazën Konispol IIIa, i karakterizuar nga qeramika impresso e tipit adriatik. Konispoli ka dhënë modelin e një vendbanimi me kulturë indigjene të zhvilluar drejpërdrejtë nga mezoliti, duke sjellë të dhëna të vlefshme në mbështetje të karakterit endogjen të neolitizimit. Në stratigrafinë e këtij vendbanimi, shtresa e neolitit të hershëm Konsipol IIIa, ndjek menjëherë dhe pa hiatus shtresën e mezolitit Konsipol II. Të dhënat arkeologjike kanë provuar se pastoralizmi ka qenë mënyra kryesore e jetesës së banorëve të tij. Në pikëpamje kronologjike ai është i njëkohshëm me kulturat adriatikase Sidar C Top, Skarin Samograd II, Crvena Stijena III, Zelena Peçina III, Smilçiç I, me të cilat e vë në lidhje në mënyrë të veçantë qeramika impresso. Megjithatë, nuk mund të thuhet me siguri në se kjo qeramikë është vërtetë me karakter lokal, apo është akulturuar nga mardhënjet me kulturat bashkëkohëse adriatikase, bartës të qeramikës impresso, kryesisht nga vendbanimi i Sidarit në Korfuz, ku ajo rezulton më e hershme se në Konispol, nëpërmjet difuzionit kulturor. Kjo qeramikë duhet të ketë ardhur në Konispol gjatë impulsit adriatikas të bartësve të qeramikës impresso, me origjinë nga Mesdheu lindor. Është pikërisht kjo qeramikë që e cilëson Konispolin edhe si përfaqësuesin e parë më të hershëm në Shqipëri të impulsit adriatikas, bartës të qeramikës impresso, me origjinë nga Mesdheu Lindor. Ne besojmë se kjo qeramikë është përvetësuar në Konsipol nëpërmjet difuzionit kulturor dhe proçeseve të akulturimit nga mardhënjet me fqinjin më të afërt, Sidar C Top (Korfuz), ku kjo qeramikë është datuar me radiokarbon rreth 7340+-180 vjet më parë (BP), e kalibruar në 6410+-5990 (6170) para Kr.(cal)*(MÜLLER 1991, 356).*, me një prioritet të ndjeshëm kronologjik ndaj impressos së Konispolit IIIa, e datuar me radiokarbon rreth viteve 7060+-110 vjet më parë (BP) dhe 6830+-80 vjet më parë (BP)*(KORKUTI et al, 1996,197; KORKUTI 2003, 221).*, e kalibruar në 6170-5800 dhe 6000-5550 para Kr.(cal)*(FORENBAHER-MIRACLE 2006, 95, tab. 3).*. Me këto të dhëna Konispoli IIIa duhet përfshirë në modelin e ashtuquajtur ***"regional contact"****(ZVELEBIL 2001, 2).*, që nënkupton mardhënje tregtare dhe këmbimi me komunitetet fqinje, përfshirë edhe shkëmbimin e ideve dhe të novacioneve*(ZVELEBIL 2001, 2)*. Ky impuls neolitizues duket se ka ndjekur rrugën e përhapjes nga Mesdheu Lindor, Egjeu drejt detit Jon dhe Adriatikut Lindor, në drejtim të brigjeve Joniane të Shqipërisë. Në një fazë të mëvonshme, që përputhet me atë Skarin Samograd II, të datuar me radiokarbon midis viteve 6600+-100 vjet më parë (BP), e kalibruar në 5630-5470 (5490) para Kr.(cal) *(MÜLLER 1988, 219-224; MÜLLER 1991, 354-355).*, komponentja adriatikase konsolidohet dhe depërton në hinterlantin kontinental, përkatësisht në Katundas I, Vlushë IIb dhe sidomos në Blaz II.

Aktualisht Vlusha II a dhe Konispoli IIIa, përfaqësojnë dy modele të ndryshme të neolitizimit dhe shkallët më të hershme të zhvillimit neoltik në Shqipëri. Megjithatë, në të dy rastet ende nuk mund të flitet për vendbanime sedentare me ekonomi bujqësore dhe mënyrë jetese karakteristike për neolitin e hershëm në përgjithësi. Gjatë këtyre fazave kemi të bëjmë më tepër me **foragers and gatherers** dhe jo me **farmers** në kuptimin neolitik. Në një fazë të mëvonshme impulsi adriatikas konsolidohet dhe depërton edhe në hinterlantin kontinental, përkatësisht në Katundas I, Vlushë IIb dhe sidomos në Blaz II e Nezir I. Mbi bazën e të dhënave të mësipërme, duke u mbështetur sidomos në evidencën e Konispolit IIIa, mund të konkludohet se proçesi i neolitizimit, të paktën në Shqipërinë Jugperëndimore, duhet shikuar si zhvillim i brendshëm akulturues autokton i kulturave më të hershme mezolitike, ndërsa në zonën e kulturës së Vlushës si bashkëjetesë e kulturës së ardhur migracionare dhe asaj indigjene. Sidoqoftë, problemi i neolitizimit të vendit, është shumë më i ndërlikuar dhe nuk mund të zgjidhet kurrësesi vetëm me Vlushën dhe Konispolin, dhe aq më tepër, kur ato sapo kanë filluar të gjurmohen dhe të trajtohen arkeologjikisht. Sqarimi shterrues i këtij problemi kërkon studime më të plota dhe datime radiokarbonike të të gjithë përfaqësimeve të hershme neolitike në Shqipëri, të cilat duhet të shtrihen në të gjitha vendbanimet e kësaj periudhe, e veçanërisht në ato me vijimësi mezolitike. Vetëm atëherë do të krijohen mundësitë për ta rrokur siç duhet dhe në aspekte të ndryshme problemin e diskutueshëm të neolitizimit të vendit tonë.

Modeli III i neolitizimit i referohet impulsit së dytë anatolian, të karakterizuar nga qeramika monokrome e kuqe dhe e pikturuar kryesisht me ngjyrë të bardhë mbi sfond të kuq, dhe qeramika polikrome, me përfaqësues kryesor grupin kulturor Podgorie I-Vashtëmi. Ky formacion kulturor rezulton i ardhur nga grupe të tjera të kompleksit ballkano-anatolik të neolitit të hershëm, pasi aktualisht në pellgun ne Korçës nuk janë zbuluar faza më të hershme të zhvillimit të tij. Qeramika mjaft e zhvilluar e këtij grupi kulturor, nuk paraprihet, së paku në pellgun e Korçës nga një fazë më e hershme zhvillimi, ndërkohë që faza më të hershme zhvillimi të qeramikës monokrome me cipë të kuqe, janë konstatuar në Anatolinë Perëndimore *(ERDOGU 2005, 97).* si dhe në një numër vendbanimesh në Thrakinë lindore (Hoća Çeşme dhe Aşaği Pinar)*(ÖZDOĞAN 2003, 351; PERLES 2005, 286)*, Maqedoninë Egjeane (Nea Nikomedia) dhe atë Lindore (grupi Anzabegovo-Vrsnik Ic), Pelagoni (Velushka-tumba I) etj. Këto analogji tregojnë se bartësit e këtij impulsi kulturor duhet të kenë ndjekur rrugën anatolo-ballkanike, gjasisht në linjën Haçilar-Hoça Çesme-Anzabegovo-Vrśnik I-Nea Nikomedia-Veluśka tumba.

Ky impuls kulturor migracionar në Shqipërinë Juglindore, ka krijuar modelin III të neolitizimit, që përfshihet në të ashtuquajturin ***"folk migration"*** të përshkruar nga M. Zvelebil*(ZVELEBIL 2001, 2)*. Një rrymë e këtij impulsi neolitizues, duket se depërton nga Verilindja e Shqipërisë, përkatësisht nga grupi kulturor Starçevo, që në fazën e tij të dytë të zhvillimit (Starçevo IIa-b), arrin ekspansionin e tij më të madh drejt jugperëndimit, duke përfshirë brenda zonës kulturore të tij të gjithë Kosovën (Glladnicë I, Rudnik I-II, Vlashnje I) dhe Shqipërinë Verilindore (Kolsh I, Burim I), me influenca të forta edhe Shqipërinë Juglindore (Podgorie I-Vashtëmi, Rajcë, Rashtan) etj.

Një rrymë e këtij impulsi neolitizues, duket se depërton nga verilindja e Shqipërisë, përkatësisht nga grupi kulturor Starçevo, që në fazën e tij të dytë të zhvillimit (Starçevo II a-b), arrin ekspansionin e tij më të madh drejt jugperëndimit, duke përfshirë brenda zonës kulturore të tij të gjithë Kosovën (Glladnicë I, Rudnik I-II, Vlashnje I) dhe Shqipërinë Verilindore (Kolsh I, Burim I), me influenca të forta edhe Shqipërinë Juglindore (Podgorie I-Vashtëmi, Rajcë, Rashtan) etj.

Evidenca arkeologjike në Shqipëri na shtyn drejt mendimit se vetëm gjatë fazës së III të Neolitit të Hershëm, finalizohet procesi neolitizues, dhe krijohen fshatra të vërtetë bujqësor dhe blektoral, sipas mënyrës neolitike të jetesës, ndërsa gjatë fazës së parë dhe të dytë, mund të flitet vetëm për grupe të vogla banorësh dhe vendbanime me karakter sezonal.

Me karakterin e një antologjie prehistorike, monografia synon të jetë një ndihmesë edhe për studentët e arkeologjisë në përgjithësi dhe asaj prehistorike në veçanti. Botimi i kësaj monografie sjellë një frymë të re në studimin e kulturave prehistorike në territorin e Shqipërisë dhe plotëson një boshllëk të ndjeshëm në pikëpamje të mënyrës së re të konceptimit dhe të trajtimit të tyre, dhe përbën padyshim një kontribut të rëndësishëm të të dy autorëve në këtë drejtim.



Ceremonia për dhënjen e Certifikatave të Mirënjohjes. Në foto: Prof. Bujar Kapexhiu, Ing. Tefik Jegeni, Mira Shkurta, Rruzhdi Lata dhe Rregjisor Ylli Pepo.

Shfaqet dokumentari **"Dibra e Madhe"**

Ditën e premte, datë 16 janar 2015 në orën 17:00, në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave në Tiranë u bë promovimi i dokumentarit "Dibra e Madhe".

Saimir Shatku, sekretar i përgjithshëm i shoqatës Bashkiësia Dibrane, tha në fjalën e tij hapëse se ky është "i pari dokumentar me një përmbajtje të gjerë mbi historinë e trevës së Dibrës, kulturën, folkun dhe traditat u realizua nën kujdesin e Kryetarit të Dibrës së Madhe, magjistër Rruzhdi Lata; me produksion dhe skenar të gazetares së RTSH-së, Mira Shkurta; regjisor: Ylli Pepo (Artist i Merituar) dhe operator: Denald Grepcka"

Shfaqja e dokumentarit u realizua midis dy promotorëve dhe falë bashkëpunimit mes RadioTelevizionit Publik Shqiptar dhe Shoqatës "Bashkësisë Dibrane" në Tiranë.

Të pranishëm në promovim ishin, organizatorët e dokumentarit; Kryetari i Dibrës së Madhe, z. Rruzhdi Lata, Kryetari i Bashkisë Peshkopi, z. Ilir Krosi; përfaqësues të komunitetit dibranë në Tiranë, përfaqësues nga shoqata "Tirana", Lidhja e Intelektualëve Dibranë, akademikë, studiues, artistë etj.

Pas fjalës përshëndetëse nga ana e kryetarit z. Lata, si dhe pas përshëndetjeve të bëra nga ana e organizatorëve u dha në një përmbledhje prej 50 minutash nga pjesa e parë dhe pjesa e dytë e dokumentarit.

Pas përfundimit të dokumentarit premierë "Dibra e Madhe" në sytë e të ftuarve, kishte mallengjim, lot ne sy, entuzisem dhe emocion, i cili shoqeronte çdo brez.

Nga ana e kryesisë së Bashkësisë Dibrane u dhanë "Certifikata Mirënjohjeje" për Kryetarin Lata, çertifikate e cila ju dorëzua nga Ing. Tofik Jegeni; për Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH, z. Martin Leka, ju dorezua nga Kryetar i SHBD, Mira Pirdeni; për gazetaren dhe producenten e dokumentarit, Mira Shkurta, ju dorezua nga SHLID, Shpëtim Cami; për regjisorin: Ylli Pepo (Artist i Merituar); ju dorezua nga anëtari i kryesise se "Bashkësisë Dibrane" Prof. dr: Bujar Kapexhiu (Mjeshtër i Madh);

Gjithashtu kjo Mirënjohjeje ju dha dhe familjes Mexhit dhe Shtesa Capa, të cilët sponsorizuan dokumentarin; Ing. Petrit Paçuku, për punën e tyre. Çertifikatat e Mirënjohjes ju dhanë organizatorëve me propozimin e kryesisë së Shoqatës "Bashkësia Dibrane" me motivacionin: "Për ruajtjen dhe mbajten gjallë të lidhjeve historike, kulturore dhe atdhetare mes Dibranëve të Tiranës me qytetin e Dibrës së Madhe."

Më pas diskutimi mes organizatorëve u zhvendos plotë emocion në koktein e shtruar në hollin e Akademisë së Shkencave, i sponsorizua nga z. Musa Riçku.

"Më këtë film kam përmbushur një premtim dhënë prindërve të mi, një ëndërr të tyre, që unë të bëja diçka për Dibran e Madhe. Filmi ka për qëllim që të tregojë vlerat më të mira të Dibrës së Madhe", thotë skenaristja Mira Shkurta.

Dokumentari i shfaq i plotë në Televizionin Publik Shqiptar më datë 24 dhe 25 janar 2015, pas edicionit qendror të lajmeve.

Korresp. "Rr.A."

Keni ndonje shqetesim
per te ndare
me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Rruga e Arbërit nr. 105

Mendime për librin
"Folklor nga Mati"

recensë

Dilaver Kurti, *hulumtuesi i shquar,* "**arkeologu**" *i visareve të popullit*

Nga **MEVLUD BUCI**

Një lidhje shumë e ngushtë shihet mes hulumtuesve të krijimtarisë popullore dhe arkeologëve. Të parët gjejnë rrënjët e shpirtit e urtësisë popullore, të dytët zbulojnë "mineralet e çmuara" të këtij shpirti.

Hulumtuesit, studiuesi i paharruar Dilaver Kurti, biri i Matit dhe nipi i Dibrës, s'ka sesi të mos frymëzojë e emocionojë sado pak çdo studiues e publicist, çdo lexues që admiron e vlerëson me shpirt krijimtarinë e çmuar të brezave. Pa mëdyshje, pa më të voglën hiperbolë, Dilaver Kurtin do ta quaja një "Thimi Mitko të viteve '60-'90 të shekullit të kaluar".

Ky intelektual pasionant, pas studimeve historike e gjurmimet në kulturën popullore, nuk rreshti së hulumtuari edhe folklorin, këtë thesar të vyer të shpirtit e mençurisë popullore. Kur më ra në dorë libri i Dilaver Kurtit "Folklor nga Mati" u emocionova e sikur m'u vu barrë e rëndë në mendje e shpirt për të shkruar pak radhë për këtë libër epope e relike të ndritur të krijimtarisë së brezave. E mira, e drejta, e thjeshta kurrë nuk harrohen, ata gdhenden në bronz si i thonë. Qysh në fund të viteve '70 (kur unë as kisha veçse 10 vite punë), do të ndjeja nga afër ndihmesën, dhe e vlerësimin, aktivizimin nga i paharruari Dilaver Kurti, i cili në çdo veprimtari por traditat e ndritura popullore mbante lidhje me studiues e veprimtarë të palodhur të trevave të Matit, Dibrës e më gjerë. Kurdoherë dashamir, kështilltar me takt, udhëzues e frymëzues për ne e cilindo që e vërente se është në udhën e çmuar të hulumtimeve për të lartësuar gjurmët e krijimtarisë të historisë e të traditave të brezave.

Dilaver Kurti ishte dhe mbeti intelektuali i vërtetë e human që zotëronte shkencën, shpirtin atdhetar matjan ku kishte lindur dhe mençurinë e thjeshtësinë dibrane ku ishte nip. Kurdoherë i saktë, realist, korrekt, durues, ndihmues, frymëzues e vlerësues kështu e njoha unë dhe moshatarët e mi të paharruarin Dilaver Kurti.

***

Më 19 tetor të vitit 2014 Dilaver Kurti mbushi 80 vjet të lindjes. Ka ndërruar jetë më 27 nëntor 1998 në qytetin historik të Burrelit. Shembulli, provat, përvojat e veprat e tij, në fushën studimore e gjurmuese për trashëgiminë historike e etnokultura përbëjnë një thesar të çmuar për Matin, kombin dhe brezat që do të vijnë. Studiuesi dhe poeti i talentuar Hamdi Hysuka, me të drejtë shkruan botimin dinjitoz: "Jeton në brezat që do të vijnë" ku pasqyron figurën e ndritur të të shqiptarit Dilaver Kurti, vlerat e librit më të fundit promovuar në 80-vjetorin e lindjes "Folklor nga Mati" mendime të studiuesve më në zë të kohës.

Gjatë viteve '60 e në vazhdim deri sa u nda nga jeta më 1998 Dilaver Kurti qe bashkëpunëtor i jashtëm i instituteve kërkimoreshkencore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa punën e tij gjurmuese e studimore e botoi në revistat e tyre periodike shkencore "Studime historike", "Iliria", "Etnografia shqiptare", "Monumentet" etj., si dhe në shtypin kombëtar e lokal të kohës. Studiues i mirënjohur e i talentuar z. Behar Gjoka midis të tjerave thekson për librin "Folklor nga Mati", ...është plotësim i visareve të kombit kronika e gjallë që unë e lexoj për herë të parë, është një enciklopedi, është zëri i Matit që flet artistikisht që na sjell këngën dhe historinë...

Është vërtet mbresëlënëse dhe dëshmi e vyer e punës pasionante fjala e Suzana Kurtit, Sefer Dukës, Agron Xhagollit, Xhemal Meçit, Esat Rukës, Adelina Fariçit, Basir Bushkashit, Aqif Ymerit, Mimoza Kurtit, Ibrahim Fariçit, Artan Kurtit personalitete të shquara të kulturës matjane e asaj kombëtare të cilët kanë motivuar qartë realisht me devotshmëri figuron enciklopedike e të ndritur të studiuesit e etnologut Dilaver Kurti. "Bazë për botimin e librit "Folklor nga Mati", shkruan publicisti e kryeredaktori e "Matit" Hamdi Hysuka u bë përmbledhësi "Gurra Popullore e Matit", material i dërguar nga Dilaveri në ish institutin e Folklorit në Tiranë (më 1982), ruajtur dhe në arkivin e tij familjar, si dhe shumë materiale të tjera të fjetura po në këtë arkiv.



"Këto tipare të veprimtarisë së tij, vijon z. Hysuka, - në fushën e mbledhjes të visarit popullore matjan janë shprehje e identitetit kombëtar, dokument i pavdekshëm për brezat që vijnë. Puna e madhe që bëri Dilaver Kurti për mbledhjen e këtyre vlerave, e ka bërë të njohur në folkloristikën shqiptare..."

Tematika gjurmuese e librit "Folklor nga Mati" është e larmishme, tërheqëse, edukuese e frymëzuese. Tekste baladash, këngë të kreshnikëve, plot tekste të këngëve historike që dëshmojnë e lartësojnë historinë e figurat historike, ngjarjet luftërat, traditat zakonore, këngë lirike me plot ngarkesë emocionale e kolorit popullor, ninulla, këngë dasme, syneti, vajtime, dashuria, nizami, prozë popullore si përralla, anekdota, proverba, gjëegjëza, urtësi, ku shpërfaqet shpirti, mençuria dhe traditat e çmuara të brezave, kultura e vyer matjane e ajo mbarëkombëtare.

Në të 253 faqet e këtij libri shpërfaqet krijimtaria, shpirti e mençuria popullore, lexuesi njeh më në plotësi Matin e matjanët, trevat për rreth si Dibër, Kukës, Mirditë, Pukë etj., ku hulumtuesi Dilaver Kurti paraqet edhe variante këngësh të gdhendura me realizim e saktësi ku shpërfaqen vlerat e brezave të mjaft teorive që rrethojnë Matin. Është domethënëse dhe çmuar apo që shkruan midis të tjerash në parathënie të librit Prof. Dr. Agron Xhagolli: "Tashmë me botimin e këtij vëllimi mund të themi sa dhe Mati ka shpërfaqësimin e vet të gjetur e të sjellë me dashuri nga Artan Kurti e çeli punën e përkushtuar të babait të tij, Dilaverit, e ka sjellë me përmasa të vlerësueshme dhe dinjitoze... (f. 10).

Libri "Folklor nga Mati", një thesar i vërtetë për brezat, për lexuesit, mësuesit, nxënësit, pedagogët, studentët, për etnokulturën e çmuar të shqiptarisë.

***

Libri "Folklor nga Mati" hapet me hyrjen ku botohet studimi shkencor i Dilaver Kurtit: "Vështrim mbi traditën folklorike në krahinën e Matit" ku pas një analize argumentuese e serioze për vlerat e traditat autori shkruan: "... krahina e Matit ka afërsi kulturore të theksuar me krahinat përreth: Mirditë, Dibër, Librazhd, Tiranë e Krujë, që në mesjetë përfshiheshin në principatën e Kastriotëve" (f. 13).

Në tekstet e këngëve, në prozën popullore e gjithçka gdhendet në librin "Folklor nga Mati" shpërfaqet jeta, qëndresa, luftërat, dashuria, zakonet e traditat e ndritura të brezave.

Tek baladat "Halili dhe e motra", "Leka i vogël", "Ymer Aga", "Pat e njera nanë nji gjalë për mall", "Kë po kënon çaj zogu i zi", "Vaja e Rrokut" (më dy variante), "Kënga e Rexhës", "Selman Brahimi", Selman Lika" (në tre variante) pasqyrojnë virtytet, nderin, madhështinë e karakterit e të virtyteve të trashëguara në brezni, shpërfaqin krenarinë legjitime, bukuritë e vlerave të pasura nga një brez në tjetrin. Në këto gjurmime hulumtuesi i shquar ka saktësuar treguesit, gjuhën, vendin, ka dhënë vërtet atë "mineral" shpirtëror të trevës matjane, atë gurrë të kristaltë që në plotësi rrezaton edhe freskinë e trevave përreth Matit.

Ngjajnë vërtet me monumente të qëndresës këngët e kreshnikëve si "Ibrahim Keta i Ri", "Arnaut Osmani", këngët historike "Gjergj Kastrioti, Skënderbeu" (në dy variante" "Shaban Aga", "Mehmet Bega", Bruç Hoti", "Demir Pasha", "Xhetan Hoti", "Zenel Vata", Lufta e Pratit", "Lufta e Gjalishit", "Padishahu qan me lot", "Krisi pushka n'ato kodra", Demë Xhaferri", "Can Velia", "Can Hysa", "Llesh Maca", "Ukë Neziri", "Cen Barçi", "Kurt Suçi" (në dy variante), "Musë Tahiri", "Isuf Pula", "Tuç Leka"... Destan Begu shef sahatin", "Haxhi Gashi", "Halil Gashi" e plot e plot të tjera pasqyrojnë luftëra, ngjarje, figura të luftëtarëve e pajisjeve popullorë, vetëmohimin për liri e atdhetari jepen me penalata të holla e saktësi luftërat kundër turkut, serbëve, Malit të Zi, beteja e Shkallës së Deshve, shpirti i besatimit të matjanëve a të trevave përreth:

"Krisi pushka në Qafë të Pratit, / Ç'po luftojnë burrat e Matit,/ Burrat e Matit me Katër-Grykës/ Me asqer t'Sulltanët grikë për grikë / Me asqer t'Sulltanit fyt për fyt / Fyt për fyt me tef të taganit / Ç'ka po i shkrue pasha sulltanit: / Ç'ka t'i luajmë popullit në Mat / Se prej Qafe Buallit e deri në Prat / A mushë istikami plot me xhak... (Vargje të këngës "Lufta e Pratit" faqe 51).

Është vërtet nga monument historie, një përjetësim qëndrese e madhështie të popullit kënga "Krisi pushka n'ato kodra":

"Krisi pushka n'ato kodra / U vra Kola, u vra Vatoloda, / Na u vra Kola na u vra Vata / Xhith Dërjani bajnë në shplaka / Bajnë në shplaka, bajn medet / Kola e Vata janë përpjek /Shumë barutin e kanë djeg /Shumë barut e shumë fishekë... (f. 55)

Tek këngët historike të librit "Folkolor nga Mati", çdo lexues, studiues, mësues, atdhetar e njeri është geni heroizmin e popullsisë, vlerat e rralla të urtëve, të bijve të tyre, por me zemër e me besë, me virtyte të rralla atdhetarie.

Të një lëkure të veçantë e me plot madhështi qëndrese janë edhe këngët "Kërcet pushka xhëmoi kepi", "Ditën e shtunë ka therr tellali", "Ali Mena", Preng Dodë Sala", "Lufta kundër esadistëve", "Xhumoi Maj", "Ali Bruçi", "Dalip Cara" (në dy versione), "Preng Pasha"... "Lin Hoxha", "Nysja e S..." e plot të tjera. Këto këngë janë pasqyrë e shpirtit heroik, kronikë e luftërave e figurës së kombit tonë.

Nëse një lexues i thjeshtë, një studiues apo qoftë ky edh filozof do të kishte në duar librin "Folklor nga Mati", do të ndjente peshën e rëndë të vlerave të çmuara, historike, do të ndjente bukurinë e shpirtit krijues të brezave. Janë vërtet emocionuese e me plot dlirësi këngët e ... "Lirika familjare" (këngët e djepit e ninulla) këngë dasmash, vaje, lirika shoqërore (këngë fëmijësh), këngë mërgimi, këngë dashurie, këngë humoristike, proza popullore, përralla, anekdota, gjëegjëza dhe proverba.

Puna hulumtuese e studimore e shkencëtarit Dilaver Kurti, birit të Matit e nipit të Dibrës i ngjan një deti të thellë, një kurorë të blertë, një rrezatim që shndrit në vite, breza e epika.

Libri "Folklor nga Mati", është një enciklopedi e vërtetë e shpirtit krijues të popullit matjan e më gjerë, një dëshmi e etnokulturës, së brezave, një provë dhe fisnikëri e mençurisë, e kulturës dhe e dritës njerëzore e cila u ndriçon kohërave nëpër vite e shekuj. Pa mëdyshje e ritheksojmë se studiuesi, hulumtuesi e shkencëtari i mirëfilltë Dilaver Kurti i Matit ishte dhe mbetet "arkeologu" i visareve të popullit. Një Thimi Mitko i Matit, një stërnip i Pjetër Budit, një nip i Dibrës së Kastriotëve, një intelektual dhe hulumtues që u flet kohërave, brezave, që nderon etnokulturën matjane dhe atë mbarëkombëtare.

Nderim paçi djali i Dilaverit, botuesi Artan Kurti, ndërtim paçi reçesenti Prof. Dr. Agron Xhagolli, nderim e dritë Matit historik të barutit, Matit të fisnikërisë, brezave të mençurisë matjane e kombëtare. "Folklor nga Mati", një thesar i vërtetë për brezat, për lexuesit, mësuesit, nxënësit, pedagogët, studentët, për etnokulturën e çmuar të shqiptarisë. Në vite e shekujt të ndrittë vepra, penda e shpirti, biri i Matiti, nipi i Dibrës, Dilaver Kurti!

ese

Veteranët e cilës luftë?

Nga **AGRON TUFA**

20 gusht 2014. Pasi mbarova disa punë të ngutshme në Tiranë, do të kthehesha sërish në Dibër, te shtëpia e prindërve, ku kisha lënë tashmë atje time shoqe me fëmijët. Dola në Laprakë, ku midis disa radhësh me pallate fshihen furgonët që nisen për në Peshkopi. Gjeta një furgon gati në të nisur dhe, për fat, kishte vetëm një vend bosh. Ulem, hedh sytë nga udhëtarët e tjerë dhe më vjen mirë që përreth meje nuk ka asnjë fytyrë të njohur, me të cilën të hysh në kuvendim.

Në këto udhëtime të gjata rraskapitëse, çdolloj bisede shndërrohet në torturë shtesë. Jam pranë dritares në sediljen e fundit, ndërsa në të majtën time janë dy pleq, njëri me kasketë, tjetri me flokë krejt të zbardhur, të shkurtër.

Nga veshja e tyre hetoj njëfarë përkujdesjeje, ndonëse kostumet e zinj janë kombinuar me këmisha aspak të përshtatshme, me vija të gjera, madje, ai plaku i skajit tjetër, te dritarja, mbi këmishë kishte veshur një jelek të hollë leshi ngjyrë portokalli. Bën vapë e madhe dhe furgoni mban erë të athët djerse, të cilën ajri që hyn nga të dy dritaret e para, gjysmë të hapura, nuk arrin ta zhdavarisë plotësisht. Njëfarë plake në rreshtin e dytë të sediljeve vjell herë pas here, duke e zhytur kokën në qeset e celofanit që ia ofron një djalë i ri, me gjasë, i nipi. Asoherë edhe duhma bëhet më shpuese, e tillë që të pështjellon rropullitë. Përpiqem të mos i mbaj sytë. Hedh vështrimin nga dritarja dhe ujërat e gjelbër të digës së Shkopetit duket sikur e shpëlajnë përfytyrimin. Shoferi e kap situatën dhe menjëherë rivendos po atë kasetë me këngë që i kishim dëgjuar në xhiron e parë, njëra më e pështirë se tjetra. Ndoshta përvoja e tij thotë se këto këngë largojnë vëmendjen e udhëtarëve nga vjelltina. Tashmë plaka është mbështetur si e alivanosur në shpinore, me sy gjysmë të perënduar. Dikush shan me zë të trashë e të ngjirur qeverinë shqiptare që gënjen vazhdimisht dhe që kurrë nuk e ndërtoi Rrugën e Arbrit.

- Or ti, teveqel, - ia pret plaku që kam përbri, në të majtën time, - në dorë e kishe ti bashkë me atë Salë hajdutin... Pse nuk e ndërtove?

- Boll rrugë ka ndërtue Sala, or mixhë, - ia pret ai, një zeshkan me zë të ngjirur dhe shton: - Tani ua kemi lanë në dorë ju të kuqve, ta bani dhe ju njiherë belí, se votat i përlatë! Bëjeni të paktën veç një rrugë, këtë që po na trazon plënc e zorrë!

- Po, po... me at' mendje bani fllad vetes ti. Qeveria jone veç me ju fry n'bythë ka mbetë, se paret na i skërllupi Sala! Një vajzë në ndenjësen para meje kthen fytyrën e thartuar nga xhami, mandej kërruset mbi një celular. Për të satën herë plaku përbri kërkon të hyjë në bisedë. Tani rreh me këmbëngulje të shkepë prej meje ndonjë miratim, ndonjë fjalë solidariteti:

- Hala i mbajnë shpresat te Salë Marrja, a e dëgjon? Unë tund kokën në mënyrë të papërcaktuar, pa ia ushqyer kuvendimin. Pasi ka kaluar një kohë boll e gjatë, mesoburri zeshkan e me zë të ngjirur kthehet përgjysmë në profil dhe i hedh fjalën plakut bri meje, i cili kuvendon me zë të ulët me plakun tjetër:

- Me ty e kam, or Xhemë! A po më dëgjon? Si ju priti Komiteti i Veteranëve, more? Apo nuk jua vari torbën fare?

- Mos na e baj gajlen, or teveqel i kapajtëm, - ia priti si bubullimë Xhema. Pa shih këndej... n'daç me e dijtë, na ka pritë e na ka sajdisë vetë zonja ministre! Keni me e pa ju, tradhtarët, se çfarë feste kemi me ngrehë!

- E di, e di or mixha Xhemë! Pashë nji shoqin tuej tue shkrujt me bojë të kuqe nji parrullë te Ura e Drinit: "Mirë se vini Veteranë të Dibrës!" Po a s'më thue, bre mixhë, sa kokrra bëheni?

- S'ka ç'të hyn n'alet ajo punë ty, - ia ktheu, s'di pse i nxehur, plaku dhe me këto fjalë, duket se e mbylli komunikimin me zeshkanin e ngjirur.

Ra prapë heshtje. Pleqtë dukeshin si tepër të mbajtur për të qenë në moshën e veteranëve pjesëmarrës në LANÇ. Dikur gjeta rastin dhe pyeta Xhemën:

- Çfarë moshe jeni, or mixhë?

- Paj, i kceva të gjashtëdhjetë e tetat kët motmot... Shoqi em asht nji vjet mbrapa meje. Pse po pyet, or djalë?

- Kot... në fakt, jo krejt kot, - zura të shpjegoj. - Desha me e ditë a keni marrë pjesë në luftë... meqë dëgjova se ju paskan thirrë në Ministri, si veteranë. Me nji fjalë, ju jeni pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare, apo jo?

- Po, në njëfarë mënyre po, po...

- Por, mixhë, në luftë nuk merret pjesë në njëfarë mënyre: o keni marrë, o s'keni marrë...

- Po, mor po! Kemi luftue... unë e shoqi em!

- E qartë! Por nëse keni marrë pjesë, atëherë sa vjeç i bie të keni qenë në fillim të luftës? Më falni, or mixhë, por nga sa thoni ju për moshën që keni, i bie që ju të keni lindur në 1946 dhe shoqi juej një vit ma vonë. E që të marrësh pjesë në një luftë duhet që, më së pari, të keni pasë lindë. Por ju të dy keni lindur pas Lufte, apo jo? Atëherë, veteranët e cilës luftë jeni ju?



- Or Xhemë, - e tundi në krah shoku i vet - pse mor i bekum e zgjat muhabetin tërkuzë? Por Xhema rrihte me dalë prej sikleti në mënyrën e vet, sepse tani njerëzit në furgon ishin kthyer për të dëgjuar bisedën dhe një pjesë kukuriseshin me të madhe.

- Papapa...! Qenke djalë i keq ti, - u ndez Xhema, - po ty, a të rren mendja me më kap në rrenë, mor pizeveng provokator? Kemi luftue, posi! Kemi luftue me diversantat, ditë e natë bile! E kam për kreni! Poooo... për kreni e kam! ata veteranët që kanë vrarë shqiptarët, jo okupatorin... E kuptova! Por s'e kuptoj pse ofendon kur mund të përgjigjeshe i qetë.

- Se ti nuk po pyet si njeri, ti po provokon... - tha i nxehur Xhema.

- Jo, bre mixhë, jo... Të pyeta sa me të nxjerrë në rrenë. Tani na thuaj, kush është provokim, pyetjet e mia, apo rrena juaj?

- Po ty, çfarë të hyn n'alet?

- Më hyn që ç'ke me të... Se ju merrni pensionin, jo si veteranë, por si ish-sigurimsa. E paratë e këtyre pensioneve merren nga taksat e mia e të gjithë taksapaguesve. Atëherë ç'punë keni ju të dy me veteranët e luftës? Këtu mixha Xhemë luajti menç krejt, se brofi menjëherë në këmbë, por ndodhi kthesë e fortë: koka iu përplas në tavanin e furgonit dhe ra përdredhtaz prapë në vendin ku qe ulë. Mbas do grimë kohe i briti me një zë të idhtë shoferit:

- Or ti, djali i timonit! Pa ndale maqinën... ndale të thom!

- Pse mor mixhë? - tha mbyturazi shoferi që qeshte nën zë.

- Ndale, mor po t'thom! Ja ke me e zdripë këtë qepazen m'tokë, ja do t'zdripi vetë! Për çudi, shoferi mori një kthesë tjetër, gjeti një vend të gjerë e të volitshëm, e ndali makinën dhe hapi derën. Mandej, i kthyer nga fundi ku ishim ulë ne, i briti gjithë nerva veteranit Xhemë:

- Deshte me e ndalë furgonin? Qe ku e ke derën e hapur. Afrohu e merr lekët e tua mbrapsht dhe zbrit poshtë... në mos, do vij vetë me të flakë përjashta, sa çel e mshel sytë! Ai zotnia atje nuk të ka kurrnji faj. Hë pra, zbrit...! Por Xhema nuk lëvizi. Mandej, i nxehur si një fëmijë, me damarin e kërcyer të ballit dhe fytyrën e ndezur prush, shpalli:

- Heu, a qashtu ma bane, a? Epo për inatin tand e të gjithë qepazeve ktu, nuk e luej kambën prej vendit!

Fill mandej shpërtheu një e qeshur e fortë, e përgjithshme. Atëherë shoferi ngriti të dy krahët, sikur të shfajësohej përpara të gjithëve, para kalamallëqeve kapriçoze të tipit "epo ç'ti bësh?". Mandej duke ndezur makinën iu kthye për herë të fundit veteranit Xhemë:

- Epo nëse nuk do të dalësh, ulu e trys aty ku je dhe shuj, se po nise prapë, vallahi, vetë kam me të kapë për krahësh e për kambësh e kam me t'fluturue si presh, në një nga kthesat e Qafë-Buallit!

(Shkëputur nga vëllimi me ese "Nga hiri i të vdekurve", botimet M&B, Tiranë, 2014 ISBN: 978-9928-172-39-6. 164 faqe. Çmimi: 700 lekë)

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Mazalla (maadh-Allah) - kam deshmitar Zotin,kerkoj mbeshtetjen e Zotit
Vallahi - per Zotin
Alem - botya. - Prej ketu ibreti alem - shembull per boten
Kane - kna- nje lloj bime, lulet e te ciles grate, sidomos nuset e reja, i perdornin per ekstraktin me te cilin ngjyronin floket.
Kallup- forme, model.

Firaun - faraon
Gjynah - mëkat; krim; Prej këtu: gjynahqar që ka marrë kuptimin "i gjorë"
Han – pijetore
Haps – burgim, burg.Prej këtu habs + hane- burg.
Harxhe - shpenzime; para për shpenzime
Hudud - kufij
Hyqëm – qeverisje, pushtet
Jahudi - çifut
Kandar – kujntal
Kasap- thertor,mishprerës.Prej këtu kasap + hane - thertore
Katrion – një llojë bime medicinale
Matare – calik uji
Matuf – budalla, idiot
Melaiçe - ëngjëj
Miraz - trashigim, trashigimi
Murtad - tradhëtar, tradhëtar i fesë islame
Mushama – tekstile e lyer me dyllë.kundër ujit
Naksan – e metë, difekt mendor; gjë e mangët, jo e plotë. S'ka insan pa naksan- s'ka njeri pa të meta.
Qebab - mish që skuqet në prush
Salem – i padëmtuar, i shpëtuar
Sarraf - kambist, arkëtar banke; mbledhës taksash
Serë - rri rojë; vigjilon, vëzhgon, kujdeset. U bë serë i dynjasë - u bë objekt vëzhgimi i botës
Tebdil – ndërrim. U bë tebdil - u ndërrua
Telash – humbje, degradim, lodhje
Teskere – biletë. Ia dha teskerën- ia preu biletën
Unur – gur zjarrnxjerrës

Faiz – interes, kamatë
Fajde – perqindje, fitim
Fakir – i varfer, i gjorë
Fakirfukara – shprehje e përbërë nga fjalët fakir dhe fukara – që do të thotë i varfëri i të varfërve
Fall - ougur, shenjë
Farfuri – flutur
Farz – imponim, detyrim.
Fatiha – surja e parë e Kuranit
Felek - kupa e qiellit; qiell; gjithësi; orbitë
Ferk– ndryshim, dallim
Fesat – degjenerim, korrupsion, që këtu fjala fesatçi
Fetë - fetë
Fil – elefant; U bë fil - u bë si elefant
Filani - akcili
Filiz - diçka e shtrenjtë; loçka e zemrës;
Fiqir - mendim, opinion,
Firak - ndarje
Firar - ikacak , ai qe ia mbath me vrap. U bë firara - ia mbathi, iku
Firaun - faraon
Fiter – mbarimi i agjërimit
Fitil - fill; fill ndezës, tampon.
Fitne – grindje, spica; trazira. Prej këtu fitnezhi – njeri që fut spica
Fodull - kërshëri; kureshtje.Në Dibër fjala përdoret me kuptimin e njeriut që e mba veten më të madh.
Fukara – i varfër.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Komuna e Fushë-Çidhnës nderon Hysen Repën
Komuna Lis nderon dy personalitete të krahinës



"Nderi i Komunës" për Gjeneralin nga Fushë Alia

Këshilli i Komunës së Fushë Çidhnës ka nderuar fundvitin që kaloi me titullin "Nderi i Komunës" njërin nga personalitetet e kësaj krahine, Hysen Jonus Repën.

Me propozim të Kryetarit të Komunës, z. Aranit Skepi, Këshilli i Komunës në mbledhjen e datës 24 dhjetor 2014 i ka dhënë titullin djalit të kësaj krahine me motivacionin "Për kontributin e dhënë në vlerësimin, propagandimin e vlerave historike ,traditës , turizmit të Çidhnës dhe Fushë Alies, aktivitetin ushtarak dhe intelektual të krahinës", thuhet në certifikatën e dhënë me këtë rast.

Hysen Repa ka lindur në Fushë Alie me 26 janar 1948. Arsimin 7-vjeçar e ka kryer në fshat, të mesmen në shkollën "Skënderbej" në Tiranë ndërsa është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. Më vonë ka kryer Fakultetin e Ekonomisë në Shkodër (1978) dhe Akademinë Ushtarake në Tiranë (1971).

Ai ka një karrierë të shkëlqyer në ushtri. Mban gradën e lartë Gjeneral Brigade që nga viti 1997. Më herët ka punuar si pedagog në shkollën teknike "Skënderbej) (1972-1975), Shef Divizioni në Shkodër (1975-1980), Shef Teknik dhe zv. Komandan Divizioni (1981-1992), Drejtor Transporti në Ministrinë e Mbrojtjes (1992-1993), Drejtor i Logjistikës po në këtë ministri (1994-1996), anëtar i Komitetit Ushtarak të Standardeve(MASS), në NATO, Bruksel (1996), Komandant Divizioni në Shkodër (1997), etj.

Në vitin e vështirë 1997 ka qenë bashkëkomandant me forcat paqeruajtëse spanjolle në Lezhë e Shkodër. Ndërsa gjatë kohës së luftës në Kosovë, ka marrë pjesë në stafin logjistik të UNHCR për përballimin e krizës humanitare. Me temën që lidhen me përballimin e krizave të emergjencave civile ka marrë titullin Doktor Shkencash.

Pas vitit 2000 ka punuar pranë Kryqit të Kuq Gjerman, Drejtor i Shërbimit të Trupit Diplomatik (2005-2009) dhe më pas specialist pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (2009-2012), derisa del në pension.

Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer edhe studime e kërkime që lidhen jo vetëm me ushtrinë por edhe me historinë.

Ka shkruar dhe botuar kërkime në fushën e projektimit dhe prodhimit të karroficines për mbështetjen me riparim te njësive ushtarake, përgatitjen e hartave profesionale të burimeve ekonomike, natyrore dhe rrugëkalimet në Shqipëri, si dhe ka referuar në simpoziume shkencore për organizimin ushtarak dhe popullor të krahinës së Dibrës, mbi historinë e revolucioneve dhe rebelime në Shqipëri si dhe mjaft artikuj mbi Luftën Nacionalçlirimtare, masakrën e Fushe Alies në 1944 dhe historinë e lavdishme të krahinës së Çidhnës në shekuj.

...Ishte një surprizë nga më të bukurat për mua... Ky vlerësim më detyron që të angazhohem më shumë për ata njerëz të Çidhnës, të një krahine me histori brilante jo vetëm në Dibër, por në mbarë Shqipërinë".

Gjatë karrierës së tij ka zhvilluar kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si në SHBA, Turqi, Gjermani, Belgjikë, kryesisht mbi mbështetjen logjistike dhe planifikimin e mbrojtjes. Gjatë viteve të tranzicionit ka dhënë kontributin e tij politik në stafet elektorale të Partisë Demokratike, kryesisht Sali Shehut në Dibër dhe Besnik Mustafajt e Spartak Ngjelës në Tiranë.

Komunikon në gjuhët anglisht, rusisht dhe italisht. Është babai i katër fëmijëve, njëra prej të cilave, Artemisa, është një nga sopranot më të mira shqiptare që po e ushtron veprimtarinë e suksesshme artistike mes Brazilit dhe Italisë.

Hysen Repa aktualisht po luan një rol në ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi rolin që kanë luajtur luftërat e dibranëve, kryesisht në periudhën kundër Perandorisë Osmane. Një faqe në FB me emrin "Battle of Torvioll" moderohet prej tij, ku mblidhen dhe botohen materialeve që kanë të bëjnë me betejat e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane, njëra prej të cilave është ajo e njohura me emrin "Beteja e Torviollit". Gjatë procesit të ndërtimit të lapidarit në kujtim të kësaj beteje, ai luajti një rol si në organizimin, ashtu edhe në dhënien e ideve dhe konsultave për një monument madhështor.

"Ishte një surprizë nga më të bukurat për mua", thotë Hyseni, i cili nuk mundi të ishte i pranishëm në ceremoninë e marrjes së çmimit, për arsye të reshjeve të mëdha të dëborës që bllokuan qarkullimin normal mes Tiranës dhe Dibrës. "Por unë kam qenë mes atyre që më vlerësuan. Aty ka qenë edhe "babai" im, Jonus Repa, thotë ai me të qeshur, duke iu referuar nipit të tij, i cili mban emrin e babait. Ky vlerësim më detyron që të angazhohem më shumë për ata njerëz të Çidhnës, të një krahine me histori brilante jo vetëm në Dibër, por në mbarë Shqipërinë".

Korresp. "Rr.e Arbrit"



Faik Xhani dhe Hasan Frangu shpallen "Qytetarë Nderi"

Në ditët e fundit të muajit janar 2015, Këshilli i Komunës Lis në Mat vlerësoj në titullin e "Qytetar Nderi" intelektualët Faik Xhani e Hasan Frangu.

Një vendim i drejtë, e pak i vonuar, që vlerëson banorët e kësaj treve në tradita, nderon Këshillin e komunën dhe intelektualët e kësaj zone.

Ceremonia zyrtare e hapi juristja e komunës Nertila Kurti, folën Kryetari i Këshillit të Komunës z. Shkëlqim Kola, Kryetari i Komunës Lis, zoti Agim Selita.

Në emër të Shoqatës së Përgjithshme të Pensionistëve të Shqipërisë, shoqata që ka bërë dhe propozimin, përshëndeti studiuesi dhe shkrimtari, Velo Cfarku.

Me mjaft vlerësim për këshillin e komunës dhe për Faik Xhani e Hasan Frangu, folën poeti Basir Bushkashi "Qytetar Nderi" i Burrelit, Enver Hasa, Kryetar i Shoqatës për Tiranën, Sportisti Shefki Çupi. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre në këtë ceremoni gazetari dhe shkrimtari Hysen Kosovrasti ardhur posaçërisht nga Dibra e Madhe, si dhe historiani Sefer Duka.

Për të pranishmit, familjarët e Faik Xhanit dhe Hasan Frangut shtruan një drekë në një restorant në Zinisht ku më të bukur e lënë këtë ceremoni përshëndetjet e miqve, shokëve dhe familjarëve si dhe rapsodi Halim Laçi, ardhur nga Fushë-Kruja dhe këngëtari i njohur matjan Shkëlqim Farrici që këndoi këngë matjane, dibrane dhe nga gjithë Shqipëria.

Faik Xhani është njëri nga bashkëpunëtorët e gazetës "Rruga e Arbërit", dhe në përshëndetjen e redaksisë me këtë rast, u tha se "Lajmi i shpalljes Qytetar Nderi të bashkëqytetarit tuaj, por edhe mikut tonë, Faik Xhani", na gëzoi pa masë, thuhet në përshëndetjen e redaksisë. "Sepse Faiku e meriton titullin që Ju i keni dhënë, sepse Faiku ju ka nderuar gjatë gjithë veprimtarisë së tij: civile, shoqërore, kulturore, duke respektuar jo vetëm veten dhe familjen, por gjithë krahinën tuaj. Faik Xhani është nga ata djem të kësaj zone, me të cilët nuk jeni krenar vetëm ju, por edhe ne që e njohim, që punojmë e bashkëpunojmë me të. Faiku, që nga dita e parë e botimit të gazetës Rruga e Arbërit, ka qenë një dashamirës dhe kontribues. Ai ka qenë një aktivist jo vetëm i medias, por edhe i çështjes sonë të përbashkët. Për Faik Xhanin nuk mbarojnë fjalët e mira në këtë ditë të shënuar: ato nuk janë kurrë me tepri për të, por nuk mjaftojnë sido që t'i rendisësh, Ndaj shkurt po themi se Faiku është virtyti i qytetarit që udhëheq me shembullin e mirë dhe fjalën e qeshur!"

Faik Xhani është bashkëpunëtor i gazetës "Rruga e Arbërit". Ai, që nga dita e parë e botimit të gazetës, ka qenë një dashamirës dhe kontribues, një aktivist jo vetëm i medias, por edhe i çështjes sonë të përbashkët...

Mes këngëve e valleve, trokitën gotat dhe uruan Faik Xhanin e Hasan Frangun, ta gëzonin titullin "Qytetar Nderi!".

Ilmi Dervishi

Njoftim

Në shkollën tuaj keni një talent që duhet promovuar, në lagjen tuaj keni një artist që duhet prezantuar, një artizan duarart, një mjek të aftë, një bujk punëtor, një qytetar shembullor...

Pranë jush gjendet dikush që e meriton që shembulli dhe puna e tij të bëhet e njohur...

Na shkruani në adresën e emailit ose na ndiqni përmes faqes në FB "Rruga e Arbërit" dhe një gazetar i yni do të vijë pranë jush...

Mos ngurro! Gjithmonë ka gjëra të mira pranë jush që duhen vlerësuar!

shkruaj email: <rrugaearberit@gmail.com>

emigracion

Në Selanik me Lirën
e Zini Shatkut...

Të bësh **vend** me djersën e ballit **në mërgim**...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Isha ulur së bashku me shoqen time të jetës, Natashën, në hollin e hotelit rreth katër tavolinave bashkuar, në një shoqëri mësuesesh të Selanikut. Atë ditë që për rastësi përkoi me ditëlindjen time, 73 vjetorin, u prezantua në një mjedis të gjerë në Universitetin Aristoteli libri im monografik "Shkolla shqipe e Selanikut". Në një mjedis solemn asnjëherë nuk arrihet të thuhen gjërat që burojnë nga zemra, respekti i ndërsjellët çka e bën njeriun njeri. Ndaj ato erdhën drejtpërdrejt, pa shkuar në shtëpi. Erdhën për tu ulur bashkë për ta gjerbë në qetësi kafen e ndjenjës shoqërore dhe respektit. Nuk mund ta përshkruaj gëzimin që çelte fytyrat e i ngjizte zërat si në një simfoni. Ishin çaste të bukura që nuk i harroj kurrë. Shumë fotografi të çastit ma mbajnë të lidhur kujtimin siç lidhet mbishartesa me nënshartesën në biologji...

Ndërsa bisedonim dhe shkëmbenim batuta humori, në portën e kafenesë silueta e një gruaje me një fëmijë përdore tërhoqi vëmendjen e Natashës.

- Lira- tha ajo.

- Lira, kush Lirë?- pyes unë duke e shkëputur vëmendjen nga mjedisi mes mësuesesh.

- Lira Shatku,- plotëson. – Nuk e mban mend? Është vajza e Ziniut, shokut tënd që banonin në katin e dytë të hyrjes tjetër të pallatit tonë, vajza e Demes.

- Po, i them unë. Jam lidhur me të në facebook kur përcolla një fotografi të Ziniut, mjeshtrit të mrekullueshëm në SMT që çfarë i thoshte mendja ia bënte dora.

E kishim pirë kafen, i kishim zbrazë ndjenjat e respektit me mësuesit. U ndamë mes urimesh njeri me tjetrin...

...Lirën e mbaja mend ashtu të vogël, topolake, me buzëqeshjen dhe respektin e veçantë që i lexohej në sy. Ishte si një lule në oborrin e pallatit tonë që mbyllte nga e djathta vargun e godinave që përfundonin te shkolla bujqësore. Koha mua më përplasi larg duke i mbyllë pa dry kujtimet për vendin dhe njerëzit.

...Lira kishte marrë vesh se unë më 11 maj 2014 do të isha në Selanik ndaj më kishte kërkuar numrin e telefonit me dëshirën që të më takonte.

U ulëm për të "ndenjë" dhe për të "ikur"...

...Lira Shatku, tash me një mbiemër të ri, Lira Selmani, ishte martuar me Ramadan Selmanin, të birin e Laim Selmanit nga Dovolani...

Kaq u desh që të "ngriheshim" dhe "të iknim".

Të zbrisnim të tatëpjetën e Qenokut, kodrës që ndan "Dy Dibrat" mbushur asokohe me kumbulla, arra, gështenja, mollë, dardhë, jo pak por mbi pesëdhjetë mijë, dobësi e jetës sime që lidhej me kujtimet kur piketonim e mbillnin pemë, jo pak por mbi pesëdhjetë mijë...

Të merrnim kthesën dhe të hidheshim e binim rrugës së kalldrëmtë të përroit për tu ndalë pak në sheshin që dominon Dovolanin, për tu përkulë me respekt përpara bustit të Heroit të Popullit Nazmi Rushiti që, siç thotë kënga "Këmishën e zezë ia bëri të kuqe" italianit në Zerqan.

Të zbrisnim më tej rrugës që e ndan fshatin në dy pjesë e të pinim kafe në oborret e mbushura me lule nën veshulët e rrushit varur mbi kokë...

Më pas të "vinim" shtatëmbëdhjetë vjet të shkuara kur familja e re erdhi dhe u vendos drejt e në Selanik për të hedhë rrënjë e lëshuar degë.

Thashë "për të hedhë rrënjë" se tashmë familja Selmani, e Lirës dhe e Ramadanit ka shtëpinë e vet. Blerë me mundin dhe djersën e punës së Lirës "shtëpi më shtëpi" dhe të Ramadanit me "të gjitha punët"...shtrim pllakash, lyerje, suvatime, patinime...

Çifti ka tre fëmijë, tre djem, njeri 23 vjeç, Xhino, me shkollë profesionale i dyti, Serxhio, njëzet vjeç, që vazhdon studimet e larta dhe i treti..."

"Këtë e nisëm për gocë dhe na doli çun", thotë Lira duke e përkëdhelur Marion. "Flet shqip, bile puro dibrançe"- vazhdon duke qeshur. Në festën greke të 25 marsit në kopsht ku shkonte, kur e pyetën se çfarë je u tha: "Nuk jam grek, jam shqiptar!"

Nuk mund të rrinim gjatë pa u kthyer përsëri në Peshkopi, pa folur për Ziniun, mikun tim më të mirë...

Më tha se Ziniu iku për të mos u shikuar e dëgjuar, për të mos përcjellë buzëqeshjen njerëzore, e veçantë për të, më 31 dhjetor 2008.

Ndjeva dhembje. Zini Shatku la pas portretin e paharruar të njeriut të dashur, të punës e të përkushtimit pas saj, deri në shkallën e mjeshtrit. Për mua ka qenë një nga miqtë më të mirë. E kisha nxënës në shkollën e mesme të mbrëmjes, më kishte nxënës kur kërkoja të përvetësoja dijet praktike në mekanikë, e kisha komshi në të njëjtin pallat. Folëm me Lirën për të me një pikë loti në sy e malli për këtë dibran të rrallë e prind të mrekullueshëm. U gëzova për fëmijët e tij që kanë ecur në jetë dhe e kujtojnë babanë e tyre me dashuri të pashuar...

Nuk mund të rrija pa e pyetur për të vëllanë, Dritanin aq i pasionuar pas mekanikës që ia pat marrë zanatin babait aq mirë sa prisja që të më thotë se ka hapur punë të vetën në riparimet mekanike në Tiranë. Më tha se është në Itali. Përfundoi universitetin për matematikë - fizikë por sot e 15 vjet ndodhet në një province të Milanos (Broni) duke punuar si fermer në vreshta dhe shofer.

Nuk mund të rrija pa e pyetur për nënën e saj, Demen, rrobaqepësen e mrekullueshme që gëzonte respekt tek të gjithë jo thjeshtë për gjilpërën në duart e saj, por për kulturën që rrezatonte, për zërin e ëmbël në bisedë. Demja është me të birin, Dritanin në Itali...

E pyes në se e merr malli për Peshkopinë. "Shkoj, më thotë. shkoj dhe nuk gjej asnjë të njohur. Kemi truall tek Llixhat. Pronë e jona është, të vjehrrit. Themi të hapim një punë, të bëhet Rruga e Arbërit..."

E pyes për të ardhmen...

"Do iki, por jo në Shqipëri, në Gjermani. Kemi hedhë dokumentet për pasaportë për tim shoq. Të shohim. Djali i vogël donë në Shqipëri, i pëlqen Shqipëria..."

Ndërsa zbardhja, pas tetë muajsh, kujtimet e asaj dite, një cikël fotografish në rrjetin social më tërhoqi vëmendjen. Lira, Ramadani dhe Mario pozonin mes bardhësisë së dëborës në ditët e ndërrimit të viteve 2014-2015. Vitin e Ri 2015 e kishin kaluar mes bardhësisë së dëborës dhe bardhësisë së shpirtit të njerëzve të tyre.

Dibra, edhe pse larg, për ta është pranë, në shpirt...



Ndërsa zbardhja, pas tetë muajsh, kujtimet e asaj dite, një cikël fotografish në rrjetin social më tërhoqi vëmendjen. Lira, Ramadani dhe Mario pozonin mes bardhësisë së dëborës në ditët e ndërrimit të viteve 2014-2015. Vitin e Ri 2015 e kishin kaluar mes bardhësisë së dëborës dhe bardhësisë së shpirtit të njerëzve të tyre.
Dibra, edhe pse larg, për ta është pranë, në shpirt...

PESHKOPI

30 mësues të shkollës së mesme profesionale, dy muaj pa paga

Tridhjetë mësues të Shkollës së Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", prej dy muajsh kanë mbetur pa marrë pagat. Mësuesit e kësaj shkolle, që nga muaji dhjetor 2013, nuk janë paguar. Shkak i kësaj duket se është bërë vendimi i qeverisë për kalimin e këtyre shkollave në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Në këtë kuadër edhe kjo shkollë, ka kaluar në varësi të kësaj ministrie.

Burime nga zyra e financës së Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, bëjnë me dije se që nga 1 dhjetori i vitit të kaluar shkolla profesionale ka kaluar në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinise dhe për pasojë pagat e mësuesve të kësaj shkolle duhet të paguhen nga ana e kësaj ministrie. Buxheti i kësaj shkolle, dhe në këtë kuadër, pagat e mësuesve si dhe zërat e tjerë të buxhetit i kanë kaluar kësaj ministrie.

Ndërkohë që pritet të bëhen ndryshimet përkatëse në buxhet për kalimin e varësisë së shkollave profesionale nga varësia prej Ministrisë së Arsimit në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, 30 mësuesit e kësaj shkolle vijojnë të mbeten pa paga që nga 1 dhjetori i vitit të kaluar.

"Kalimi në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, thonë mësuesit e kësaj shkolle, na ka bërë që të ndjehemi të diskriminuar në krahasim me kolegët tanë. Nuk arritëm të marrim rrogën edhe të dhjetorit për të festuar vitin e ri, ndërkohë që një gjë e tillë nuk u realizua edhe në muajin Janar të vitit në vazhdim. Kjo i ka bërë këta mësues që mos e quajnë një zgjidhje të duhur kalimin e shkollave profesionale në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale. Historikisht, thonë mësuesit, shkollat profesionale kanë qenë dhe duhet të jenë edhe në vijim në varësi të Ministrisë së Arsimit, pasi plan-programet e shkollave, cilatdo qofshin ato, mund dhe duhet të hartohen vetëm nga Ministria e Arsimit që është e specializuar për një veprimtari të tillë.

H.Likdisha

LIBRI I RI



ZYBER GJONI
ÇIDHNAKË NË SHEKUJ
Botimet M&B
ISBN 978-9928-172-28-0
Çmimi: 1000 lekë

Rruga e Arbërit nr. 105

Dr. Islam Cani me librin "Çidhna dje, sot nesër" dhe Haki Përnezha me: "Krahina e Çidhnës", me plot guxim kanë marrë përsipër të hedhin fashë drite mbi ngjarje të ndryshme të historisë së krahinës së Çidhnës.

recensë

Historia e Çidhnës përmes dy studimeve

Nga **SELMAN MËZIU**

1. HYRJE

Të gërmosh me plotë vullnet, këmbëngulje e pasion me parmendën e drujt të dijes, për të nxjerrë nga larvat e shumta të shekujve bëmat historike të një populli, fshati, krahine, apo të Dibrës në tanësi asht mjaft e vështirë, kjo sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, gjetjet arkeologjike, emërtimet gjeografike, studimet në lëmrat e toponomistikës, onomistikës etj.

Por, megjithatë, studiuesit me plot guxim kanë marrë përsipër të hedhin fashe drite mbi ngjarje të ndryshme të Historisë së krahinës së Çidhnës si **Dr. Islam Cani me librin "Çidhna dje, sot nesër" Studim sociologjik – historik, Tiranë 2013** dhe Haki Përnezha me: **"Krahina e Çidhnës" Histori dhe etnokulturë**, **Tiranë 2013.**

Secili nga historishkruesit duke ballafaquar ngjarjet e ndryshme me literaturën e bollshme të shfrytëzuar, kanë kërkuar të bëjnë analiza e të nxjerrin përfundime mbi ngjarje, heronj, përpjekje e ndeshje ushtrishë kundërshtare si dhe të shkruajnë mbi zakonet veshjet, festat e ndryshme, jetën shoqërore, besimet fetare, veprimtarinë e udhëheqësve popullor e burrave të zgjuar etj.

2. ETIMOLOGJIA DHE PREJARDHJA E EMRIT ÇIDHËN

Tanima asht bamun e zakonshme, që të shprehim pengesat dhe deri në të pamundurën për të zbuluar të vërtetën e fshehur nëshkulmimet e shekujve. Dhe ja të ndjekim sëbashku se çfarë udhe arsyetimi ka ndjekur I.Cani. Ai shprehet kështu në faqen (f. 70): "…një liqen në qendër të Greqisë mban emrin *Kidhna,* emër që dotë thotë "*dru."* Ndërsa pothuajse në fund të librit ai i drejtohet veprës së Homerit të lashtë: "Odiseja" në të cilën ai shkëput shprehjen (f. 267): "Odiseja me trup fizik me mendjen e tijë, mprehtësinë e largëpamësinë të shkon ndërmend se ai e fiton këtë betejë të ashpër dhe e pagëzoi shtegun me emrin *Çirçe* (Zana)." Kurse më tej ai si njohës i mirë i toponomastikës së vendlindjes ka bamun krahasimin (f.140) : "Te njëjtën vëmendje i kam kushtuar edhe ndryshimit të emrit *Kidhna, Çidhna*…… se mos ka të bëjë me vendosjen e *Çidhnës së Vjetër* në zonën mbi Mashotin në vijën ku ndahet Xhaxhishti me ketë të fundit apo atje ku kemi shtegun e keq *Çirçe*, ku fusha dhe rruga ka nje emër *Çirç."*

Ndërsa studiuesi tjetër H.Përnezha zgjedh një arsyetim krejtësisht të kundërt me të parin dhe ja (f. 14 – 15): "Dokumenti me i vjetër…është ai i Prokopit të Çezarese, në shekullin e VI" i cili e përmend emrin e fshatit (dhe më gjerë në formën *Kethinja (Ke –thinj-a).* Me vonë, në vitin 1467 (tefteri turk i regjistrimit të popullsisë S.M.) vjen me merin *Gizzine (Gi-zzi-ne)* (pasuar me mbiemrin "e poshtme e sipërme"). Ne vitin 1560 ne dok.nr.1" vjen me emrin *Kedene (Ke-(z)de-ne).* Në vitin 1583 vjen me emrin *Kezina (Ke-zi-na).* Ne vitin 1903 vjen në formën *Kizina (Ki-zi-na),* ndërsa në vitin 1916 me emrin *Çezina (Çe-zi-na)."*

Dhe me tej ai vazhdon të njëjtin arsyetim me prejardhjen e emërit *Sina,* merr në konsiderate emërtimet e disa vendeve si Mëzes, Vok Seta, Malet e zeza dhe citon gjithashtu dy herë udhëtarin austriak Johan Georg von Hahn. Përfundimi i tijë është ky: "*Kështu ne përfundojmë se emri i krahinës sonë vjen nga thellësitë e shekujve dhe në bazë të tij qëndron mbiemri* ***(i) zi.*** *Konfiguracioni gjeografik dhe numri i madh i toponimeve që lidhem me këtë mbiemër, shkon në favor të mendimit tonë për prejardhjen e emrit Çidhna."*

Të dy autorët parashtrojnë vetëm nga një variant domethënë të tyren, në të cilën i pari asht lidhur me Odisen e Homerit dhe me një toponim në Greqi, ndërsa i dyti duke u mbështetur në dokumenta në turqisht e latinisht, i cili kërkon të na bind ndërmjet rrokëzimit për të vënë në dukje rrënjën **fjalës *i zi***. Të dyja mbartin dyshime dhe nuk kanë force argumentuese. A njihen hipoteza të tjera mbi prejardhjen e emrit të kësaj krahine?

Haki Koltraka një tjeter histori shkrues i Kastriotëve ka vënë në dukje (f. 8): "*Kjo derë e vjetër (Kastriotët S.M) sipas Herodotit nis nga mbreti pellazg Kidni, që e shtrinte zotërimin e tij mbi fisin Peneste të luginës në pellgun e Drinit të zi që shtrihej nga Lura deri në Ohër." (3)*

Një ndër banorët e parë të kësaj treve ka qenë Ilio Idhnaku. Mbiemri i të cilit i mbeti sepse ishte me karakter shumë i prekshëm, idhnohesh me pak gja, pra rrëmbehesh në diskutime e gjykime, vepronte e arsyetonte me gjakënxehtësi. **Çi- idhnak** që jeni juve Ilio. Sipas rregullave gjuhësore të morfologjisë kemi rënien e një shkronje "i" dhe kështu rrjedh fjala *çidhnak* me të cilën, filluan të quheshin më pas banorët e këtyre anëve dhe vetë vendi mori emrin *ÇIDHNA.(4)* E marrë nga gojëdhanat që vazhdojnë të qarkulloin ende në odat çidhnake.

Në relacionin e Pjetër Mazrekut të vitit 1633, do ë shkruantë: "*Prej natyre janë* ***idhnakë*** *e hujli, por pastaj ulen e kuvendojnë me të kënaqë…*" (f.41. "Krahina e Çidhnës" H. Përnezha)





Megjithë materialet e studimet e mësipërme mbetet ende i paqarte etimologjia, dhe prejardhja e emrit të Çidhnave. Zbulimi në të gjitha mënyrat e shfaqjes në kohë e hapësirë kërkon ende kohë, studime më të thelluara dhe tërheqja e gjithë mundësive të prejardhjes të emrit Çidhën, duke i analizuar këto hipoteza mund te dilet me përfundime të bindshme, të qëndrueshme në kohë.

3. NDARJET E ÇIDHNËS

Duke përqasun dy studimet do të vëmë në dukje si ashtkryer ndarja e Çidhnës si krahinë e si fshatra, formimet dhe shpërbërjet e tyre. Cilat janë kriteret që janë marrun në konsideratë, dhe si asht realizuar ky unitet historkio-etnografik?

Studiuesi I.Cani në lidhje me sa më sipër shkruan: "*Çidhna, përfshin vetë veten me fshatin Grykë Nokë, dhe fshatrat: Arras, Gryk-Noka, Kodër –Leshe, Laças, Mustafaj, Rrennxi, Sina e Epërme, Sina e Poshtme, Kandri, Kuke, Bresti i Poshtëm, Bresti i Epërm e deri në Kuben me rreth 10040 banorësh."* (f.24)

Për të nxjerrë në pah saktësinë e përshkrimit gjeografik, do të citojmë studiuesin tjetër H. Përnezha i cili shprehet:*"…koha kur u lindën konaçet e krahinës, Çidhna përbëhej nga pesë fshatra dhe ato ishin si më poshtë: Në fshatin Çidhën u formua konaku i Spatës; në Grykë, konaku i Nokës; në Mustafe, konaku i Alisë; në Sinë, konaku i Kaloshit dhe në Arras konaku i Lushës."(f.237)*

Dhe më tej ai vazhdon: "*Çidhna malore lëvizi drejt asaj fushor.(f.250) …..tashmë të shpërndarë në 12 copë fshatra (13 fshatra u bënë pas vitit 1875, kur Bresti i Epër u bë pjesë e Çidhnës)..."(f. 252)*

Duke anlizuar si më sipër, dalin dy veçoritë e autorëve. Ndërsa studiuesi Cani, kërkon të përshkruaj gjeografikisht ndarjen e karahinës, dhe duke i kushtuar rëndësi relieveve, natyrës etj. Përnezha e fillon me lëvizjen e grupimeve të fiseve në Konaçe në oxhaçe etj, duke motivuar me shkaqet e ekonomike,konfliktet shoqerore për të argumentuar kalimin nga një fshat Çidhna e Eper në zmadhimin e saj deri në krahinë që shtrihet në dy krahët e Drinit të zi. Gjithashtu studiuesit të mësipërm, nuk i intereson se ku e ka fillesën Çidhna si fshat dhe banorë formuesit, ndërsa Cani shkruan:*"Sipas Defterit Turktë viteve 1467 figuronin këto katunde: Sina e Epërme, Sina e Poshtëme, Gardhi i Poshtëm, Arrasi, Shashari dhe Çidhna. Sipas mendimit tim kjo është e padrejtë sepse Çidhna ka qenë e vendosurnë të gjithë M.Faqë, Xhaxhenj, Gurë-Lurë e ndoshta padashje asht ba ndarja në dy pjesë siç thuhet* **Çidhna e Poshtme dhe Çidhna e Epërme** *që nënkupton Grykë Nokën me Çidhnën. Pra nga ana territoriale ajo ashtë një. Çidhna që përfshin fshatrat Grykë –Nokë, më vonë Sinët dhe Mustafet e Arrasit na japin të kuptojmë Çidhnën e vjetër. Ndërsa Çidhna e Re do të ishte kalimi i popullatës matanë Drinit, e cila tanima ka kuptimin krahinor të saj."f. 26*

Duke vazhduar arsyetimin e tijë studiuesi I.Cani ne f.(188) do të venë në dukje: "*Sipas Popullit Çidhna e Epërme fillonte nga Prati, shtrihej deri tek Gjurra e Xhixhit, me lagjen e Pashnjarëve të Grykë Nokës. Këtë e mbështet edhe Defteri Turk"*

Studiuesi Përnezha na jep një tjetër klasifikim: "*Krahina sot ka 13 copë fshatrapor* **mija** *e saj janë Arras, Sinë,Çidhën, Mustafe Grykë."* f, (323) Ndërsa nuk shkruan për nëndarjet Çidhën e Poshtme dhe Epërme dhe për rrjedhojë as për kufijtë topografiko- natyror.

Dhe më tej studiuesi Cani shprehet ndër të tjera: "*Shashari sot asht lagje e Kodër Leshe." f.26*

Autori i punimit tjetër ka shkruar: "*Edhe pse të vendosur në këto vend të lashta, si në Mustafe, Gryke, Çidhën" Sine e Arras,* (**Shashari e Krashi** *nuk egzistojnë ato janë shuar si fshatra)….f. (240)*

Nga një studiues tjetër çidhnak, Ali Hoxha duke shkruar mbi Defterin Turk të Marsit të vitit 1467, Pas Arrasit e Tartajve lexojmë:*"Krrash (Defteri Turk) Krrash(Indentifikimisipas mendimit tonëme katundet e sotme të Dibrës) Lagje (e Merskanës) 2 shtëpi në vitin 1467 (numuri i shtëpive sot – (asjnë shtëpi S.M) (f.68) (10)*

Duke arsyetuar nga pohimet e mësipërme dhe studimi i punimeve të I.Canit, dhe H. Përnezhes lindin pyetjet e më poshtëme:

1- A egziston ndarja e fshatrave, ose e lagjeve në Çidhën e Poshtëme dhe Çidhën e Epërme dhe cilat janë fiset e fshatformimit, e kufijtë natyror të tyre.?
2- Cilat janë origjina e formimit të emërtimeve të këtyre 13 fshatrave, për të cilat autorët nuk janë të të njëjtit mendim, dhe fiset e më të vjetër që kanë formuar ato?
3- Kur fiset apo konaqet e Çidhnës malore zbritën në vendet fushore (siç quhen ndryshe TOPALLTAJ), para viteve 1800 apo më vonë dhe cilat ishin motivet e bashkimit (gllabrimit) nga Çidhnakët?
4- Çfarë kriteresh kanë ndjekur autorët në përcaktimin e krahinës së Çidhnës: gjeografik, juridik, etnografik, politiko-klasor, fetar apo pse kanë shkuar një ose dy shtepia të një fisi dhe ja ky fshat i përket krahinës së Çidhnës?
5- Lagjia Shashari dhe Krashi egzistojnë apo janë kthyer në rrënoja, nga cilat vende të populluara apo toponime kufizohen? (Lexuesit dhe studiuesit kanë mbetur ne udhëkryq??)

4. QYTETI, QYTEZAT DHE KALATË

Qytetërimet e lashta dhe të vonshmet kanë lënë gjurmët e tyre në forma të ndryshme edhe në krahinën e Çidhnës, për të cilat të dy studiuesit kanë pasqyruar ato me forma të ndryshme dhe me pikpamje e përshkrime që dallohen më së miri nga njëri tjetri. A kanë mundur të dy sëbashku të na ndërtojnë me dokumentet historike, me provat arkeologjike të ndihmuar edhe nga toponomistika e gojëdhenat, kufizimet gjeografike dhe kohore të qytetit të Oenës dhe të Çidhnës? Dhe ja se si shprehen ato:

Historishkruesi Cani në lidhje me pozicionimin gjeografik të qytetit të Çidhnës do të shkruaj: "***Çidhna-qytet*** *sot fshat ka një Fushë me disa hektarë dhe disa gryka me emërtime si: fshat (lagje) Grykë Nokë, Bokas, Brethas, Maj, Dujs e Biz. Në qendër të qytetit në Biz është pusi qindra mijëra vjeçarqë quhet pusi i Dukes." f.(111)*

Ndërsa studiuesi Përnezha e ilustron idenë e qytetit të Çidhnës vetëm si kohë shtrirje duke shkëputur nje fragment nga studiuesi Iliaz Kaca: "*….qyteti i Çidhnëska nisur jetën në periudhën e hershme të epokës së bronxit2100vjet para e.r….." f.(7)*

Dhe më tej i njëjti autor do të deklaroi: "*Le të shohim''qytetin"e Çidhnës. Është i vendosur në një masiv shkëmbor, i cili ndahet më dysh nga Seta. Pjesa e shkëmbit në të djathtë të rrjedhës së Setës quhet kepi i Harlecit, ndërsa ajo në të majtë quhet Kepi i Xhitetit. Në perëndim të këtij shkëmbi vijon një luginë, e cila quhet Lugu i Shkallës. "Ky qytet lindi si nevojë e kontrollit të kësaj rruge ndër më të vjetrat dhe më të rëndesishme të Dibrës që lidhte trevën(jo vetëm Çidhnën H.P.) me labiatët."(I.Kaca) f. (10)*

Përpiqet në punimin e tij I.Cani të na japë kufijtë e Oenës i cili përmendet si emër qyteti nga kronisti i luftrave të Romakëve kunder vendeve të Ilirisë Tito Livio (viti 169 p.k.) dhe ja se si e përshkruan Autori: "***Oena*** *simboli qytetit dhe toponimet e saja e bëjnë të dallueshme dhe më bindëse ekzistencën e qytetit sot fshati i vogël Çidhën. f.(195)* dhe më tej: *"…..atje ku sot është Çuka e ura e Lushës, që ka lagjen e Lushës të Krashit dhe Bajrektarit e përfundon tek Ura e Setës" (fshati ARRAS, S.M.) f.198 ;*dhe i njëjti autor jep shtrirjen përfundimtare të qytetit të OENËS " ….. *Qyteti ka qenë në të dya anët e lumit të Setës që fillon nga Kepi i Qytetit deri në Gurë Lurë, anash këtij lumi me emrin e vjetër Artatus." f.(198)*

Duke dashur të japim një përcaktim të trojeve të sakta të qytetit(qytezës) së Oenës po shkëputim disa mendime te disa studiuesve:

Profesor Kristo Frashëri shkruan: "*Gjiteti i Qidhnës ndodhet mbi një kodër shkëmbore (640 mbi nivelin e detit) e cila kontrollon në mënyrë të padiskutueshmehyrjen në grykën e Setës. Ashtu siç thotë Livi për qytezën Oene-gjiteti i Qidhnës, nga njëra anë mbrohet prej lumit Setë, i cili në këtë rast përfaqëson lumin Artatus, nga ana tjetër prej Malit Pleshaj, të cilit i përshtaten fjalët e shkrimtarit romak se është një mal shumë i vështirë për tu kapërcyer. Në terracën shkëmbore duken gjurmë muresh antike , të cilat duhen pranuar, nuk jane "shumë të forta" siç thotë Livi për ato të qytezës Oene……" f.(145) (5)*

"…..se qyteti Oene- shkruan historiani Hilmi Sadiku-*gjendej pranë lumit të Artatasit mbi një mal shumë të pjerrët e të pakalueshëm, na japin mudësinë të mendojmë se qyteti Oene mund të lokalizohet në fshatin e sotëm Qidhën të Dibrës së poshtme, ku gjenden rrënoja e një kështjelle të kësaj kohe." f. (255) (6)*

Po kështu edhe arkeologu Ilaiaz Kaca do të arrijë në përfundimin: "*Mendimet e shprehura nga studiues të ndryshëm për indentifikimin e Oenes në Çidhën të Dibrës pajtohen sepse kushtet e favorshme natyrore, pozita gjeografike dhe strategjike, pozita në rrugë kalimin nga Dibra për në Shkodër nëpërmjet krahinës së Lurës flasin në favor të asaj teze…. Në mbështetje të mendimit të shprehur më lartë janë dhe disa gjetje të periudhës së vonë antike të zbuluara në fushën e Macdhoves." f. (77) (7)*

Duke arsyetuar me sa kemi shkruar më lartë, lindin pyetjet:

1- Kundodhet saktësisht me kufizimet e sotme gjeografike e topografike qyteti ose qyteza e Oenës?

2- Ku shtrihet saktësisht qyteti i Çidhnës, cilët janë kufizimet kohore të formimit të njërit (Oenës) e tjetrit(Çidhnës) qytetërim? Apo mbivendosen edhe si qytete njëri mbi tjetrin?

3- A mund të gëllitet nga histori shkruesit një qytet antik me një shtrirje kaq të madhe territoriale? (Nga brigjet e Drinit në Gurë Lurë S.M.) Po aq më pak mund ta përfytyroi një lexues i thjeshtë.

Të bëjmë një përçapje për të vërtetuar se si i emërtojnë dhe pozicionet gjeografike të disa kalave në krahinën e Çidhnës sipas Canit e Pernezhës në studimet e tyre:

*"Kjo (Kepi i Qytetit,S.M.)ishte fortesa e parë mbrojtëse e Oenës dhe kontakti i parë ose pika hyrëse për në qytet që sot njihet me toponimin "****Kepi i Qytetit."*** *f.(107)-* shkruan studiuesi I.Cani.

Ndërsa H.Përnezha i kushton disa rrjeshta të shkruar, dhe ja se si shprehet: *"Jo vetëm kaq, por ky "qytet"ka shërbyer edhe si vendvrojtimi, pasi në majë të kepit të Xhitetit gjenden edhe sot fragmente muresh e vendroj edhe nga kjo pikë kontrollohen lëvizjet nga Qafa Kanush (ndoshta THEKANUSH S.M.)dhe ura e Lushes." f.(10)*

Profesor Adem Bunguri do të shënojë: *"Kalaja e dytë, e përdorur kryesisht si pikë vrojtimi, është ajo e Kepit të Qytetit në hyrje të Çidhnës së Poshtme, e shfrytëzuar si fortesë në periudhën e bronxit të vonë, në atë helenistike dhe atë antike të vonë." f.(16) (8)*

Natyrshëm lind pyetja: Kepi i Xhitetit (Qitetit) ka qenë kala apo pikë vrojtimi?

Dr. I. Cani për një kala tjetër shprehet: *Kalaja e Oenës, ndodhet në pozicionin ndërmjet maleve të Halës së zezë, në një zonë shkëmbore e gëlqerore që sheh Dibrën…." "Ajo është e vendosur mbi një gurë madhështor një pjesë shkëmbore(shkëmb)në mes të malit. Sheshi ku është vendosur kalaja është rreth 500 metra (sigurisht katrore S.M.). …..Në përfundim të mureve ndodhet një shpellë që quhet shpella e shpëtimit." (f.104)*

(vijon numrin e ardhshëm)

BURIMET E PËRDORURA

1. Dr. Islam Cani "Çidhna dje, sot, nesër". *Studime historike-sociologjike Botime "Vallmasi" Tirane 2013*
2. Haki Pernezha "Krahina e Çidhnës". *Histori dhe etnokulturë, Botime M&B, Tiranë 2013*
3. Haki Koltraka Troviogjli Kastrotët e kidnit Skënderbegas. Tirane 2002 – 2006
4. Biseda me Mersim Krrashin kryer më 05. 01. 2007 datelindja 1936, dhe Selim Daci bisede 13.08 2007. Materiali i arshivuar.
5. Kristo Frashëri "Në gjurmet e qyteteve peneste"; në"Studime historike." N.4 Tiranë 1975
6. Hilmi Sadiku, "Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qytezave ilire te enestëve. Në: "Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve" (f. 255-256) Tiranë 1969
7. Iliaz Kaca Kontribut për lokalizimin e disa qyteteve peneste sipas të dhënave burimore e arkeologjike. Në: Dibra dhe Dibranët Shkodër 1985
8. Adem Bunguri "Të dhëna arkeoogjike nga Çidhna e Poshtme, Tirane 2008 *(Dorëshkrim)*

sport

Flet portieri i talentuar i Korabit, Mani Livani

Unë, "njeriu fluturues"!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Mani Livani është 21 vjeç dhe ka gjashtë muaj që mbron kuadratin magjik të portës në skuadrën pretendente të grupi A në Kategorinë e Dytë, Korabi. 5 vjeç është larguar nga fshati i lindjes, në afërsi të qytetit të Burrelit dhe familja e tij jeton prej 15 vjetësh në Fushë-Krujë. Ka 720 minuta pa pësuar gol me ekipin kryesues të kategorisë së dytë, Korabin, por më shumë se ky fakt, janë videot e çuditshme që ka publikuar në rrjetet sociale, të cilat e kanë njohur Mani Livanin, portierin e adhuruar tashme jo vetëm nga dibranët, por shumë tifozë të futbollit në Shqipëri dhe jashtë saj.



- Si nisi historia e një "powrtieri fluturues"?

- Që në moshën 7 vjeçare e kam filluar jetën sportive dhe karrierën si portier në Fushë Krujë. Iliria ishte ekipi i parë që unë pagëzova emrin tim si portier me moshat e vogla, për të vijuar më pas me disa skuadra. duke i ngjare një portieri "endacak", pasi lëviza sa ne qytetin tim, në Prezë, Tiranë, Yshek dhe Vore. Kur hodha shtat, zgjodha Kamzën të luaja me paratërinjtë, por në kujtesën time ka mbetur trajneri i Tiranës, Kadri Pengili, tek i cili kam qëndruar për afro 1 vit e gjysmë.

Më tej provova të luaj edhe me të rinjtë e Kamzës, ndërsa ekipi i parë i të rriturve ishte Vora ku ju gëzova daljes në kategorinë e dytë nga e treta, që ishte kjo skuadër. Me pas kalova tek Mamurrasi, por ndoshta shtatlartësia, më detyroi të mbetem portier i dytë. Korabi më testoi dy herë, në dy edicione të ndryshme. Sivjet më pëlqeu ekipi pretendent i Peshkopisë dhe zgjodha të isha pjesë e tij.

- Si është e mundur që një talent i tillë nuk ka dorën e ndonjë profesionisti të portës për tu stërvitur, por vëllait të tij?

- Është shumë e vërtete dhe kjo është një pyetje logjike. Në fakt, kur isha i vogël, kam bërë shumë kurse private me ikonën e portës së Partizanit dhe kombëtares, Perlat Musta. Kam fituar shumë prej tij. Por, tashmë kohët e fundit, mua më stërvit vëllai i im, Matlindi, dhe unë bëj çfarë më thotë ai.

- Sa jeni i gjatë dhe si guxoni të hidheni mbi lartësi dhe objekte të tilla si mure, makina, motora, betone etj?

- Jam 180 cm i gjatë. Sa i takon pjesës tjetër të pyetjes mund të them se po nuk guxove, nuk bëhesh. Unë e kam "vrarë" frikën, ndaj edhe hidhem ashtu. Lartësia e objekteve për mua është e zakonshme dhe shpeshherë harroj se çfarë kam poshtë trupit tim, madje më dhuron kënaqësi. Kam besim te ushtrimi që bëj dhe nuk pyes për frikën. Kjo më jep më shumë shpirt gare dhe më bën të mos kthehem mbrapsh edhe në daljet e mia në portë.

- Cila është jeta e një portieri tashmë me famën e publikut?

- Jeta ime është sporti dhe vetëm sporti. Ju kujtoj se stërvitem katër orë në ditë, prej të cilave gjysma me ekipin dhe gjysma indivduale. Për mua, detyra e një portieri nuk mbaron me orarin e stërvitjes së tij, por me mbylljen e ditës së tij të palodhshme. Unë kam vëllain që nuk kursehet të më bëjë gjithçka me dhe pa top. Hidhem dhe nuk ndalem për orë të tëra. Detyra ime është ta frenoj topin në rrugën e nisur dhe ta bllokoj portën.

Nuk jam dëmtuar kurrë edhe pse kam rrezikuar me hedhjet e mia gjatë stërvitjeve të përditshme, mbi makina, apo tuba betoni.

- Porta, apo roli i portierit, është trashgimni apo pasion?

- Në fakt, babai im ka qenë shumë i dhënë për tu bërë portier. Kishte mjaft cilësi, por asokohe nuk kishte kushte ta vazhdonte një karrierë të tillë. Tashmë jam i lumtur që ëndrrën e babait e mundësova unë, aq më tepër që vëllain e kam trajner, pa emër, por me shumë punë dhe përkushtim...

- Si ndjehesh te "Korabi" dhe a do vijosh misionin deri në fund me këtë ekip?

- Unë ndjehem shumë mirë me dibranët. Tifozët më ndjekin hap pas hapi, por edhe stafi dhe skuadra kanë një harmoni për t'u admiruar. Jam ndjerë si në shtëpinë time, ndoshta ngaqë jemi edhe fqinj dhe kemi shumë gjëra të përbashkëta. Presidenti Femi Meziu, trajnerët Erblin Laçi, Shpëtim Toska e Telman Perleka, drejtori klubit Sokol Muho, të gjithë kanë një angazhim maksimal. është një ekip që mbështetet nga bashkia, por donator kryesor është një djalë shumë pasionant, presidenti aktual Femi Meziu. Natyrisht, ka raste që edhe individë të ndryshëm tregohen dashamirës me ne, pas një fitoreje, ose rezultati lavdërues, duke dhënë ndonjë premio. Mos harroni që Korabi ka 11 fitore dhe vetëm një barazim. Kjo s'ka ndodhur asnjëherë në historinë e futbollit dibran.

- Ky rekord i Korabit me 11 fitore dhe një barazim, mos do të thotë që edhe ju kërkoni një rekord në emrin tuaj?

- Në fakt e synoj edhe unë. I kam vënë vetes detyrë që të mos lejoj gol në portën dhe të kaloj kufirin e 1085 minutave, pra dua të thyej rekordin e Alban Hoxhës. Të gjitha mundësitë janë, por më shumë se rekordi im, mua do më pëlqente të dilte Korabi në kategorinë e parë dhe ti gëzoheshim një historie të të një treve kaq të madhe e të njohur, që për fat të keq e ka futbollin në kategorinë e dytë.



Vilson Ndregjoni, *mundësi që do të bëhet Kampion i Botës*



Disa njerëz janë të veçantë... Punojnë fort në heshtje dhe lënë suksesin e tyre të bëje zhurmë për to. I tillë është edhe Vilson Ndregjoni. Ai lindi në 31 janar të 1992 në Lukan të Dibrës. Është vetëm 23 vjeç dhe kraharori i tij numëron më shumë medalje sesa vite jete.

Vilsoni nisi të merrej me sport në vitin 2004, vit që rezultoi mjaft i suksesshëm, pasi mori menjëherë titullin Kampion i Shqipërisë, titull që e ruajti për 10 vite radhazi, deri në 2014. Që nga pesha e parë 32 kilogram, duke vijuar më pas në ngjitje me peshat 35 deri 74 kilogram, Vilsoni nuk njeh kundërshtarë, por merr rresht dhjetë tituj Kampion i Shqipërisë në Mundje, si dhe nga viti 2012-2014 mban stafetën e Sportistit më të Mirë të vitit me të rriturit.

Por Vilsoni nuk mjaftohet vetëm më tituj në Shqipëri. Egoja e tij shkon më larg. Në vitin 2012 ai merr pjesë në Kampionatin Europian të të Rinjve në Kroaci, ku u rëndit në vendin e pestë me dy ndjeshje të fituara. Në 2013 ai merr humbjen e parë në karrierë në Kampionatin Kombëtar të Mundjes në Uzbekistan, për shkak të moshës së tij mjaft të re, po kjo nuk e ndaloi dot, përkundrazi, i dha atij shtysë të vijojë me këmbëngulje për më tej. Po në këtë vit, mundësi dibran fiton katër turne radhazi përkatësisht në Bullgari, Maqedoni, Greqi, Mal të Zi dhe Kosovë.

Qershia mbi tortë e gjithë karrierës 10-vjeçare të Vilsonit u vu në vitin që sapo lamë pas, kur ai triumfoi në Kampionatin Ballkanik, duke u shpallur Kampion Ballkani. Flamuri kuqezi valëvitet sërisht triumfator në duart e një dibrani...

Ndërsa e pyesim për planet më të afërta Vilsoni na surprizon më shumë se me medaljet dhe kupat e fituara. Duket sikur 2015 do te jetë viti i tij. Gjatë kësaj periudhe 12 mujore, sportisti, përveçse i zënë me stërvitjen intensive, që është pjesë e pandarë e jetës së tij, duket se do të jetë mjaft i angazhuar me udhëtime jashtë shtetit.

Këtë vit pritet që Vilsoni të udhëtojë drejt Azerbajxhanit për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror dhe Europian të Mundjes. Shtatori do ta gjej në Las Vegas, sërish në një kampionat të rëndësishëm mundjeje. Gjithashtu, këto muaj pritet konfirmimi i pjesëmarrjes së tij si përfaqësues i Shqipërisë në Lojërat Olimpike Brazil 2016.

Sashenka Ndreka

Rruga e Arbërit nr. 105

Një shembull i një qytetari të thjeshtë
dhe portretizimi i tyre në krijimtarinë artistike

kujtesë

Për **veten** dhe **Halit Seit Gjikën**

Nga **XHAFER MARTINI**

PËR HALIT SAHIT GJIKËN

Vjershën e poetit Ilri Spata ma sollën të printuar. E lexova dhe më pëlqeu shumë si çdo krijim i këtij poeti që shkruan me ashkë zemre dhe me vërtetësi. Në këtë vjershë ka edhe një strofë të tillë:

"Se këngë e shkrime për të tjerë,
Si elegjiak i madh shkrove.
Siç qajnë mardhur nëpër erë,
Pemët zhveshura prej dëbore".

Vërtet shkrova për të tjerë dhe mua më duket se kam bërë një gjë të mirë duke kujtuar ata që nuk janë më. Këtë nuk e kam bërë që edhe të tjerët të shkruajnë për mua, por se e ashtu e kam ndjerë, ashtu më ka thënë zemra të shkruaj për njerëz të shquar që ka nxjerrë Dibra, të cilët, sa qenë gjallë, nuk u nderuan dhe nuk u respektuan ashtu si e meritonin. Mjafton të kujtojmë këtu piktorin gjenial Bajram Mata, mjekun po gjenial Basri Neziri, poetët Maliq Bitri e Naim Plaku, historianin Hysen Lala dhe shumë të tjerë. Për ndonjë prej tyre si, për shembull, për Hoxhën e Blliçes, Bujar Kaloshin, Rrahim Gjikën dhe Hilmi Kolgjegjën kam shkruar edhe monografi të veçanta.

Kisha vendosur të "pushoj" pak, se edhe vdekja e miqve dhe shokëve po bëhej kaq e shpeshtë sa nuk po mundja ta "ndjek". Po merrem me kujtimet e mia se është mosha që ta bëj këtë punë para se të jetë vonë. Por kohët e fundit mora vesh se kishte vdekur Halit Sahit Gjika, vdekja e të cilit më pikëlloi shumë dhe unë po e thyej "betimin" tim. Por jo për cilindo që vdes, lë punët e tjera dhe shkruaj. E bëj këtë gjë për ata që ndjehem borxhli jo thjesht para tyre dhe familjes së tyre, por edhe para historisë dhe kulturës dibrane.

Djemtë e një burri që kishte vdekur, dhe që ishin edhe në gjendje të mirë ekonomike, kishin thirrur një vajtimore të famshme dhe i kishin thënë:

- Na e qajë babën me fjalë të zgjedhura ashtu si di ti!

- Mirë, - u thotë ajo, - por më bini këtu pushkën e patllaken që t'i kem parasysh!

- Armë nuk ka pas mbajtë,- i thanë ata.

- Më jepni sahatin e floririt, - tha prapë ajo.

- As sahat nuk ka pas.

- Më jepni kutinë e fakfanit dhe cigarishten e duhanit, - ra ajo në kërkesën e fundit, ku nuk kishte më poshtë.

- As duhanin nuk e ka pas pi, - i thanë djemtë.

- Po çfarë t'i qajë këtij? Ky paska vdekur me kohë, - tha vajtimorja dhe u ngrit e iku.

Alegoria besoj është e qartë. Të gjithë ata për të cilët kam shkruar unë, kanë qenë njerëz të veçantë, që kanë pasë shumëçka për t'ua përmendur. Nuk është fjala për kërkesat e vajtimores që përmendëm, por për gjëra të tjera shumë më të mëdha. Po Haliti çfarë ka pasë? Atë më kryesoren që rrallë burra e kanë në këtë jetë: Haliti kishte mirësinë njerëzore në një shkallë të pakrahasueshme. Ai ishte njeri i thjeshtë, me një arsim modest, por njeri i mësuar nga jeta, plot urtësi dhe mençuri, plot përvojë pozitive. Të bisedoje me Halitin thuajse kishe para një filozof dhe mendimtar të madh, që shkoqiste me një thjeshtësi të habitshme dukuri dhe probleme shumë të ndërlikuara, dhe që mbante një qëndrim të vetin ndaj çdo ngjarjeje dhe ndodhie, qëndrim i cili ishte i kundërt, në shumë raste,me atë të njerëzve të tjerë. Haliti arsyetonte, analizonte dhe nxirrte përfundimet e veta, çka e bën atë një tip krejt origjinal dhe krejt të pandikueshëm nga të tjerët. Kurse ndikim i tij tek të tjerët ishte i madh. Unë për veten time kam pasur rastin të konstatoj sa i thellë ishte ai në mendime, sa i përzemërt në veprime, sa organizator cilësor në punë që duheshin kryer bashkërisht, si për shembull, në dasma, morde dhe përgjithësisht në punë të tilla ku duhet ndërgjegje dhe cilësi. Aty ku punonte Haliti, puna shkëlqente.


Halit Gjika

ILIR SPATA

Mësuesit tim të letërsisë
Xhafer Martinit

Të pashë mërzitur, merakosur,
Breror' e thinjave rrudhash rënë.
"Kush do 'i thotë fjalët e fundit?
Si do ma këndojnë të fundmen këngë?"

Se këngë e shkrime për të tjerë,
Si elegjiak i madh shkrove.
Siç qajnë mardhur nëpër erë,
Pemët zhveshura prej dëbore.

Siç uluron kur vjen me gjamë
Veriu i egër luginës dimrit,
Siç varen, qajnë të murrmet re
Kur zbresin Setës a derdhen Drinit.

O ti fodulli me balluke,
Që kryeneçe t' binin mbi ballë;
do dalë dikush të t'i qëndis
Kripur prej lotësh t'ëmblat fjalë.

Do të dalë dikush nga Ti mëkuar
Me shqipen mjalt e letërsinë
Të t' i qëndis në stilin tënd
Ato që bota ende s'dinë.

Nga fara jote që jetës mbolle
Do të shpërthejë ndonjë filiz
Me sytë rrëmbushur prej lotësh,
O mësuesi im i letërsisë.

Ku dihet është ai çamarroku
Që fjalët t'i rrokte pa i thënë,
Që të parat këngë djaloshare
T'i pat lexuar dhe i pat nxënë!

Kur val' e nxehtë e kujtimeve
Do ja përziej fjalët me lotë:
I ri, i sertë, fodull prej Çidhne
Me ne do të jesh, ti s'ikën dot!

Do t' dalë dikush, ti brengën hiqe
T'i thotë ato që s'munde dot
Të na i sillje në këngë e vargje
Ene t'i mbartnim nëpër botë.

Mos u mërzit, dikush do ngushet
Të fundmet fjalë me mall t'i thotë
Të marrin dheun si lule bjeshke
Që nga Korbai e tej në Botë!

Si shushërimë e Drinit plak
Që agut shelgjeve pështpërit,
Si këngë e bulkthit nëpër natë,
Aromë e barit sapo kosit.

Ti do të ngelesh si atëherë:
Hedhur balluken përmbi ballë!
Sikur e shkrove të parën këngë,
Sikur qëndise të parat fjalë!

"Sa herë hallet duan të më ulin poshtë dhe të më shkelin me kambë, unë i jap vetes nalt. Ngre kokën si kali i mirë kur hynë në lumë. Tue ba vazhdimisht këtë veprim, tue synue gjithnji naltësinë, do ti që Zoti sikur më jep krahë dhe më mban lart, të paktën më lart se njerëzit e tjerë. Po hallet e shqetësimet, çdo e keqe është për toke, jo në naltësi".

Mirësinë Haliti e rrezatonte me çdo njeri që takohej, në çdo bisedë, në çdo rast, kudo që të ishte dhe me këdo që të bisedonte. Nëse kishte ndonjë të keq, nëse kishe ndonjë hall, nëse, për shumë arsye ose pa arsye fare, ndiheshe i pikëlluar, i mërzitur, një takim me Halitin ishte si një melhem që i vihet plagës dhe që e shëron me njëherë. Haliti nuk ishte një njeri i vetëm në kuptimin e zakonshëm të kësaj fjale, ai ishte një institucion, institucioni i mirësisë njerëzore. Ai ishte bashkëfshatar i imi, i ardhur nga Mustafet, por i vendosur afër shtëpisë sime në Fushë Alie. Ishte lumturi që na u bë fqinj një njeri si Halit Gjika. Haliti ishte nip tek Kukelet, po në Fushë Alie, djali i Dije Kukelit, një grua shumë fisnike, që të kujton atë racën e pastër njerëzore që tani pothuaj nuk takohet më.

Halitin e varrosën në Fushë Alie. Unë nuk mund të shkoja për arsye moshe dhe shëndeti. Natyrisht, doja që Haliti të jetonte sa më gjatë, të gëzonte fëmijët që i janë bërë aq të mbarë, të gëzonte nipërit dhe mbesat, të gëzonte jetën se edhe nuk ishte kaq i vjetër, por, në të njëjtën kohë, gëzohem që edhe unë mund t'i shërbej Halitit më ndonjë farë mënyre dhe kjo është që të shkruaj për të, siç kam bërë edhe për shumë të tjerë. Kjo është detyra ime,e elegjiakut, siç është shprehur Iliri.

Ndërsa po shkruaj për Halitin, fjalët dynden cila të zërë vendin e para në radhë për të treguar për të. Mendimet më kanë kapuluar aq shumë sa kanë marrë formën e një reje që ma ka kufizuar shikimin në të gjitha anët, përveçse në tastierën e kompjuterit, ku ndriçon dielli i fjalëve. Unë kurrë nuk e kam parë Halitin të mërzitur, të stresuar, të mposhtur nga gjendje të rënda shpirtërore. Herë-herë, kur përpiqesha ta shpjegoja këtë dukuri, ai nuk më dukej si i kësaj toke.

Një ditë, ndërsa po pinim nga një kafe dhe po bisedonim bashkë, ia thashë atë që kishte menduar prej kohësh për të: Pse ti, Halit, je gjithnjë i gëzuar, pse nuk je i mërzitur si ne të tjerët, pse nuk të kam parë kurrë të merakosur, edhe kur ke pas hall? Unë nuk bisedoja si me çdo njeri tjetër me Halitin, dhe Haliti nuk bisedonte me mua si me çdo njeri tjetër. Ne filozofonim me njeri-tjetrin ose përpiqeshim të filozofonim. Dhe pyetja që i bëra, ishte me natyrë filozofike. Por mua nuk ma kishte marrë kurrë mendja se edhe ai do të përgjigjej në mënyrë filozofike. Unë kisha lexuar shumë filozofë dhe dija shumë rryma filozofike. Ai nuk kishte lexuar asnjë prej tyre, bile asnjë libër. Po, filozofinë popullore e njihte shumë mirë. Përgjigjja e tij qe pak a shumë kjo:

"Sa herë hallet duan të më ulin poshtë dhe të më shkelin me kambë, unë i jap vetes nalt. Ngre kokën si kali i mirë kur hynë në lumë. Tue ba vazhdimisht këtë veprim, tue synue gjithnji naltësinë, do ti që Zoti sikur më jep krahë dhe më mban lart, të paktën më lart se njerëzit e tjerë. Po hallet e shqetësimet, çdo e keqe është për toke, jo në naltësi".

Kjo filozofi më është ngulur në tru dhe unë kam dashur ta trajtoj ashtu si e meriton, në mënyrë filozofike. Haliti, vështruar nga kjo anë, i takonte shkollës së stoikëve, të qëndrestarëve. Prej kësaj filozofie, ose mendësie që e kishte Haliti, më dukej se ai fitonte përherë atë lartësinë që i duhej për të mos u lyer dhe zhgërryer në baltërat e halleve të përditshme. Ai gjithnjë kishte besuar në Zotin dhe Zoti ka thënë: "Nëse ti më afrohesh një pëllëmbë, unë të afrohem një pash, dhe nëse ti më afrohesh një pash, unë të hedhe krahët në përqafim".

Prej Halitit kam mësuar shumë gjëra. Ato tregimet popullore, në frymë dhe në motive, prej të cilëve kam botuar mjaft tek dy librat: "Fjala priu" dhe "Dasma me 300 nuse", një pjesë të mirë i kam marrë nga Haliti. Si pjesë e përvojës dhe kulturës popullore, a dinte shumë prej tyre. I tregonte bukur dhe, për çudi, dinte t' interpretonte në mënyrën më të përshtatshme. Shumë pjesë të kësaj kulture, ngjarje historike, ndodhi të së kaluarës së hershme dhe të vonë, i kam mësuar prej Halitit. Ka qenë, më duket vitit 1988, kur në Fushë Alie u bë një sesion shkencor kushtuar problemeve të historisë dhe kulturës popullore. Haliti, me atë të ecurin e tij të ngadaltë, erdhi dhe u fut në sallën si shumë katundarë të tjerë. U mbajtën disa kumtesa, një prej të cilave e kisha unë. Natyrisht, trajtimet ishin ato të frymës së kohës, megjithëse pati ndonjë përpjekje për të dalë jashtë suazës që mbretëronte. Kur mbaroi sesioni, unë dhe Haliti u takuam. E pyeta për përshtypjet që kishte krijuar për sesionin shkencor. E kuptova se diçka kishte për të më thënë.

- Këtë luftën që është bërë këtu në Salbatër nuk e përmendët fare, - tha Haliti duke pasur parasysh luftën e Halil Alisë ndaj partizanëve më 8 gusht 1944 në kodrat e Fushë Alies.

- Nuk e kishim në program, - i thashë.

- Qe luftë vllavrasëse, luftuan shqiptarët me njëri-tjetrin, - tha Haliti.

Në vitet e para të demokracisë lufta nacionalçlirimtare është kontestuar shumë pikërisht për kahjen e luftës vëllavrasëse (luftës civile), siç u shpreh në atë kohë Haliti. Bisedat me Halitin më kanë vlejtur shumë për të shkruar librin për Halil Alinë. ("Kaq shumë gurë u hodhën për mbi mua", Tiranë 2008)

Haliti ishte besimtar dhe kishte bindjen se njeriu ishte vdekshëm, por shpirti jo, shpirti ishte si era dhe do të bridhte i lirë ose do të jetonte më ndonjë qenie tjetër. Subjektin e tregimit "Jetë", që e kam botuar në disa libra, ma ka treguar Haliti.

Me dy fjalë, subjekti është ky:

Ishin dy miq dhe njeri sëmuret rëndë. Kur po vdiste, i tha mikut: unë do të vdes, por shpirti im jo. Ai do të hyjë tek një qen. Buça e Larme do të bëjë katër këlyshë, njeri prej tyre do të jetë i zi dhe me një pullë të bardhë në ballë.

kujtese

Më 8 janar 2015 iu dha lamtumira e fundit, Hazis Fali Ramës, një ndër personalitetet e shquara të zonës së Muhurrit

Ky do të jem unë. Të më therësh brenda javës së parë të lindjes. Ky është amaneti. Do ta bëj, i dha fjalën miku.

I sëmuri vdiq, të gjallit as që i shkoi mendja tek amaneti që i kishte lënë miku. Një ditë, si ta kishte bërë me qëllim, Buça e Larme, me katër këlyshët i del në rrugë. Shikon ky burri Pullaliun dhe iu kujtua amaneti mikut. E kapi dhe nxori thikën ta therte. Mos më vra, nuk ke të drejtë, i tha ai. Po a je ti filani? Po, ai jam, por ti duhej të më vrisje javën e parë, kur nuk kisha hapur sytë. Tani që pashë botën, dua të jetoj edhe si qen".

"Njeriu edhe sikur midis thumbit e patkoit të jetë, don të jetojë", tha Haliti duke më sjellë mesazhin e këtij subjekti shumë interesant. Haliti vetë vuajti pesë vjet para se të vdiste. E mbante gjallë tubi me oksigjen. Mjafton ta hiqte një çast atë dhe...Po ai kishte bindjen që Zoti ta jep jetën dhe vetëm Ai ka të drejtë të ta marrë. Çdo vetëvrasje, sipas tij, ishte një gjë shumë e dënueshme nga Zoti.

Haliti ka qenë edhe mjek popullor, një kirurg ortoped me famë. Kush thyente krahun, dorën, këmbën, çdo gjymtyrë, shkonte tek Haliti. Ai ishte kaq mjeshtër në këtë punë, sa nuk kishte dështuar kurrë. Kishte një dorë të lehtë, thonin ata që e kishin provuar. Sa të të prekte Haliti, dhimbja ikte. "Ma thyen krahun dy herë në spital dhe dy herë ma futën në allçi", thotë H. Krahu zuri shtrembër për të dytën herë dhe shkova tek Haliti. Unë kujtova se po e vizitonte për të konkluduar se ç'duhej të bënte me të, kur ai, "krrak", me një lëvizje të shpejtë, ma çoi krahu në vend. Më theri fortë ajo lëvizje e papritur, por kaq qe. Ja, tani me këtë krah, që e kam prej Halitit, punoj më shumë se me tjetrin. Desha t'i japë pare, por u fye shumë. Nuk e bëj për pare, tha, por nga dashuria që kam ndaj Zotit.

Nga vëllimi me Novela (Tiranë, 2012), si më të bukurën prej tyre, unë konsideroj atë me titull " Balada e Drenushës", ku heroi kryesor është Brahim Bredhi, një mjek i shquar popullor, ortoped sikur të jetë me gradë dhe me titull, që konkurron edhe doktorët e qytetit, prandaj ata bëjnë çmos për ta mënjanuar. Çdo shkrimtar, ose shumica prej tyre, kur portretizojnë një personazh, kur e karakterizojnë atë, ndodh që kanë parasysh prototipa realë, njerëz nga jeta, vetitë dhe cilësitë e të cilëve ua veshin personazheve letrarë. Natyrisht, transformimet janë të shumta, të asaj natyre që shkrimtarit ia kërkojnë kushtet e rrethanat, por mbështetja tek një njeri real ka mjaft rëndësi për të shtuar forcën realiste të veprës dhe besueshmërinë e personazhit. Kur kam dhënë mjekun popullor Brahim Bredhi, mua vazhdimisht më është kujtuar Halit Gjika. Natyrisht, që nuk janë identikë, por Haliti si njeri më ka ndihmuar shumë në karakterizimin e personazhit letrar.

Se ç'njeri ka qenë Haliti, mund ta gjykojmë edhe nga fëmijët që ka lënë, dhe jo pak, por shtatë: tre djem dhe katër vajza, të gjithë me arsim të lartë, të gjithë me punë dhe të dalluar në profesionet e tyre, të gjithë të sjellshëm, të pritshëm, bujarë dhe të thjeshtë si Haliti. "Ka pasur një ndikim të madh tek secili prej nesh, thotë djali tij më i vogël, por që tashmë është burrë dhe ka mbaruar shkollën e lartë. - Kurrë nuk ka përdorur dhunë, kuptuar këtu edhe dhuna e fjalës. Përkundrazi, na drejtohej me fjalë të ëmbla, të mira, duke na nxitur dhe frymëzuar më shumë në mënyrë të heshtur. Kur u sëmurë rëndë dhe e pa gjendjen e vetë, me gojë nuk na e thoshte, por ne e kuptonim se donte të varrosej në Fushë Alie. Ai i mendonte të gjitha: rruga e largët, mesi i dimrit, shpenzimet dyfish dhe plot të këqija të tjera, prandaj nuk e hapte gojën që të na e linte amanet. Por ne e dinim dhe e varrosëm në Fushë Alie. Kjo ishte një sakrificë shumë e vogël në krahasim me ato që ai ka bërë për ne..."

Ndahet nga jeta **Ajri Begu**, shkrimtari dhe themeluesi i Bankës Qendrore të Kosovës



Është ndarë nga jeta Ajri Begu, shkrimtari dhe themeluesi i Bankës Qendrore të Kosovë. Begu, njëri nga ekonomistët e shquar të brezit të mesëm, vdiq pas një sëmundje të shkurtër, por të rëndë, në moshën 64 vjeç.

I lindur në Dibër, ku mbaroi shkollën e Mesme, studio ekonominë në Universitetin e Prishtinës dhe një kohë punoi gazetar dhe analist i zhvillimeve ekonomike. Begu shkruante poezi si dhe kishte një rol aktiv në jetën kulturore të Prishtinës.

Pas luftës u angazhua për themelimin e Bankës Qendrore të Kosovës, ndërkohë u zgjodh guvernator i saj.

Begut iu bënë homazhet e fundit në Teatrin Kombëtar të Kosovës më 26 janar. Veprimtari dhe shkrimtari Adem Demaçi ka ngushëlluar familjen dhe miqtë e pranishëm në mbledhjen komemorative e mbajtur në Teatrin Kombëtar. "Ne mbetëm pa një atdhetar të madh, pa një punëtor të madh, mirëpo duhet ta vazhdojmë jetën se jeta vazhdon si me ne ose pa ne po ne duhet të përpiqemi që të bëjmë atë çfarë na ka mbetur për të bërë", ka thënë Demaçi në ceremoninë e përcjelljes.

Në ceremoninë e përcjelljes kanë folur edhe Guvernatori aktual i Bankës Qendrore të Kosovës, Bedri Hamza, ndërsa Prof. Mahmut Hysa e ka kujtuar Begun dhe fëmijërinë e tyre duke e cilësuar si personalitet të shquar dhe profesional në aspektin financiar.

Një portret më të detajuar mbi jetën dhe veprimtarinë e Ajri Begut do të botojmë numrin e ardhshëm.

Kujtohet kampioni i boksit, Mentaz Allajbegu



Me rastin e një-vjetorit të ndarjes nga jeta, është nderuar nga familjarë dhe miq të shumtë kampioni i boksit Mentaz Allajbegu.

Ai ishte trajneri shqiptar me famë botëror i sportit të mundjes, duke i dhënë shqiptarëve të këtij sporti titujt kampion evropian, botëror e olimpik. Allajbegu ndërroi jetë një vit më parë në moshën 67-vjeçare. Ai ishte nga Dibra por punën më të madhe e bëri në klubin e mundjes Liria nga Shkupi dhe atë Prishtina. Për herë të parë filloi punën si mësues sporti në shkollën "7 Marsi" në Dibër. Këtu nxori kampioni i parë në boks, 15-vjeçari Ekrem Sulejmani në vitin 1966. Trajneri Allajbegu punën e tij e kishte të drejtuar në shumë disiplina si gjimnastika, shenjëtaria, atletika, ping-pongu, ndërsa kur nxënësit kishin pushime verore, ai arrinte që të organizonte kampingje në Liqenin e Ohrit në Ohër, në Strugë dhe në Prespë, që kështu fëmijët të mësonin edhe notin.

Me nisjen e punës në Klubin "Prishtina" më 1983 filloi edhe puna e mirëfilltë e Federatës së Mundjes së Kosovës, të cilin Allajbegu arriti ta themelojë me punë dhe mund të madh. Ai i ndiqte talentet e mundjes në gjithë Kosovën, dhe nxënësit e tij Shaban Sejdiu , Shaban Tërstena , Abdulla Memeti, Bajram Qerolli, Mirdi Limani, Albert Selimi dhe Azem Maksutaj etj., arritën të shpalleshin jo vetëm kampion në ish-Jugosllavi, por edhe të fitonin medalje në lojërat olimpike në Los Anxhelos (1984) dhe Seul (1988).

Gjatë viteve të fundit ai e ushtronte profesionin e tij vullnetarisht, dhe shumë boksierë që vazhdojnë sot karrierën, mësimet e para i kanë marrë nga Mentaz Allajbegu, i cili për punën, përkushtimin dhe dashurinë që ushtroi ne profesionin e tij, do të mbahet mend gjatë!

Lamtumirë Hazis Rama!



Më 8 janar 2015 iu dha lamtumira e fundit, Hazis Fali Ramës, një ndër personalitetet e shquara të zonës së Muhurrit. Familjarë, miq, të afërm, shokë, bashkëluftëtarë e bashkëpunëtorë të shumtë e përcollën atë për në banesën e fundit me të gjitha nderimet që meritonte.

Ndonëse ndërroi jetë në moshën 91-vjeçare në Babrru të Tiranës ku jetonte bashkë me familjen prej afro dy dekadash, për t'i dhënë lamtumirën e fundit Hazis Ramës, qindra njerëz udhëtuan në një ditë të ashpër dimri, që nga Tirana në Muhurr (ku ai e kishte lënë amanet që të varrosej). Ishte edhe kjo pjesëmarrje masive e qindra qytetarëve nga Muhurri, Luznia, Sinja, Peshkopia, Tirana, Durrësi dhe nga e gjithë Shqipëria në lamtumirën e fundit, dëshmi e respektit përkëtë burrë të shquar të Muhurrit e të krejt Dibrës.

Ai, ndërroi jetë, krejt papritur, më 8 janar 2015. Kjo ikje e papritur, e bëri më të thekshme dhimbjen e madhe për të, jo vetëm për familjen dhe të afërmit e tij të dashur, por për të gjithë ata breza nxënësish që ai kish mësuar në Peshkopi, Muhurr, Luzni, Tiranë etj.., për të gjithë kolegët, pedagogët, intelektualët, me të cilët ai kish punuar.., për të gjithë të njohurit e tij të shumtë si në Dibër, në Tiranë e kudo.

Ai lindi në Muhurr me 1924, në një familje me tradita të njohura patriotike.

Kur ishte ende i ri, i brumosur me dashurinë për atdheun rroku armët dhe u rreshtua me partizanët e komandës së vendit, që luftonin për çlirimin e atdheut nga pushtetuesi nazifashit. Pikërisht për këto merita gëzonte dhe Statusin e Veteranit të LANÇ-it. Arsimin bazë e kreu në vendlindje, dhe pas kualifikimit si mësimdhënës shërbeu fillimit si edukatori i parë në Kopështin e Fëmijëve të qytetit Peshkopi dhe më pas si mësues i shkollave fillore Muhurr, Zimur, Hotesh etj. Qysh në moshën e rinisë, me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike të familjes, tek ai spikati zelli dhe vullneti i madh për shkollën, për librat dhe dituritë.

U formua si intelektual dhe shërbeu si i tillë me devotshmeri në sektorë të rëndësishëm edhe në ish kooperativën bujqësore Muhurr.

I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit.

Në përditshmërinë e jetës ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale dibrane.

Kujtimet më të mira për atë burrë të mençur, bujar, patriot dhe edukator shembullor ruajnë ish koleget por dhe ish nxënësit e shumtë që e mbajnë mend për mprehtësinë e mendimit dhe forcën e argumentit. Më së miri ato ruhen e dëshmohen në kujtimet e bashkëmoshatarëve Ahmet Kaponga Korça, Dr.Kolë Geraj nga Komani i Pukës e Xhemal Mani nga Rreth Kale, që e ndjejnë shumë mungesën e ish shokut të tyre, me të cilin pinin kafenë e mëngjezit dhe që dëgjonin me vëmendje e mësonin nga urtësia e mençuria e tij.

Pikërisht, si i tillë ai u përcoll për në banesën e fundit , me të gjitha nderimet që meritonte, nga familjarët, të afërmit, miqtë e shokët e shumtë, nga Dibra, Tirana, Kruja, Tropoja, Durrësi, Elbasani, e nga e gjithë Shqipëria.

Zakonsiht në të tilla përcjellje, gjithkush për të ndjerin flet fjalë të mira, por rrallë ndodh që gjithkush të përjetojë vlera dhe mirësi nga vetë ceremonia e lamtumirës. Natyrisht është vlerë numri aq i madh i miqve e shokëve që erdhën për ngushëllime në familje, shumicë kjo që nuk u pakësua as në varrimin e tij në Muhurr, 200 kilometra larg shtëpisë së banimit të familjes në Babrru të Tiranës. Ata e nderuan Hazisin për virtytet shembullore që ai mishëronte dhe transmetonte në familje, punë, shoqëri e kudo. Hazis Rama ishte burrë i urtë, i mençur, largpamës, por edhe burrë i kuvendeve. Kudo ku punoi e shërbeu, si në vitet e zjarrta të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në periudhat e mëvonshme si mësues e edukator i brezave të shumtë, por dhe si magazinier në ish koop. bujqësore ai demostroi aftësi të rralla, sjellje shembullore, përkushtim e korrektësi ndaj të gjithëve. Me këto cilësi të rralla njerëzore rriti dhe edukoi 5 djemtë, katër vajzat dhe dhjetra nipërit e mbesat e tij, të cilët duhet të jenë krenar për babain e gjyshin e tyre.

Halil RAMA

Pajtohu në gazetë - 1 vit vetëm 600 lekë















Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603